



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar i auditimit i ushtruar në “Agjencinë e Prokurimit Publik”
(APP)

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” në

AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

Prill 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.....	3
II. Hyrja.....	8
1) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	8
3) Identifikimi i çështjes:	9
4) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim	10
5) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:	10
6) Kriteret e vlerësimit:.....	11
8) Standardet e Auditimit.....	11
9) Metodatat e auditimit.....	12
10) Dokumentimi i auditimit	13
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT	13
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:.....	14
2.1 Veprimtaria e Agjencisë së Prokurimit Publik	14
2.2 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.	51
2.3 Auditimi i llogarive vjetore.....	58
2.4 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	72
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	81

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë e Prokurimit Publik, më poshtë e emërtuar “APP”, për periudhën nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2023, me objekt “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë”.

Auditimi kishte në fokus pesë drejtime kryesore, sipas programit të miratuar me nr. 1037/2, datë 14.12.2023, dhe në të u angazhuan 4 (katër) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u përqendrua kryesisht në aktivitetin e APP mbi planifikimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm të njësisë, procedurat e prokurimit publik, mbajtjen e evidencës kontabël dhe menaxhimin e aktiveve.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë dhe financiar të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të APP për periudhën nga data nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2023, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të pakualifikuar të përputhshmërisë dhe opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
A/1	<p>Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar një mungesë koherence të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, për sa i takon afateve të ankimimit administrative. Konkretisht, sipas Ligjit Nr.36/2020 në neni 53 pika 2 dhe 3, përcaktohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p>Ndërkohë që ne VKM Nr.1170, datë 24.12.2020 neni 62 pika 4 dhe 5, përcaktohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës,</p>	<p>(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	E lartë	<p>Nga APP në bashkëveprim me Ministrinë e Mbrojtjes në rolin e institucionit përgjegjës për prokurimet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të merren masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve, duke mos lejuar mungesë koherence ligjore.</p>

	<p>sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.</p>			
A/2	<p>Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në lidhje me Dokumentet standarde të ankandit, ka një mospërputhje ndërmjet pikës 3 të nenit 20, ku përcaktohet se autoriteti shitës negocion me ofertuesit, për t'iu përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftim në mënyrë që të kenë si rezultat përzgjedhjen e ofertës më të mirë. Por, në pikën 5.1 të DSA shprehet se “Nuk do të kryhet asnjë negociatë me Ofertuesin në lidhje me ofertën e tij”, përsëri ka një mospërputhje ligjore, e cila sjellë problematika në praktik.</p> <p>- Nga ana e grupit të auditimit konstatohet një mos përputhje në afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimi të tij, konkretisht në shtojcën 7 të DSA përcaktohet se subjekti fitues ka afat 30 ditë kohë për tu paraqitur për formulimin e sigurimit të kontratës. Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi në lidhje me afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimi të tij, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës.</p> <p>-Ka vetëm 1 standard Dokumenteve Standarde të Ankandit, edhe pse janë 4 procedura të ndryshme. Pavarësisht faktit se VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 përcakton se: “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dokumentet standarde të ankandit publik, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.</p>	<p>(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	E lartë	<p>Nga APP në bashkëveprim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e institucionit përgjegjës për prokurimet në fushën ankandeve publike, të merren masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve të kuadrit rregullator në fuqi dhe dokumenteve standard të ankandeve.</p>
B/1	<p>Për periudhën 2021-2022, rezultoi se nuk ka pasur asnjë proces hetimi për kontrata koncesionare .Referuar informacionit të datës 18.7.2023, dërguar nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, për vitin 2020 është nënshkruar kontrata koncesionare datë 20.4.2020 me objekt: “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës”, me Autoritet Kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu, Sektori i Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare në Agjencinë e Prokurimit Publik, nuk ka informacion të përditësuar nga ATRAKO, nëse janë finalizuar me nënshkrim kontrate, tre procedurat koncesionare të vitit 2022 . APP pasi administron kontratat koncesionare nga ATRAKO,(kjo e fundit është përgjegjëse për mbajtjen e bazës së të dhënave për të gjitha kontratat e koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të dhëna në Republikën e Shqipërisë), vlerëson në bazë të kriterëve të caktuara në rregulloren e saj</p>	<p>(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	E lartë	<p>Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa në vijim që të ketë një komunikim të vazhdueshëm me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve lidhur me përditësimin e informacionit për kontratat koncesionare .</p>

	të brendshme, për përzgjedhjen e kontratave që do t'i nënshtrohen hetimit administrativ.			
B/3	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga subjekti mbi planet e verifikimit për procedurat e prokurimit publik, procedurat e Konçesioneve/PPP dhe procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë për vitet 2022 dhe 2023, u konstatua se: APP si institucion verifikues ende nuk ka përbushur detyrimin ligjor për monitorimin procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, me qëllim dhënien e sigurisë për mirëmenaxhim të fondeve publike në këto procedura prokurimi. Megjithëse APP ka ndër marrë në kohë dhe ka ndjekur në vijimësi gjithë veprimet e nevojshme konform kërkesave të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, për të përmyllur procesin e implementimit të sistemit të komunikimit dhe të informacionit ende nuk ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AKSHI, pasi nevojitet asistencë e një specialisti IT, në rolin e administratorit të SIK-së, si person përgjegjës për aspektet e sigurisë që lidhen me implementimin, instalimin dhe operimin e sistemit. Për këtë arsye APP, me shkresë nr. 9550/1 prot, datë 14.12.2023, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të caktuar një nga specialistët IT të atashuar në APP, në rolin e administratorit të SIK por nuk ka marrë një përgjigje nga AKSHI.</p> <p>Nisur nga të dhënat statistikore për periudhë 2021-2023 rezultojnë të jenë në total 35 kontrata të nënshkruara për procedurat e prokurimit në këtë fushë. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 14 të ligji nr. 36/2020 “Për Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.”</p>	<i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i>	E lartë	<p>-APP të vijoje bashkëpunimin me Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për caktimin e specialistit të IT-së në APP, në rolin e administratorit të Sistemit të Informacionit të Klasifikuar, si personi përgjegjës për aspektet e sigurisë që lidhen me implementimin, instalimin dhe operimin e këtij sistemi.</p> <p>- Nga ana e APP-së të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga AKSHI me qëllim përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i informacionit të klasifikuar, si dhe të marrë masa për nisjen e punës për verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit.</p>
B/4	<p>Nga auditimi i zërave “Llogari të arkëtueshme” u konstatua se:</p> <p>- Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në shumën 158,509 lekë përfaqëson të drejtat që i kanë lindur institucionit të APP-së për të arkëtuar debitorë, e cila daton që në vitin 2000 dhe përfaqësojnë gjoba ndaj punonjësve. Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto të drejta nuk janë arkëtuar dhe kanë kaluar afatin e parashkrimit për arkëtimin e tyre. Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë <u>kjo shumë rezulton e paarkëtueshme</u>, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 115 Kodit Civil “ Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.</p>	<i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 55-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i>	E lartë	<p>Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të parkëtueshëm, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.</p>
B/7	<p>Nga auditimi i Llogarive të pagueshme u konstatua se:</p> <p>Në llogarinë 401-408, “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, ndër të tjera, përfshihet dhe detyrimi që ka institucionit i APP-së, në vlerën 1,507,813 lekë, furnitorë të palikuiduar për periudhën 2007-2008. Nga</p>	<i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 55-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i>	E lartë	<p>Nga ana e titullarit të Agjencisë së Prokurimit Publik të merren masat për ngritjen e një grupi pune, me qëllim identifikimin e mundësive reale për pagesën e këtyre debitorëve apo për</p>

<p>informacioni i vënë në dispozicion, këto detyrime nuk janë paguar, si dhe nga ana e furnitorit subjekti "G", janë kaluar afatet e parashkrimit për pagesën e tyre. Nga ana e furnitorit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si dhe ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 114 "Afatet e parashkrimit" ku citon se "Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë" dhe neni 121 "Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës" <u>ky detyrim është i parashkruar.</u></p>		<p>sistemimin e këtyre vlerave sipas parashkimeve në Kodin Civil.</p>
---	--	---

Në përfundim të auditimit të përputhshmërisë dhe financiar, të ushtruar në Agjencinë e Prokurimit Publik, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 31.12.2023, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 1037/2, datë 14.12.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin dhe opinionin, si më poshtë:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare: (i pakualifikuar¹)

Audituesit e pavarur të KLSH^{se}, kanë audituar pasqyrat financiare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe dokumentacionin financiar për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2023 dhe japin opinion për pasqyrat financiare të vitit 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të flukseve monetare, të ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto, pasqyrat statistikore dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit APP paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit në datën 31.12.2022 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar", të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin".

Baza për opinionin:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Agjencisë së Prokurimit Publik në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe ISSAI 1700².

Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik

¹- Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, *Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar dhe (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.*

²**ISSAI 1700**- Objektiv i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

(ISSAIs), Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 130- “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar**.

Nën gjykimin profesional të audituesit është marrë në konsideratë pragu i materialitetit për vitin 2022 (në masën 0.7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar) në vlerën 1,169 mijë lekë për shpenzimet, për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Opinion mbi përputhshmërinë: i pamodifikuar/pakualifikuar³.

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Agjencia e Prokurimit Publik me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e institucionit Agjencia e Prokurimit Publik është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe justifikon dhënien e një “Opinionit të Pakualifikuar”.

Baza për opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar të përputhshmërisë:

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Agjencia e Prokurimit Publik” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000⁴ dhe ISSAI 100, paragrafi 42 .

Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), parimet INTOSAI-P1 “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20, ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. si dhe me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, miratuar me Vendimin nr. 245, datë 25.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga APP dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

³ 3 -Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (Dhjetor 2023, fq. 103-104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinionet e pakualifikuara: “Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinionin të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”.

⁴ISSAI 4000 – *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.*

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Strukturat drejtuese të Agjencisë së Prokurimit Publik janë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të APP-së, (trajtuar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit).

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Hyrja.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 1037/2, datë 14.12.2023, në Agjencinë e Prokurimit Publik, nga data 11.12.2023 deri më datë 29.01.2024, për periudhën e auditimit 01.01.2021-31.12.2023, u krye Auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.G., (përgjegjës grupi),
2. J.K., anëtar
3. A.H., anëtar
4. L.L., anëtar

1) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Agjencia e Prokurimit Publik me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në nenin 3 të tij ka përcaktuar se, “Auditim i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord”. Në nenin 12 “Auditimi i përputhshmërisë” të po këtij ligji është shprehur se: “Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik”. Në pikën 2 të po këtij neni ka përcaktuar se “Auditim financiar” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

ISSAI 4000, paragrafi 23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t’i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislative, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar.

ISSAI 1700, paragrafi 4: Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë

e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

Objektivat e auditimit synojnë:

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

b. njeherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

2. Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë APP, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

3) Identifikimi i çështjes:

Projekt Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit të Agjencia e Prokurimit Publik, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Agjencia e Prokurimit Publik”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri në 31.12.2023, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të APP-së, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 1037/2, datë 14.12.2023.

4) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim

Niveli menaxherial i Agjencisë së Prokurimit Publik është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

5) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit.

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi çështjet që janë nën auditim.

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)

d) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj;

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 47, ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit

të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh” Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

6) Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; i ndryshuar me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”;
- Udhëzimi MF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimin MF nr.5, datë 21.02.2022.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”;
- Udhëzimi MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së} e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Prokurimit Publik miratuar me vendimin nr. 5, datë 29.12.2022 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Institucionit të Agjencisë së Prokurimit Publik”.

8) Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- INTOSAI – P - 1 “Deklarata e Limës”;
- INTOSAI – P – 10 - 99 “Parimet themelore të INTOSAI”;

- INTOSAI – P - 10 “*Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAP*”;
- INTOSAI – P - 12 “*Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve*”;
- INTOSAI – P - 20 “*Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies*”;
- INTOSAI – P - 50 “*Parimet e juridiksionit të SAP*”;
- ISSAI 100 - 129 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”;
- ISSAI 2000 - 2899 “*Standardet e Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 400 “*Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë*”;
- ISSAI 4000 “*Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë*”;
- ISSAI 2705 “*Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*”;
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020.

9) Metodatat e auditimit

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 0.7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përlllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin e Agjencisë së Prokurimit publik, niveli i materialitetit për vitin 2022 rezultoi në vlerën 1,169 mijë lekë.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) *hartimit*; (b) *implementimit*; dhe (c) *funksionimit* të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri në të moderuar.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të

metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të APP-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

10) Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me Akt Konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

Nga ana e audituesve të KLSH janë dorëzuar zyrtarisht aktet e konstatimit në institucionin e Agjencisë së Prokurimit Publik, me datën 29.01.2024. Nga ana e strukturave të APP-së, pas analizimit të akt konstatimeve janë dërguar komentet, me shkresën nr. 8974/8 prot, datë 02.02.2024, (protokolluar në KLSH me nr. nr. 1037/3 prot., datë 02.02.2024).

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Agjencia e Prokurimit Publik mbikëqyr sistemin e prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efikasitetit dhe transparencës në procesin e prokurimit publik. Agjencia e Prokurimit Publik është person juridik, institucion qendror në varësi të Kryeministrit, që financohet nga buxheti i shtetit. Misioni i Agjencisë së Prokurimit Publik është përgatitja e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura; Verifikimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës dhe në rast shkeljesh të dispozitave ligjore dhe nënligjore, vendosja e gjobave ose propozimin e marrjes së masave administrative; Monitorimi i mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, si dhe zbatimin e masave dhe aktivitetëve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private; Hartimi dhe nxjerrja e Buletinit të Njoftimeve Publike; Përrjashtimi i operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionare apo të ankandit publik për një periudhë nga një deri në tre vjet; Nxitja dhe organizimi i kualifikimit të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Veprimtaria e Agjencisë së Prokurimit Publik

2.1.1. *Mbi verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës” si dhe “Mbi sigurimin e transparencës, bashkëpunimit me të tretët, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik, me entet e tjera për zbatimin e standardeve kombëtare në përgatitjen e specifikimeve teknike nga autoritet kontraktore, me organet e auditimit publik, si: KLSH, strukturat e Auditimit Brendshëm, Inspektimin financiar mbi shqyrtimin e raporteve audituese të paraqitura prej tyre.*

Në zbatim të pikës 1, të programit “Për verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës ”u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullore e brendshme e Agjencisë së Prokurimit Publik, miratuar me vendim nr.14, datë 13.9.2018 (e ndryshuar).
2. Rregullore e brendshme nr.10, datë 19.01.2018“Mbi procedurat e përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike/procedurat e koncesioneve dhe ankandëve publike” (e ndryshuar)
3. Rregulloren e brendshme “Për procedurat e verifikimit” miratuar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të APP-së nr.11, datë 19.01.2018,(ndryshuar me vendim nr.05, datë 22.5.2019,me rregullore nr.01, datë 23.06.2021, dhe rregullore nr.02 prot, datë 27.09.2022
4. Urdhër i Kryeministrit nr.34, datë 17.3.2022, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, (i ndryshuar)
5. Plan Verifikimi nr.7459/1 prot., dt.20.11.2020.
6. Plan Verifikimi nr.7301/01 prot., datë 25.11.2021
7. Plan Verifikimi nr.7301/1 prot., datë 25.11.2021.
8. Plan Verifikimi nr.7931prot., datë 15.11.2022.
9. Plan Verifikimi, me nr.5707 prot., datë 24.7.2023.
10. 25 praktika vendimmarrjesh të Sektorit Ligjor dhe Shqyrtimit të Kërkesave për Përjashtim

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, mbi verifikimet e kryera nga APP dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e procedurave objekt verifikimi, të dhëna mbi rezultatet e verifikimeve, gjobave dhe propozimeve për marrjen e masave administrative, rezultoi si më poshtë:


Agjencia e Prokurimit Publik në cilësinë e rregullatorit të sistemit të prokurimit publik kryen në mënyrë të vazhdueshme verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës. Ky proces përfshin verifikimin e hapave të ndjekur nga autoritetet/entet kontraktore/shitëse në zhvillimin e procedurave, duke synuar ndërgjegjësimin e tyre për zbatimin me rigorozitet të legjislacionit për prokurimet publike.

Në bazë të ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 23, në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, APP merr masa administrative sipas parashikimeve ligjore ose i propozon drejtuesit të autoritetit ose entit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat e autoriteteve ose enteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje, si dhe merr masa për përjashtim të operatorit ekonomik nga e drejta për të përfituar kontrata publike.

Nëpërmjet procesit hetimor/verifikimit, APP nuk ka për qëllim vetëm penalizmin e personave, të cilët rezultojnë të kenë kryer veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit, por edhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për shmangien e problematikave të evidentuara dhe përmirësimin e procesit në të ardhmen.

Deri në muajin mars të vitit 2022, verifikimi i procedurave të prokurimit kryhej nga Sektori i Verifikimit të Procedurave, në varësi të Drejtorisë Juridike, Verifikimit dhe Integritit, bazuar në rregulloren e brendshme të APP-së nr.05, datë 22.5.2019, “Për procedurat e verifikimit”, ndryshuar me rregullore nr.01, datë 23.06.2021.

Me riorganizimin dhe strukturën e re institucionale, miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 149, datë 28.12.2021, është krijuar Sektori i Monitorimit të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, i cili përbëhet nga një përgjegjës dhe dy inspektorë. Sipas kësaj strukture Drejtoria Juridike dhe Monitorimit të Procedurave përbëhet nga tre sektorë sipas skemës si më poshtë:



Referuar rregullores së brendshme nr.02 prot, datë 27.09.2022 “Për Procedurat e Verifikimit”, procesi i hetimit administrativ, kryhet nga Sektori i Monitorimit të Procedurave të Prokurimit, si dhe Sektori i Monitorimit të Koncesioneve/PPP dhe Procedurave në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Procesi i verifikimit inicohet përgjithësisht mbi këto baza:

- Kryesisht, me nismën e APP, nëpërmjet hartimit të planeve të verifikimit;
- Reklamim nga të tretët;
- Indicie nga raportet e organeve audituese, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), KLSH etj;
- Raste të evidentuara nga publikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Buletini i Njoftimeve Publike apo vetë APP nëpërmjet komunikimit shkresor me autoritetet/entit kontraktore.

Në rastet kur, procesi kryhet me nismën e APP-së, Sektorët e Verifikimit hartojnë planet e verifikimit dhe i konfirmojnë te Drejtori i Drejtorisë përkatëse dhe miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm. Në çdo rast tjetër kur hetimi inicohet në bazë të indicieve nga të tretët, Drejtori i Përgjithshëm i përcjell praktikën Drejtorit të Drejtorisë.

Plani i verifikimit përmban objektin, bazën ligjore, qëllimin e planit, metodat dhe indikatorët mbi bazë të së cilave kryhet përzgjedhja e procedurave të përfshira në plan si dhe periudha e zbatimit të tij. Përzgjedhja e procedurave të prokurimit për përfshirjen e tyre në planin e verifikimit kryhet duke u bazuar në llojin e procedurës, vlerën e fondit limit, objektin e prokurimit, vlerën e kursyer, shpeshësinë e kontrollit të autoritetit/entit kontraktor përkatës etj.

Bazuar në vendimin nr. 12, datë 29.9.2021 “Për miratimin e gjurmëve të Auditit”, APP ka miratuar gjurmën e auditit për trajtimin e vendimeve të verifikimit, ku përcaktohet në mënyrë të detajuar procesi i verifikimit, strukturat përgjegjëse dhe aktivitetet e kontrollit.

➤ **Mbi veprimtarinë e Sektorit të Monitorimit të Procedurave të Prokurimit për periudhën objekt auditimi.**

1. Të dhëna mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për vitin 2021.

1.1. Verifikimi i procedurave ku hetimi administrativ është iniciuar kryesisht.

Sektor i Monitorimit të Procedurave të Prokurimit ka hartuar plan verifikimi me nr.7459/1 prot, dt.20.11.2020, me objekt “Zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore gjatë periudhës 2019-2020”. Në këtë plan janë përfshirë 28 procedura prokurimi, të cilat kanë qenë objekt denoncimesh (*me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike*), me qëllim nisjen e hetimit administrativ nga APP, për shkelje e parregullsi në kryerjen e procedurave nga autoritetet përkatëse.

Pas evidentimit të shkeljeve/mangësive, si dhe shqyrtimit dhe analizimit të kundërshtimeve të paraqitura nga autoritetet kontraktore, ka vijuar me përgatitjen dhe nxjerrjen e vendimeve përkatëse përfundimtare, sipas parashikimeve të LPP. Procedurat kanë qenë të llojit “E hapur”, “Kërkesë për propozim” dhe “Procedure prokurimi me vlerë të vogël”.

Në përfundim të verifikimit të gjithë procedurave të prokurimit të përfshira në Plan, është përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të Internetit të APP, njoftimi nr.7459/4 prot, datë 25.05.2021, në të cilin, duke marrë shkas nga shkeljet dhe mangësitë që ka evidentuar në procedurat e verifikuara, ka sjellë në vëmendje të të gjithë autoriteteve kontraktore të mbajnë në konsideratë rekomandimet e dhëna në këtë njoftim, me qëllim mirë-zbatimin në vijim të dispozitave ligjore të prokurimit.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, është miratuar Plani i Verifikimit nr.7301/01 prot, datë 25.11.2021, me fokus 16 autoritete kontraktore. Në hartimin e këtij plani është mbajtur në konsideratë rekomandimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për përfshirje të procedurave, për të cilat autoritetet kontraktore nuk kanë reaguar ndaj rekomandimeve të dhëna nga APP, gjatë fazës së publikimit të dokumenteve të tenderit për problematika që lidhen me kriteret e kualifikimit.

Në këtë plan janë përfshirë edhe procedura të denoncuar nga operatorë ekonomikë, pretendimet e të cilëve shërbejnë si indicie për verifikim të zbatimit të ligjshmërisë.

Përzgjedhja e procedurave është bazuar kryesisht në natyrën e kontratës, duke përfshirë të tre llojet: punë, mallra dhe shërbime, si dhe vlerën e fondit limit.

1.2. Verifikimi i drejtpërdrejtë i procedurave të reklamuar nga operatorë ekonomikë.

Gjatë këtij viti, ky Sektor ka kryer verifikim të procedurave të prokurimit, që janë përfunduar me nënshkrim kontrate dhe që janë denoncuar në APP nga operatorë ekonomikë përmes Portalit të Bashkëqeverisjes. Konkretisht, ka përfunduar hetimi administrativ dhe APP ka dalë me vendimet dhe trajtimet përkatëse për 7 autoritete kontraktore, sa i takon zbatimit të ligjshmërisë së 8 procedurave të prokurimit, nga të cilat gjashtë prokurime me vlerë të vogël dhe dy të llojit “Kërkesë për propozim”.

Në përfundim të verifikimit, pra shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosje si dhe pretendimeve të denoncuesve për këto procedura, APP ka dalë me vendimet përkatëse të arsyetuara.

Procedurat e denoncuar nga operatorët ekonomikë i përkasin kryesisht prokurimeve me vlerë të vogël, duke qenë se ligji i mëparshëm i prokurimit publik dhe që ka qenë në fuqi në kohën e zhvillimit të tyre, nuk parashikonte proces ankimi. Gjithashtu, këto lloj procedurash, për nga mënyra e zhvillimit të tyre dhe fondit limit, konsiderohen të thjeshtuara dhe si të tilla pjesëmarrja e operatorëve në to është relativisht e lartë dhe si rrjedhim edhe konkurrenca ndërmjet tyre.

1.3 Verifikimi i procedurave të përcjella për kompetencë në APP, nga institucione të tjera.

Sektor ka nisur hetim administrativ edhe për disa raste të propozuara nga Komisioni i Prokurimit Publik. Gjatë kësaj periudhe, kanë qenë subjekt verifikimi 9 autoritete kontraktore për 9 procedura

prokurimi, nga të cilat 3 janë të llojit “E hapur”, 4 janë “Kërkesë për propozim”, 1 është “E kufizuar”, si dhe 1 procedurë është “E hapur e Thjeshtuar”. Objekt i ankesave lidhet me problematika të llojit si:

- mos respektimin e afateve të ankimit nga ana e autoriteteve kontraktore,
- veprimet në sistemin e prokurimit elektronik,
- konfliktin e interesit dhe pretendime për çënim të fshehtësisë së procesit.

Për sa më sipër, Sektori ka administruar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm nga autoritetet kontraktore që kanë zhvilluar procedurat e prokurimit, dhe në përfundim të procesit ka dalë me vendimet përkatëse të arsyetuara.

1.4. Verifikimi i procedurave të prokurimit që kanë si objekt administrimin e mbetjeve spitalore.

Në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së autoriteteve kontraktore, lidhur me zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për administrimin e mbetjeve spitalore gjatë periudhës 2020-2021, është ngritur në muajin Korrik një grup pune i përbashkët me Departamentin e Antikorrupsionit në Kryeministri, në të cilin janë përfshirë edhe specialistë të Sektorit të Verifikimit të Procedurave, për të vlerësuar zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit, të zhvilluara për lidhjen e kontratave në fjalë.

Në këtë kuadër, është kryer verifikim ndaj 10 institucioneve spitalore, në cilësinë e autoriteteve kontraktore, për 10 procedura prokurimi, në përfundim të të cilit janë përgatitur gjetjet e evidentuara dhe rekomandimet përkatëse mbi bazën e këtyre gjetjeve.

Në formë tabelore, të dhëna mbi verifikimet e kryera dhe të përfunduara nga APP gjatë vitit 2021:

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	41 <i>(duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi për disa procedura)</i>		
Vendime të nxjerra nga APP, me masa penalizuese	33		
Tërheqje vëmendje dhe orientim i përgjithshëm/mbyllje hetimi	9		
Procedura prokurimi të verifikuara	Procedura për punë publike	Procedura për mallra	Procedura për shërbime
(Total)	8	26	10
44			

Burimi: APP

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	6
Procedurë e kufizuar	1
Procedurë kërkesë për propozim	12
Procedurë e hapur e thjeshtuar	1
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	24
TOTALI	44

Burimi: APP

Gjithashtu, në formë tabelore të dhëna mbi verifikimet e kryera në kuadër të kontrollit për administrimin e mbetjeve spitalore, gjatë vitit 2021:

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	10
Procedura prokurimi të verifikuara	10

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	5
Procedurë kërkesë për propozim	5
TOTALI	10

Burimi: APP

Të dhëna totale mbi verifikimet e kryera gjatë vitit 2021:

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	50
<i>(duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi për disa procedura)</i>	
Procedura prokurimi të verifikuara	54

Burimi: APP

1.5 Verifikim i gjetjeve në raportet e organeve audituese, të dërguara në APP.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera audituese si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe Auditit të brendshme të institucioneve, APP ka administruar raportet e tyre përfundimtare për vlerësim të gjetjeve që lidhen me prokurimet publike.

Gjatë këtij viti, Sektori ka nisur verifikimin për gjetjet e pasqyruara në 11 raporte auditimi, ku subjekt auditimi kanë qenë 18 autoritete kontraktore. Nga raportet e auditimit, janë verifikuar në total gjetjet për 83 procedura prokurimi/objekte/raste auditimi, gjetje të lidhura me kontrata shtesë, si dhe konstatime të përgjithshme të lidhura me kërkesa të legjislacionit të prokurimit publik. Për një prej raporteve në fjalë, janë verifikuar gjetjet e evidentuara ndaj 8 autoriteteve kontraktore lidhur me shërbimin e transportit për mësuesit dhe nxënësit, të siguar nga këto autoritete gjatë viteve 2019-2020. Pas përfundimit të procesit verifikues janë marrë vendimet përkatëse me masat penalizuese. Në formë tabelore, të dhëna mbi numrin e raporteve me gjetjet e shqyrtuara, sipas organeve audituese:

Institucioni auditues	Numri i raporteve
K Kontrolli i Lartë i Shtetit	5
Audite të Brendshme të Institucioneve	4
Drejtoria e Inspektimit Financiar	1
Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar për Antikorrupsionin	1
TOTALI	11

Burimi: APP

Në formë tabelore, të dhëna mbi llojet e procedurave të prokurimit të trajtuara në raportet e organeve audituese, gjetjet e të cilave janë trajtuar nga APP:

Lloji i procedurës së prokurimit/objektit të auditimit	Numri
Procedurë e hapur	26
Kërkesë për propozim	22
Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	3
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	21
Objekte të realizuara pa procedurë prokurimi	11 (raste)
TOTALI	83

Burimi: APP

1.6 Masa administrative të vendosura nga APP, në kuadër të procesit të verifikimit

Në formë tabelore, paraqiten të dhënat përmblendhëse mbi masat administrative (gjobë, masë disiplinore) të vendosura nga APP, në përfundim të verifikimeve, gjatë vitit 2021:

Gjobë	102 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi
Propozim për masë disiplinore	145 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Burimi: APP

II Të dhëna mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për vitin 2022

II.1 Verifikimi i procedurave ku hetimi administrativ është iniciuar kryesisht.

Gjatë këtij viti, Sektori ka përfunduar verifikimin e procedurave të prokurimit, objekt i Planit të Verifikimit të nisur në fund të vitit 2021, me nr.7301/1 prot., datë 25.11.2021. Subjekt i planit ishin 16 autoritete kontraktore, në të cilin përfshiheshin procedura prokurimi të llojit “E hapur”, “Kërkesë për propozim” dhe “E hapur e thjeshtuar”. Në hartimin e këtij plani, u morën në konsideratë autoritete kontraktore, të cilët nuk kanë reaguar/reflektuar mbi rekomandimet e dhëna nga APP në fazën e publikimit të procedurës. Kryerja e verifikimit “ex post” të procedurave për autoritetet që nuk reagojnë në këtë fazë të procedurës, është rekomanduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Duke qenë se, njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë) janë në mënyrë të vazhdueshme objekt auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe gjetjet e evidentuara dërgohen si indicie për verifikim në APP, në këtë plan u përzgjedhën kryesisht institucione në varësi të tyre dhe institucione të tjera. Përzgjedhja e procedurave është bazuar kryesisht në natyrën e kontratës, duke përfshirë të tre llojet: punë, mallra dhe shërbime, si dhe vlerën e fondit limit.

Gjithashtu, subjekt i këtij plani ishin edhe autoritete kontraktore, për procedurat e të cilave ka pasur denoncim në APP nga operatorë ekonomikë. Dy procedura prokurimi janë përfshirë në plan, në bazë të indicies së vetë APP, për njërën prej të cilave është marrë shkas nga një vendim i KPP, sipas të cilit rezulton se, operatori ekonomik ankues ka hequr dorë nga ankesa e bërë për kriteret e kualifikimit, ndërkohë që procedura është me vlerë të konsiderueshme të fondit limit.

Në përfundim të hetimit administrativ të procedurave objekt verifikimi, APP ka dalë me vendimet përkatëse, me masat administrative, në varësi të shkeljeve dhe pasojave të ardhura prej tyre.

Nëpërmjet njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, me lëndë “Sjellje në vëmendje”, drejtuar të gjithë autoriteteve kontraktore, APP ka vënë theksin te respektimi i dispozitave ligjore të prokurimit, duke u bazuar në shkeljet dhe mangësitë e rezultuara nga verifikimi i procedurave të prokurimit, objekt i planit të verifikimit, me qëllim shmangien e tyre nga autoritetet kontraktore, në të ardhmen.

Gjithashtu, në fund të këtij viti, është miratuar Plani i Verifikimit nr.7931prot, datë 15.11.2022 me fokus 12 autoritete kontraktore. Në këtë plan u përfshinë procedura prokurimi me vlerë të vogël të denoncuar në APP nga operatorë ekonomikë, të cilët kishin kërkuar kryerjen e hetimit administrativ nga APP, për mosrespektim të legjislacionit të prokurimit publik në zhvillimin e procedurave përkatëse.

Në hartimin e këtij plani është mbajtur në konsideratë edhe fakti se stafi i Sektorit të Monitorimit të Procedurave të Prokurimit ka qenë i reduktuar, në vetëm një inspektor, nga tre që parashikonte organika. Për këtë arsye, Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore ka dërguar kërkesën për shpallje të pozicioneve vakante në Departamentin e Administratës publike me shkresë nr.1271/5 prot, datë 03.03.2022 dhe shkresë nr. 6053prot, datë 07.09.2022.

II.2 Verifikimi i drejtpërdrejtë i procedurave të reklamuar nga operatorë ekonomikë.

Gjatë këtij viti, Sektori ka vijuar njëkohësisht me verifikimin e disa procedurave prokurimi që kanë pasur si objekt “Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar”, të zhvilluara nga 7 autoritete kontraktore. Verifikimi nisi si rezultat i denoncimit nga një operator ekonomik në Platformën e Bashkëqeverisjes. Pretendimet e parashtruara lidheshin me kriteret e veçanta të kualifikimit, të hartuara për këto procedura nga autoritetet subjekt denoncimi. Objekt i verifikimeve në fjalë ishin gjithsej 30 procedura prokurimi.

Përveç problematikave të evidentuara lidhur me kriteret e kualifikimit, gjatë verifikimit të procedurave në fjalë dhe komunikimit me autoritetet përkatëse, u vërejtën disa paqartësi nga ana e këtyre të fundit lidhur me publikimin e procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe mënyrën e administrimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, të kërkuar nga autoriteti kontraktor, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë. Në këtë kuadër, u pasqyruan detajime të mëtejshme të procesit në udhëzimin përkatës mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror

ndërkombëtar.

Në përfundim të hetimit administrativ, APP ka dalë me vendim për 7 autoritete kontraktore, pas denoncimeve të paraqitura. Për çdo rast të hetimeve të kryera për procedura prokurimi me indicie nga të tretë, një kopje e vendimit të marrë në përfundim të hetimit, i është dërguar njëkohësisht edhe subjektit denoncues.

II.3 Verifikimi i procedurave të përcjella për kompetencë në APP, nga institucione të tjera.

Përveç sa më sipër, në disa raste KPP i ka propozuar APP-së, nisjen e hetimit administrativ, në vendimet e marra gjatë trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë në procedura të ndryshme prokurimi. Gjatë këtij viti, kanë qenë subjekt verifikimi 5 autoritete kontraktore lidhur me 5 procedura prokurimi të hapura, njëra prej të cilave me dy lote objekt verifikimi.

Pas administrimit të dokumentacionit provues nga autoritetet kontraktore që kanë zhvilluar procedurat e prokurimit, APP ka shqyrtuar, vlerësuar dhe ka shprehur qëndrimin e saj përmes vendimmarrjes përkatëse.

Gjatë këtij viti, APP ka bashkëpunuar me strukturën e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, për hetim administrativ të kryer ndaj 1 autoriteti kontraktor, lidhur me 5 objekte prokurimi, nëpërmjet një grupi të përbashkët pune. Përfshirja e punonjësve të APP në këtë grup pune, u bë pas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në pikat 5, 6 dhe 7 të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”.

Në vijim, në formë tabelore, paraqiten të dhëna mbi verifikimet e kryera dhe të përfunduara gjatë vitit 2022:

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	34 <i>(duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi për më shumë se një procedurë)</i>		
Vendime të nxjerra nga APP, me masa penalizuese	27		
Tërheqje vëmendje dhe orientim i përgjithshëm/mbyllje hetimi	8		
Procedura prokurimi/raste të verifikuara	Procedura për punë publike	Procedura për mallra	Procedura për shërbime
(Total)	5	42	12
59			

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	18
Procedurë kërkesë për propozim	8
Procedurë e hapur e thjeshtuar	2
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	1
Sistemi dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar	30
TOTALI	59

Burimi: APP

II.4 Verifikim i gjetjeve në raportet e organeve audituese, të dërguara në APP.

Gjatë vitit 2022, pranë APP-së, janë përcjellë raportet përkatëse të auditimit nga institucionet audituese në vend, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Auditimi i Brendshëm i Ministrisë së Kulturës.

Në këtë kuadër, është përfunduar verifikimi i gjetjeve të pasqyruara në 8 raporte auditimi, ku subjekt auditimi kanë qenë 8 autoritete kontraktore, për 118 procedura prokurimi, si dhe për konstatime të përgjithshme të evidentuara në këto raporte. Në përfundim të verifikimit, APP ka dalë me vendime për masa penalizuese.

Në vijim, në formë tabelore, paraqiten të dhëna mbi llojet e procedurave të prokurimit të përfshira në raportet e auditimit, gjetjet e të cilave janë trajtuar nga APP:

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	27
Kërkesë për propozim	28
Negociim pa shpallje	3
Konkurs projektimi	1
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	56
Sistemi dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar	3
TOTALI	118

Burimi: APP

II.5 Masa administrative të vendosura nga APP, në kuadër të procesit të verifikimit

Në formë tabelore, paraqiten të dhënat përmbledhëse mbi masat administrative (gjobë, masë disiplinore) të vendosura nga APP, në përfundim të verifikimeve, gjatë vitit 2022:

Gjobë	130 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi
Propozim për masë disiplinore	95 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Burimi: APP

III. Të dhëna mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për periudhën Janar – 27 Dhjetor 2023

III.1 Verifikimi i procedurave ku hetimi administrativ është iniciuar kryesisht.

1. Së pari, është përfunduar verifikimi i procedurave të prokurimit, objekt i Planit të Verifikimit me nr. 7931 prot, datë 15.11.2022, të nisur në fund të vitit 2022, Konkretisht, subjekt i planit në fjalë të verifikimit ishin 12 autoritete kontraktore për procedura prokurimi me vlerë të vogël, të cilat janë denoncuar nga operatorë ekonomikë.

2. Së dyti, në muajin Korrik është miratuar një tjetër plan verifikimi, me nr.5707 prot, datë 24.7.2023, me fokus katër drejtime. Konkretisht:

2.1 Mbi monitorimin e procesit të planifikimit të nevojave dhe realizimit të tyre në kohë.

APP ka vlerësuar si domosdoshmëri bazuar në të dhënat e raporteve vjetore, si dhe raporte të organizmave ndërkombëtarë, vlerësimin e situatës për sa i takon procesit të planifikimit nga autoritetet/entet kontraktore të nevojave të tyre dhe finalizimit në kohë të procedurave të prokurimit.

Sektori i Monitorimit të Procedurave të Prokurimit pasi administroi informacion nga Sektori i Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Statistikave të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik sa i takon regjistrin të parashikimeve për vitin 2022, vlerësoi të përfshijë në planin e saj të verifikimit 50 autoritete kontraktore, të cilat rezultuan jo vetëm me numrin më të lartë të elementëve të regjistrin të përfshijë, respektivisht për gjashtë-mujorin e parë (Janar – Qershor) dhe të dytë (Korrik – Dhjetor) të vitit 2022, por njëkohësisht rezultuan edhe të përsëritur në të dy gjashtë-mujorët.

2.2 Mbi analizimin e situatës lidhur me argumentimin konkret të specifikimeve teknike/kritereve të kualifikimit në procesverbalin përkatës.

Sektori mori në analizë informacionin e dërguar nga Sektori i Koordinimit me të dhënat e procedurave përkatëse të prokurimit, për të cilat, autoritetet nuk kanë argumentuar në procesverbal specifikimet dhe secilin prej kritereve të vendosura. Lista me të dhëna përfshinte 13 autoritete kontraktore lidhur me 19 procedura prokurimi.

2.3 Mbi monitorimin e procedurave të denoncuar nga operatorë ekonomikë.

Në planin në fjalë të verifikimit janë përfshirë 6 autoritete kontraktore për procedura prokurimi mbi kufirin monetar të procedurave me vlerë të vogël, duke qenë se, këto të fundit kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme objekt verifikimi.

2.4 Mbi raste të administruara në institucion, si rezultat i komunikimeve të institucionit me

autoritete kontraktore.

Së fundmi, në plan janë përfshirë edhe raste të administruara në institucion nga 2 autoritete kontraktore, të cilat përbëjnë indicie për verifikim.

III.2 Verifikimi i procedurave të përcjella për kompetencë në APP, nga institucione të tjera.

Gjatë kësaj periudhe, është përfunduar trajtimi për konstatime në vendimet e KPP-së, për 12 autoritete kontraktore lidhur me 13 procedura prokurimi. Gjithashtu, në kuadër të komunikimit shkresor të institucionit me dy autoritete kontraktore dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të këtij komunikimi, janë vërejtur problematika të autoriteteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave. Për të dy autoritetet subjekt hetimi janë përgatitur gjetjet dhe pasi janë dërguar kundërshtimet përkatëse, APP ka dalë me vendimet përfundimtare.

Në vijim, në formë tabelore, paraqiten të dhëna mbi verifikimet e kryera dhe të përfunduara gjatë periudhës Janar – 27 Dhjetor 2023:

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	(43) <i>(duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi për më shumë se një procedurë)</i>		
Vendime të nxjerra nga APP, me masa penalizuese	24		
Tërheqje vëmendje dhe orientim i përgjithshëm/ mbyllje hetimi	21		
Procedura prokurimi të verifikuara	Procedura për punë publike	Procedura për mallra	Procedura për shërbime
(Total)	13	33	10
56			

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	25
Procedurë e kufizuar	3
Kërkesë për propozim	3
Procedurë e hapur e thjeshtuar	12
Me negociim pa shpalle paraprake te njoftimit te kontrates	1
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	12
TOTALI	56

Burimi: APP

III.3 Verifikim i gjetjeve në raportet e organeve audituese, të dërguara në APP.

Gjatë kësaj periudhe, pranë APP-së janë përcjellë raportet përkatëse të auditimit nga institucionet audituese në vend, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore. Në këtë kuadër, janë marrë në shqyrtim gjetjet për procedurat e prokurimit të audituara, të përfshira në këto raporte. APP ka përfunduar verifikimin e gjetjeve të pasqyruara në 5 raporte auditimi, ku subjekt auditimi kanë qenë 5 autoritete kontraktore, lidhur me 89 procedura prokurimi. Në përfundim të verifikimit, APP ka dalë me vendime për masa penalizuese.

Në vijim, në formë tabelore, paraqiten të dhëna mbi llojet e procedurave të prokurimit të përfshira në raportet e auditimit, gjetjet e të cilave janë trajtuar nga APP:

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	42
Kërkesë për propozim	4
E hapur e thjeshtuar	2
Shërbim konsulence	2
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	39
TOTALI	89

Burimi: APP

III.4 Masa administrative të vendosura nga APP, në kuadër të procesit të verifikimit

Në formë tabelore, paraqiten të dhënat përmbledhëse mbi masat administrative (gjobë, masë disiplinore) të vendosura nga APP, në përfundim të verifikimeve, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023:

Gjobë	77 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi
Propozim për masë disiplinore	75 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Burimi: APP

➤ Mbi veprimtarinë e Sektorit të Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve dhe Procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

APP e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, Ligjit nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Spektori i verifikimit të procedurave të koncesioneve/PPP, dhe procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare në Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit të Procedurave, kryen hetim administrativ, nëpërmjet verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/PPP, ankandit publik dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë pas fazës së nënshkrimit të kontratës, por në çdo rast jo më vonë se 3 vjet nga nënshkrimi i saj.

APP fokuson procesin e verifikimit në evidentimin e problematikave, që lidhen me aspektin procedural dhe kryesisht me:

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së koncesionit/PPP
- hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për ofertuesit;
- shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura;
- respektimin e kërkesave të tjera procedurale.

Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë në fushën e Koncesioneve/PPP

Në bazë të nenit 11, shkronja “a”, të ligjit nr.125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, **Agjencia e Prokurimit Publik** kryen detyrat e mëposhtme:

“Monitoron respektimin e procedurave konkurruese të koncesioneve /partneriteteve publike private, sipas legjislacionit për prokurimet publike, pas nënshkrimit të kontratës dhe, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjopa ose propozon marrjen e masave administrative”;

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 149, datë 28.12.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, në strukturën e APP-së është shtuar Spektori i Monitorimit të Koncesioneve/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Referuar organikës së APP të miratuar me urdhrin e sipërcituar, Spektori përbëhet nga tre punonjës: Përgjegjësi i Sektorit dhe 2 Inspektorë. Plotësimi i pozicionit të punës së Përgjegjësit të Sektorit dhe njërit prej inspektorëve është kryer respektivisht në datën 11.08.2022 dhe 01.03.2022, ndërsa pozicioni tjetër i punës është ende vakant.

Lidhur me aktivitetin e këtij sektori, pas administrimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit u konstatua si më poshtë:

-Referuar informacionit të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve/PPP, dërguar në formë elektronike APP-së në datë 18 korrik të vitit 2023, dhe vënë në dispozicion grupit të auditimit, për procedurat koncesionare që janë finalizuar me nënshkrim kontrate, rezultoi se:

-Për vitin 2021, është nënshkruar kontrata koncesionare datë 30.7.2021 me objekt: “*Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i një porti turistik në qytetin e Vlorës*”, me autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

-Për vitin 2022, është nënshkruar kontratë koncesionare me datë 29.04.2022 me objekt “*Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje e “Portit të Integruar”*”, në Triport Vlorë.

- Kontratat e mësipërme janë publikuar në faqen e regjistrimit elektronik të koncesioneve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 rezultojnë edhe procedura të tjera koncesionare /PPP, por nga komunikimi elektronik (*datë 18 korrik 2023*) midis ATRAKO dhe APP u konstatua se:

Sipas ATRAKO, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka përcjellë kontratat koncesionare te Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, në bazë të detyrimit ligjor që ka sipas VKM nr.211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrimit elektronik të koncesioneve/PPP”. Në mungesë të këtij informacioni nga ana e APP-së, nuk mund të vijohej me përfshirjen e ndonjëres prej kontratave në një plan verifikimi.

Megjithatë nga data 18 korrik 2023, data e fundit e komunikimit elektronik midis APP-së dhe ATRAKO, nuk ka patur komunikim tjetër midis tyre. Për sa më sipër, është e domosdoshme që APP të ketë një komunikim të vazhdueshëm me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve lidhur me përditësimin e informacionit për kontratat koncesionare .

Procedurat koncesionare të vitit 2022, për të cilat nuk ka informacion nëse janë finalizuar me nënshkrim kontrate, sipas komunikimit elektronik (*datë 18 korrik 2023*), janë si më poshtë:

-Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Milot-Thumanë”

-Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Kashar-Pezë-Lekaj”

- Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Lekaj-Konjat-Fier”.

Ndërsa, për vitin 2023 rezulton se për procedurat koncesionare , nuk ka ende fitues të shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Për sa më sipër, për periudhën 2021-2023 janë finalizuar me nënshkrim kontrate 2 procedura dhe nga ana e sektorit të monitorimit të koncesioneve është përzgjedhur për verifikim procedura me vlerën më të lartë të fondit limit. Gjithashtu procesi i përzgjedhjes është kushtëzuar nga fakti se ky sektor ka kapacitet të kufizuar në burime njerëzore pasi ende nuk është plotësuar pozicioni i punës “inspektor”. Pra , nga 1 (një) përgjegjës dhe 2 (dy) inspektor që parashikon struktura aktualisht vazhdon të jetë një përgjegjës dhe një inspektor. Rezulton të jenë kryer procedurat për shpalljen e vendit vakant por nuk është paraqitur asnjë kërkesë për këtë pozicion pune.

Pra, sektori i monitorimit të koncesioneve/PPP, ankandeve publike dhe procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes, për periudhën objekt auditimi (2021-2023) ka hartuar një plan verifikimi me nr.6452/1 prot, datë 21.8.2023, me objekt: Verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën koncesionare “*Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje e “Portit të Integruar”*”, në Triport Vlorë, dhe përmes shkresës nr.6511 prot, datë 23.08.2023, APP ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e hetimit administrativ për këtë kontratë koncesionare.

Nga i njëjti informacion i dërguar APP-së nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve në e-mailin e datës 18 korrik 2023 rezultoi se, për vitin 2020 është nënshkruar kontrata koncesionare datë 20.4.2020 me objekt: “*Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës*”, me Autoritet Kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kontratë e cila nuk ka qenë objekt verifikimi nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Sipas pikës 1, të nenit 65 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) (*ligji në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës*)

“*Agjencia e Prokurimit Publik verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 2 vjet nga nënshkrimi i saj*”

Pra, në rast se do të vlerësohej për verifikim kjo kontratë koncesionare , afati i verifikimit të saj do të shtrinte deri në prill të vitit 2022.

Konstatohet se, gjatë vitit 2020 nuk është verifikuar ndonjë kontratë koncesionare , për arsye të

situatës së pandemisë, trajtuar në analizën vjetore të APP-së të vitit 2020⁵, por edhe gjatë periudhës 2021-2022, sërisht nuk është kryer ndonjë verifikim kontrate, pasi sipas APP-së, struktura e këtij sektori ka qenë e paplotë dhe nuk ka pasur një plan trajnimi për stafin lidhur me procedurat koncesionare. Nga komunikimi me subjektin, rezultoi se nuk ka një kërkesë zyrtare të APP-së drejtuar institucioneve përgjegjëse, për nevojat që ka për trajnime të stafit të saj lidhur me procedurat koncesionare .

Në kuadër të Urdhrit nr.6, datë 17.01.2023 të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”, është krijuar grupi ndërinstitucional i punës për rishikimin e ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, për të garantuar përputhshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian.

Në përbërje të grupit të punës, ndër të tjerë, janë edhe dy përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në këtë kuadër, APP si pjesë e grupit të punës për hartimin e ligjit të ri të koncesioneve/PPP, por edhe në cilësinë e institucionit drejtues të Kapitullit V “Prokurimi Publik”, ka punuar me ekspertë të Sigmas për draftimin e pjesës procedurale të këtij akti, me qëllim përafrimin e tij me Direktivën përkatëse të BE-së.

Për këtë arsye, me e-mail-in e datës 18.09.2023, APP ka percjellë komentet dhe qëndrimet e saj lidhur me draftin paraprak të hartuar nga eksperti i SIGMA-s. Gjithashtu, nga APP janë shtruar edhe disa çështje, me qëllim bërjen e tyre objekt diskutimi dhe vlerësimi nga grupi i punës.

Një ndër çështjet që është parashtruar nga APP, është edhe ajo që lidhet me kompetencën për monitorimin e respektimit të procedurave konkurruese të koncesioneve /partneriteteve publike private, pas fazës së nënshkrimit të kontratës; kompetencë e përcaktuar në nenin 11, germa “a”, të ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

Vlersimi i APP-së është që kjo kompetence t’i kalojë ATRAKO-s, për arsyet si më poshtë:

1. Referuar VKM-së nr.150, datë 22.3.2007 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së trajtimit të koncesioneve (ATRAKO)”, por edhe nenit 12, të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, ATRAKO e ushtron veprimtarinë e saj vetëm në fushën e koncesioneve/PPP. Në këto kushte, ATRAKO është krijuar si institucion me njohuri të specializuara në këtë fushë.

2. Ndërkohë, APP ka një fushë të gjerë veprimtarie, ku përveç kompetencave mbikëqyrëse të sistemit të prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efikasitetit dhe transparencës në procesin e prokurimit, ka edhe kompetenca monitoruese në fushën e ankandit publik dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

3. Kontratat koncesionare janë mjaft komplekse dhe për monitorimin e tyre nevojitet staf i kualifikuar dhe multidisiplinar, si dhe nisur nga rëndësia që kanë këto kontrata për financat publike, APP vlerëson se procesi i monitorimit duhet të kryhet nga struktura dhe institucione më të specializuara, që kanë fushe veprimtarie të specifikuar në fushën e koncesioneve/PPP.

4. Nisur dhe nga parimet e Direktivave të BE-së, nga praktika e vendeve ndërkombëtare, koncesionet/PPP duhet të monitorohen nga struktura të posaçme, që krahas anës procedurale vlerësojnë edhe aspektet financiare të një procedure koncesionare .

Nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024, ku

⁵ Gjatë këtij viti, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, APP u fokusua në verifikimin e procedurave të prokurimit, duke mbajtur në konsideratë rekomandimin e KLSH për verifikim të procedurave pa reagim/reflektim nga autoritete kontraktore, mbi kriteret e pranimit, dhe denoncimet e paraqitura nga palë të treta, kjo, pasi prezenca në zyrë e punonjësve ka qenë shumë e kufizuar dhe si rezultat, ka patur vështirësi dhe vonesa në shpërndarjen e praktikave, fotokopjimin/skanimin e tyre, pasur në vëmendje edhe volumin e praktikave të verifikimit. Për pasojë, nuk ka qenë e mundur të përfshihen për verifikim procedura në fushën e koncesioneve/PPP apo procedura të tjera prokurimi me përzgjedhje”, fq.91

janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit mbi veprimtarinë e APP-së në fushën e monitorimit të koncesioneve.

1. Lidhur me plotësimin e vendit vakant “Inspektor” në Sektorin e Verifikimit të Procedurave të Koncesionit/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare, bëjmë me dije se me aktin e emërimit nr.700 prot, datë 31.01.2024, të DAP, është plotësuar ky pozicion pune.

2.Lidhur me mungesën e trajnimeve të stafit për procedurat koncesionare sqarojmë se: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) është institucioni, që ofron trajnime për nëpunësit e administratës publike por në planin e saj të trajnimeve, nuk ka pasur trajnime në fushën e koncesioneve/ppp. Pavarësisht kësaj, APP mirëpret çdo sugjerim tuajin për institucione të tjera, ku mund të drejtohet APP në marrjen e shërbimit të trajnimit në këtë fushë.

3. Lidhur me monitorimin e kontratave koncesionare, APP inicion një proces monitorimi, kryesisht ose me indicie të palëve të treta raporte të auditimit të organeve audituese në vend. Vlen të theksohet se, në fushën e koncesioneve nuk ka pasur të raportuara në APP indicie nga palë të treta, sipas kërkesave të legjislacionit, si dhe nuk janë referuar raporte me gjetje të procedurave koncesionare nga asnjë organ auditues. Gjithashtu shtojmë se Sektori i Verifikimit të Procedurave të Koncesionit/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare ka filluar të funksionojë pas muajit Gusht 2022.

- Për sa i përket cilësimin tuaj për procedurën koncesionare me objekt “*Projektim, ndërtim operim, mirëmbajtje dhe transferim i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës*” duam të sqarojmë se kjo procedurë, në kohën e nisjes së Planit të Verifikimit ka qenë çështje e referuar në organet e prokurorisë (SPAK).

fakt i verifikueshëm edhe nga kërkimet në internet.

4. Sa i takon konstatimit për komunikim të vazhdueshëm me ATRAKO-n, sqarojmë se pas komunikimit elektronik me këtë institucion në muajin korrik, u përgatit dhe u miratua në muajin gusht, Plani përkatës i Verifikimit. APP do ta mbajë në konsideratë rekomandimin tuaj, duke marrë informacion të përditësuar nga ky institucion, në kohën që do të vlerësohet nisja e një Plani Verifikimi.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit :

1 Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit, grupi i auditimit thekson se nuk mund të gjykojë nëse janë korrigjuar mangësitë, pasi auditimi në terren ka përfunduar. Kjo mbetet për t’u parë në momentin e kryerjes së verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, prandaj observacioni për këtë pikë nuk do të merret në konsideratë.

2.Nga auditimi në terren rezultoi se nga ana Juaj nuk ka pasur një kërkesë zyrtare drejtuar institucioneve përgjegjëse, për nevojat që ka për trajnim të stafit të saj, lidhur me procedurat koncesionare, për këtë arsye observacioni juaj për këtë pikë nuk do të merret në konsideratë.

3.Observacioni juaj nuk do të merret në konsideratë pasi nuk u paraqit nga ana juaj dokument provues.

4.Për procedurat koncesionare të vitit 2022, paraqitur si më poshtë, APP nuk ka marrë informacion të përditësuar nëse janë finalizuar me nënshkrim kontrate, referuar komunikimit të vetem elektronik (*datë18 korrik 2023*) me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve.

-*Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Milot-Thumanë*”

-*Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Kashar-Pezë-Lekaj*”.

- *Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Lekaj-Konjat-Fier*”.

Për sa më sipër, APP, në vijimësi, gjatë hartimit të planit të verifikimit bazuar në kriteret e përcaktuara në rregulloren e saj të brendshme, të marrë masa për sigurimin e një informacioni të përditësuar nga ATRAKO mbi kontratat koncesionare.

Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ankandëve publike

Me krijimin e Sektorit të Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në

Fushën e mbrojtjes në muajin mars të vitit 2022, nisën proceset verifikuese në fushën e ankandëve publike, duke iniciuar në muajin qershor një komunikim shkresor me të gjitha institucionet që kanë vepruar si Autoritet Shitës në vitin paraardhës 2021, (77 të tilla), për mbledhjen e informacionit mbi ecurinë e veprimtarive të ankandëve të realizuara prej tyre, si dhe detyrimin ligjor për raportim periodik 6 mujor, pranë APP-së.

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion, Sektori hartoi planin e verifikimit nr.6511 prot, datë 23.09.2022, me objekt “*Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë në disa procedura të ankandit publik, të zhvilluara nga autoritete të ndryshme shitëse, gjatë vitit 2021*”.

Në këtë plan u përfshinë 8 procedura ankandi. Në përzgjedhjen e autoriteteve shitëse u morën në konsideratë ato, të cilat kanë zhvilluar të paktën 2 procedura ankandi gjatë vitit 2021, të finalizuara me nënshkrim kontrate. Ndërsa, përzgjedhja e procedurave u bazua në kritere si: - lloji i procedurës së përdorur;- vlera fillestare e ankandit;- objekt i ankandit dhe vlera e fituar.

Gjatë vitit 2022, përfundoi hetimi administrativ për 2 procedura, për të cilat është konkluduar me dhënien e masave administrative në mbështetje të nenit 7, pika 2/c të LAP, për shkak të konstatimit të shkeljeve/mangësive dhe veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve shitëse në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik. Masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të hetimit administrativ janë si më poshtë:

- Për 3 punonjës në një Autoritet Shitës është vendosur gjobë.
- Për 3 punonjës në një Autoritet Shitës është propozuar dhënia e masës disiplinore

Gjatë vitit 2023, përfundoi hetimi administrativ për 6 procedura ankandi publik, të zhvilluara nga autoritetet shitëse gjatë vitit 2021, te llojit “E Hapur”;

Nga hetimet administrative të kryera mbi zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të ankandit publik, APP ka konkluduar me vendime për masa penalizuese, konform parashikimeve ligjore në 6 raste. Konkretisht:

- Për 5 punonjës në 1 Autoritet Shitës është vendosur gjobë.
- Për 19 punonjës në 5 Autoritete Shitëse është propozuar dhënia e masës disiplinore.

Bazuar në vendimin e APP, autoritetet shitëse kanë detyrimin për të raportuar në APP, mbi veprimet e ndërmarra në zbatim të masave të dhëna nga kjo e fundit, në vendimet e hetimit administrativ të procedurave dhe vendimet për verifikimin e gjetjeve si rezultat i indicieve nga raportet përfundimtare të auditimit.

- Sa i takon vendimit të dhënë nga APP, në përfundim të hetimit administrativ të kryer prej saj, për dënimin me gjobë të anëtarëve të njësisë së ankandit, rezulton se, autoriteti shitës ka raportuar se, anëtarët e njësisë së ankandit kanë ankimuar në gjykatë vendimin.

- Sa i takon vendimit të dhënë nga APP, në përfundim të hetimeve administrative të kryera prej saj, për propozim mase disiplinore ndaj anëtarëve të njësisë së ankandit pranë 5 autoriteteve shitëse, rezulton se, këto autoritete kanë raportuar pranë APP mbi zbatimin e masës.

Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 36/2020 “Për Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare”, Agjencia e Prokurimit Publik është institucioni përgjegjës për verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 vjet nga nënshkrimi i saj, në përputhje me këtë ligj si dhe legjislacionin përkatës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga subjekti mbi planet e verifikimit për procedurat e prokurimit publik, procedurat e Koncesioneve/PPP dhe procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë për vitet 2022 dhe 2023, u konstatua se:

Nga sektori përgjegjës nuk është hartuar plan verifikimi për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, e për pasojë nuk ka nisur asnjë proces hetimi administrativ ndaj autoriteteve që kanë realizuar procedura në këtë fushë. Sipas subjektit, shkak për këtë situatë është mospërfundimi i procesit të implementimit dhe akreditimit të Sistemit të Komunikimit të Informacionit, në të cilin do të operohet/prodhohet/përpunohet informacioni i klasifikuar “Sekret

shtetëror”. Nisur nga të dhënat statistikore për periudhë 2021-2023 rezultojnë të jenë gjithsej **35** kontrata të nënshkruara për procedurat e prokurimit në këtë fushë.

Gjatë periudhës 2022- 2023, APP është angazhuar për krijimin e infrastrukturës së nevojshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, si nga ana e ngritjes së kapaciteteve administrative për pajisjen e punonjësve me CSI, ashtu edhe të infrastrukturës së nevojshme teknike.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që vijnë nga legjislacioni i informacionit të klasifikuar, APP ka ndërmarrë një sërë veprimesh si :- Caktimi me urdhër të brendshëm nr. 99, datë 18.10.2022 të oficerit të sigurisë, - krijimi i komisionit për klasifikim të informacionit “ sekret shtetëror” në APP, me urdhër nr. 100, datë 18.10.2022, dhe miratimi nga ky komision i listës së informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, që do të prodhojë institucioni gjatë veprimtarisë së tij, (*Vendim nr. 01, datë 21.11.2022 , “Për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në Agjencinë e Prokurimit Publik) dhe përcjellja e tij në DSIK. etj.*

- Me urdhrin nr. 110/1, datë 23.12.2022 *“Për një shtesë në urdhrin nr. 110, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e funksioneve që duhet të pajisen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit” për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Agjencinë e Prokurimit Publik”, në listën e funksioneve organike që do të njihen me informacionin e klasifikuar, u shtua edhe pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Menaxhimit të Bazës së të Dhënave.*

- Me shkresën nr. 37/9 prot, datë 05.01.2023, AKSIK-ut i’u përcoll kërkesa për pajisje me CSP të punonjësve të cilët i përkasin listës së funksioneve që duhet të pajisen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit”, të miratuar me urdhrin nr.110, datë 16.12.2022 . Kësaj kërkesë iu bashkëlidh edhe dokumentacioni i përcaktuar në nenin 10, të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”.

- Në datën 27.03.2023, nëpunësit e APP u pajisën me CSP të vlefshme deri në datën 23.03.2028.

- Me shkresën nr. 255/3 prot, datë 28.02.2023 “Kërkesë për asistencë”, APP i është drejtuar Drejtorisë së Shifrës për asistencë lidhur me procesin e implementimit të sistemit të komunikimit dhe të informacionit (në vijim “SKI”), në të cilin trajtohet Informacion i Klasifikuar.

-Me shkresën nr. 1595 prot, datë 15.03.2023, me lëndë: *“Përgjigje shkresës nr. 255/3 prot., datë 28.02.2023”, Drejtoria e Shifrës, në cilësinë e Autoritetit Kombëtar Tempest, ka rekomanduar që të kryhet një inspektim paraprak i hapësirës së ambienteve të APP, ku do të shrihet SKI.*

-Pas kryerjes se inspektimit, Drejtoria e Shifrës me shkresën nr. 245/1 prot, datë 20.04.2023, ka përcjellë raportin me rekomandimin përkatës për ambientet e përshtatshme, ku duhet të instalohet SKI.

Gjithashtu janë miratuar dhe akte të tjera si: -Urdhri nr.72, datë 05.10.2023 “Për ndarjen e zonave të sigurisë në Agjencinë e Prokurimit Publik”, - Plani për evakuimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, - Plan masash për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar.

Megjithatë ende nuk është plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga AKSHI, pasi nevojitet asistencë e një specialisti IT, në rolin e administratorit të SIK-së, si person përgjegjës për aspektet e sigurisë që lidhen me implementimin, instalimin dhe operimin e sistemit. Për këtë arsye APP, me shkresë nr. 9550/1 prot, datë 14.12.2023, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të caktuar një nga specialistët IT të atashuar në APP, në rolin e administratorit të SIK por nuk ka marrë një përgjigje nga AKSHI.

Në këtë kuadër APP si institucion verifikues ende nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për monitorimin e këtyre procedurave, me qëllim dhënien e sigurisë për mirëmenaxhim të fondeve publike në prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Masat e marra nga APP: Me shkresën Nr. 266/1 prot., datë 31.01.2024, me lëndë: *“Kthim përgjigje shkresës suaj Nr. Prot 9550/2, datë 12.01.2024”, AKSHI ka caktuar në detyrën e Administratorit të SKI,*

njërin nga punonjësit IT, të atashuar në APP.

Pas caktimit në këtë detyrë, Administratorit të SKI i janë vënë në dispozicion draftet e dokumentacionit të hartuar pjesërisht (*pasi nevojitet asistenca e një punonjësi IT, i cili duhet të kryejë edhe detyrën e administratorit të SKI*) sipas përcaktimeve të VKM nr. 792, datë 28.12.2023 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurimin e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit”, me qëllim akreditimin e SKI. Ky dokumentacion do të plotësohet dhe do t’i përcillet Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, për të finalizuar procesin e akreditimit të SKI.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit, grupi i auditimit thekson se nuk mund të gjykojë nëse janë korigjuar mangësitë, pasi auditimi në terren ka përfunduar. Kjo mbetet për t’u parë në momentin e kryerjes së verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, prandaj observacioni për këtë pikë nuk do të merret në konsideratë.

➤ **Mbi veprimtarinë e Sektorit Ligjor dhe Shqyrtimit të Kërkesave për Përrjashtim të Operatorëve nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, konçesioneve partneritet publik privat dhe ankandeve publike.**

Një ndër detyrat kryesore të APP, në bazë të nenit 23 shkronja ë), dhe nenit 78 të Ligjit nr.162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’, është edhe vlerësimi i rasteve për përjashtim nga e drejta për të fituar kontrata publike të operatorëve ekonomikë. Këto raste evidentohen nga APP gjatë procesit të verifikimit apo shqyrtimit të raporteve të organeve të auditimit, ose si rezultat i propozimeve të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve të tjera audituese në ushtrim të funksioneve të tyre, të cilët kërkojnë përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi publik, koncesioni/partneriteti publik privat apo procedura ankandi publik, për një periudhë të caktuar kohore.

Verifikimi i rasteve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike nëpërmjet procesit të hetimit administrativ, kryhet nga Sektori Ligjor dhe i Shqyrtimit të Kërkesave për Përrjashtim, pjesë e Drejtorisë Juridike dhe Monitorimit të Procedurave.

Procedura e hetimit administrativ kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 129, të LPP-së , nenit 110 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të Kodit të Procedurave Administrative, rregullores së brendshme të institucionit nr.05, datë 29.12.2022 si dhe të rregullores së brendshme të APP-së, nr.02, datë 23.6.2021, ndryshuar me rregullore nr.01, datë 27.9.2022 “*Mbi procedurat për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike*”

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën në mënyrë rastësore 25 praktika vendimarrjesh nga 98 praktika gjithsej, për periudhën 2021-2023, dhe rezultoi si më poshtë:

➤ Në 4 (katër) raste, Sektori ligjor dhe i shqyrtimit të kërkesave për përjashtim të operatorëve ka tejkalluar afatin 60 ditor për përfundimin e procedurës, parashikuar në nenin 91 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe nuk ka nxjerr një akt për të justifikuar zgjatjen e afatit.

➤ Në 3 (tre) raste të përjashtimit të operatorëve nga e drejta për të marrë pjesë në procedura prokurimi, vendimi përfundimtar i APP-së nuk është publikuar në faqen zyrtare të saj në kundërshtim me pikën 2 të nenit 112 të VKM-së nr.285/2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”

Për operatorin “M” sh.p.k

APP, me vendim nr.63, datë 16.7.2021, ka vendosur të përjashtojë për 18(tetëmbëdhjetë) muaj operatorin ‘M’sh.p.k, me NIPT KXXX nga e drejta për të fituar kontrata publike në bazë të nenit 13/3/a, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. (*ligji në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për përjashtim*).

APP ka nisur procedurën administrative me shkresën nr. 2045 prot, dt. 19.03.2021, pas vënien në lëvizje nga opeatori ekonomik “G.S.” PF, me shkresë nr.7961/4 prot, dt, 21.01.2021.Shoqëria ‘M’sh.p.k ka dërguar kundërshtimet me shkrim në funksion të këtij procedimi me shkresë nr.2045/1 prot , datë 07.04.2021.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga grupi i auditimit, rezultoi se:

APP ka administruar dokumentacionin e nevojshëm për një hetim të plotë dhe të paanshëm si dhe ka ndjekur të gjitha hapat procedurialë e ligjor në kryerjen e verifikimeve mbi pretendimet e ankimuesit si dhe kundërshtimeve nga operatori ekonomik, në përputhje me kreun X të Kodit të Procedurës Administrative, të Rregullores së Brendshme nr.10 datë 19.01.2018 (i ndryshuar)“*Mbi procedurat e përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike/procedurat e koncesioneve dhe ankandeve publike* si dhe Rregulloren e Brendshme të instiucionit miratuar me vendim nr.14, datë 13.9.2018 (i ndryshuar).

Vendimi përfundimtar i përjashtimit i nxjerrë në përfundim të hetimit, plotëson të gjithë elementët mbi formën, strukturën dhe përmbajtjen, bazuar në nenin 13, të Rregullores së brendshme nr.10 datë 19.01.2018 (i ndryshuar)“*Mbi procedurat e përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike/procedurat e koncesioneve dhe ankandeve publike*. Në marrjen e këtij vendimi është marrë në konsideratë si rrethanë lehtësuese fakti që operatori ekonomik është skualifikuar në këtë procedurë dhe nuk ka përfituar fonde publike. Ndërsa si rrethanë rënduese, fakti që operatori është përjashtuar me një vit nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit me vendim nr.20/2020.

APP ka tejkalluar afatin ligjor të përfundimit të hetimit sipas nenit 91 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe nuk ka nxjerr një akt për të justifikuar zgjatjen e afatit, ku citohet ... “**Afati për përfundimin e procedurës administrative, 1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm, 2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë; 3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre.;4. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme;5. Mosrespektimi i afateve kohore, të parashikuara në këtë nen, duhet të justifikohet nga organi përgjegjës para organit epror ose nga nëpunësi përgjegjës përpara eprorit të tij, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit ose nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme” dhe neni 92 ku citohet ... “**Zgjatja e afatit të procedurës, 1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi; 2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar;3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar.Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit.”****

Për “OT”sh.p.k

Për operatorin “OT” sh.p.k, me NIPT XXX, APP, me vendim nr.57, datë 17.6.2022 ka vendosur për përjashtim të këtij operatori për 3 (tre) muaj, nga e drejta për të fituar kontrata publike, pasi ndodhej në kushtet e mospërmbushjes kontraktuale sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP. Në bazë të nenit 78/1/b, “*Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: - mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik”*

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga grupi i auditimit, rezultoi se:

APP ka nisur procedurën administrative me shkresë nr.1098/5 prot,datë 11.04.2022, pas vënies në lëvizje nga Qendra Kulturore Tiranë (në cilësinë e autoritetit kontraktor), me shkresë nr.62 prot, datë 07.02.2022. AK ka dërguar dokumentacion provues me shkresë nr.1098/4 prot, datë 28.3.2022, ndërsa Operatori “OT”sh.p.k, ka paraqitur kundërshtimet lidhur me këtë procedim me shkresë nr.1098/7 prot, datë 16.5.2022.

APP ka administruar dokumentacionin e nevojshëm dhe ka konkluduar se operatori nuk ka dorëzuar objektin e kontratës, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

APP ka ndjekur të gjitha hapat procedural e ligjor në hetimin e kryer, në përputhje me kreun X të Kodit të Procedurave Administrative, të Rregullores së Brendshme nr.10, datë 19.01.2018 (i ndryshuar) “Mbi procedurat e përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike/procedurat e koncesioneve dhe ankandeve publike si dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit miratuar me vendim nr.14, datë 13.9.2018 (i ndryshuar).

Në vendimin e marrë është marrë në konsideratë fakti se ky operator nuk rezulton i përjashtuar më parë nga procedurat e prokurimit si dhe vlerën e ulët të kontratës, (279,999 lekë me tvsh).

APP ka tejkaluar afatin 60 ditor për përfundimin e procedurës, parashikuar në nenin 91 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe nuk ka nxjerr një akt për të justifikuar zgjatjen e afatit.

Për operatorin L

APP, me vendim nr.113, datë 29.8.2022 ka vendosur të përjashtojë për 10 (dhjetë) muaj, operatorin “L” sh.p.k, me NIPT X nga e drejta për të marrë pjesë në procedura prokurimi, për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontrata publike, parashikuar në nenin 78/1/b të LPP.

Bazuar në shkresën nr.1254 prot, datë 20.04.2022 të Bashkisë Dibër (Në cilësinë e Autoritetit Kontraktor), APP ka nisur procedim administrativ për përjashtim të operatorit ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, me shkresë nr.2802/5, datë 22.6.2022.

AK ka depozituar dokumentacion provues në APP me shkresat nr. 1564/1 prot, datë 19.05.2022, si dhe nr.1564/1 prot, datë 08.6.2022. Ndërsa operatori ka paraqitur kundërshtimet e tij të shoqëruara me dokumentacion me shkresë nr. 2802/7 prot, datë 25.7.2022.

APP ka administruar dokumentacionin e nevojshëm nga palët e përfshira në këtë proces si dhe ka kryer verifikimet përkatëse, në përputhje me me kreun X të Kodit të Procedurës Administrative, nenin 110 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të Rregullores së Brendshme nr.10, datë 19.01.2018 (i ndryshuar) “Mbi procedurat e përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike/procedurat e koncesioneve dhe ankandeve publike si dhe Rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me vendim nr.14, datë 13.9.2018 (e ndryshuar). Vendimi përfundimtar i përjashtimit i nxjerrë në përfundim të hetimit plotëson të gjithë elementët mbi formën, strukturën dhe përmbajtjen, bazuar në nenin 13, të rregullores nr.2, datë 23.6.2021.

Në vendimin e marrë është mbajtur në konsideratë si rrethanë lehtësuese për operatorin ekonomik fakti se si :- nuk ka përfituar fonde publike, pasi malli nuk është marrë në dorëzim dhe AK nuk ka kryer asnjë pagesë. Ndërsa si rrethanë rënduese rezulton se mosrealizimi i objektit të kontratës ka dëmtuar intresat e AK-së në plotësimin e tyre në kohë, si dhe operatori rezulton i përjashtuar më parë nga procedurat e prokurimit me vendim nr. 56, datë 16.6.2022.

APP ka tejkaluar afatin 60 ditor për përfundimin e procedurës, parashikuar në nenin 91 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe nuk ka nxjerr një akt për të justifikuar zgjatjen e afatit.

1. Për operatorin “A” sh.p.k,

Për operatorin “A” sh.p.k, me NIPT XXX, APP, me vendim nr.24, datë 30.3.2023 ka vendos për mospërjashtim të këtij operatori nga e drejta për të fituar kontrata publike, pasi nuk ndodhej në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga grupi i auditimit rezultoi se:

Ky procedim administrativ ka nisur me shkresë nr. 75151/1 prot, datë 08.08.2022 në bazë të kërkesës nr.1551 prot, datë 21.07.2022 të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve Kukës, . Autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacion provues me shkresë nr.1551/8 prot, datë 14.11.2022 ndërsa shoqëria A” sh.p.k, ka përcjell dokumentacionin provues me shkresë nr.1116 prot., datë 13.10.2022.

Rezulton se është administruar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që mbështet vendimmarrjen e APP-së. Dokumentacioni përfshin kopje të kontratave të lidhura me shoqërinë mbikëqyrëse “A” sh.p.k, -korrespondencën shkresore midis Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë,- dokumentacion provues dërguar nga shoqëria për të mbështetur kundërshtimet e saj. Në përfundim të hetimit, referuar dokumentacionit të administruar nga APP, rezulton se shoqëria i ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe nuk është në kushtet që parashikon neni 78/1/b i LPP.

APP ka ndjek të gjitha hapat procedural e ligjor në hetimin e kryer, në përputhje me kreun X, të Kodit të Procedurës Administrative, nenit 110 të VKM-së nr 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Rregulloren e brendshme nr.02, datë 27.9.2022 “Mbi procedurat për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike” si dhe Rregulloren e brendshme të institucionit, miratuar me vendim nr.5, datë 29.12.2022. Vendimi përfundimtar i përjashtimit i nxjerrë në përfundim të hetimit plotëson të gjithë elementët mbi formën, strukturën dhe përmbajtjen, bazuar në nenin 13, të rregullores së procedurave të përjashtimit të operatorëve.

Rezulton se, APP ka tejkalluar afatin 60 ditor për përfundimin e procedurës, parashikuar në nenin 91 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe nuk ka nxjerr një akt për të justifikuar zgjatjen e afatit.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mangësi në procesin e përditësimit të informacionit për kontratat koncesionare</i>
Situata:	<p>Për periudhën 2021-2022, rezultoi se nuk ka pasur asnjë proces hetimi për kontrata koncesionare .Referuar informacionit të datës 18.7.2023, dërguar nga Agjencia e Trajtimit të Konçesioneve, rezultoi se: për vitin 2020 është nënshkruar kontrata koncesionare datë 20.4.2020 me objekt: “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës”, me Autoritet Kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.</p> <p>Spektori i Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare në Agjencinë e Prokurimit Publik, nuk ka informacion të konfirmuar nga ATRAKO, nëse janë finalizuar me nënshkrim kontrate, tre procedurat koncesionare të vitit 2022. APP pasi administron kontratat koncesionare nga ATRAKO,(kjo e fundit është përgjegjëse për mbajtjen e bazës së të dhënave për të gjitha kontratat e koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të dhëna në Republikën e Shqipërisë), vlerëson në bazë të kriterëve të caktuara në rregulloren e saj të brendshme, për përzgjedhjen e kontratave që do t’i nënshtrohen hetimit administrativ.</p>
Kriteri:	Neni11, shkronja “a”, e ligjit nr.125/2013 “Për Konçesionet dhe Partneritetin Publik Privat.
Ndikimi/Efekti:	Mospërmbushje e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin11, shkronja “a”, të ligjit nr.125/2013 “Për Konçesionet dhe Partneritetin Publik Privat.
Shkaku:	Situata e pandemisë dhe mungesë stafi. Gjithashtu, sipas komunikimit elektronik (dt.18.7.2023) me ATRAKO, për disa nga procedurat koncesionare të vitit 2022 nuk ka informacion nëse janë finalizuar me nënshkrim kontrate, pasi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duhet të dërgojë kontratat koncesionare të lartpërmendura te Agjencia e Trajtimit të Konçesioneve, në bazë të detyrimit ligjor që ka sipas VKM nr.211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrimit elektronik të koncesioneve/PPP”. Në mungesë të këtij informacioni nga ana e APP-së, nuk mund të vijohej me përfshirjen e ndonjëres prej kontratave në një plan verifikimi.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa në vijim që të ketë një komunikim të vazhdueshëm me Agjencinë e Trajtimit të Konçesioneve lidhur me përditësimin e informacionit për kontratat koncesionare dhe përzgjedhjen e kontratave që do t’i nënshtrohen hetimit administrativ.

Titulli i Gjetjes:	<i>Strukturë e paplotësuar dhe mungesë trajnimesh për procedurat e koncesioneve.</i>
Situata:	<p>Struktura e Sektorit të Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare është e paplotë për arsye të një pozicioni vakant “Inspektor” si dhe nuk ka një plan trajnimi për stafin e këtij sektori lidhur me procedurat koncesionare . Nga komunikimi me subjektin, rezultoi se nuk ka një kërkesë zyrtare të APP-së drejtuar institucioneve përgjegjëse, për nevojat që ka për trajnim të stafit të saj, lidhur me procedurat koncesionare. Sipas subjektit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) si institucioni përgjegjës, që ofron trajnime për nëpunësit e administratës publike nuk ka pasur trajnime në fushën e koncesioneve/PPP.</p> <p>Gjithashtu, sipas subjektit edhe nëse struktura e sektorit do të jetë e plotësuar, kapacitetet e saj në burime njerëzore janë të pamjaftueshme për të marrë në shqyrtim disa procedura koncesionare . Për më tepër, nisur nga rëndësia e lartë që kanë kontratat koncesionare për financat publike, vetëm një strukturë e posaçme me staf të kualifikuar dhe multidisiplinar si ATRAKO mund të monitorojë dhe vlerësojë aspektet proceduriale dhe financiare të procedurave koncesionare , pasi struktura e APP-së është e pamjaftueshme për shkak të kompetencave të tjera që ajo ka si: kompetenca mbikëqyrëse të sistemit të prokurimit publik, kompetenca monitoruese në fushën e ankandit publik dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.</p>
Kriteri:	Urdhër i Kryeministrit nr.34, datë 17.3.2023,“ Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik” (i ndryshuar), nenit 11, pika 1, si dhe neni 21, i Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “ <i>Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin</i> ” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mospërmbushje e detyrimeve ligjore dhe objektivave institucional.
Shkaku:	Nga shpalljet e kryera për vendin vakant nga DAP, në procedurat e rekrutimit për këtë pozicion ka rezultuar se nuk ka pasur kërkesa. Lidhur me trajnimet për procedurat koncesionare nuk janë marrë masa për trajnimin e punonjësve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<p>Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendit vakant “Inspektor” në Sektorin e Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare.</p> <p>- Nga ana e APP-së të merren masa për koordinimin e veprimeve me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për planifikimin e trajnimeve të specialistëve të Sektorit të Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP për procedurat koncesionare, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe krijimin e njohurive të specializuara në këtë fushë</p>

Titulli i Gjetjes:	<i>Mospërmbushje e detyrimit ligjor për monitorim të procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.</i>
Situata:	APP si institucion verifikues ende nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për monitorimin procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me qëllim dhënien e sigurisë për mirëmenaxhim të fondeve publike në

	<p>prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Nisur nga të dhënat statistikore për periudhë 2021-2023 rezultojnë të jenë në total 35 kontrata të nënshkruara për procedurat e prokurimit në këtë fushë. Megjithëse APP ka ndërmarrë në kohë dhe ka ndjekur në vijimësi gjithë veprimet e nevojshme konform kërkesave të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, për të përmbyllur procesin e implementimit të sistemit të komunikimit dhe të informacionit, ende nuk ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AKSHI, pasi nevojitet asistencë e një specialisti IT, në rolin e administratorit të SIK-së, si person përgjegjës për aspektet e sigurisë që lidhen me implementimin, instalimin dhe operimin e sistemit. Për këtë arsye APP, me shkresë nr. 9550/1 prot, datë 14.12.2023, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të caktuar një nga specialistët IT të atashuar në APP, në rolin e administratorit të SIK por nuk ka marrë një përgjigje nga AKSHI.</p>
Kriteri:	Nenin 14 i ligjit nr. 36/2020 “Për Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare”.
Ndikimi/Efekti:	Mungesë sigurie në menaxhimin e fondeve publike për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.
Shkaku:	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk i është përgjigjur kërkesës së APP-së për caktimin e një specialisti IT, në rolin e administratorit të Sistemit të Informacionit të Klasifikuar.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<p>APP të vijoj bashkëpunimin me Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për caktimin e specialistit të IT-së në APP, në rolin e administratorit të Sistemit të Informacionit të Klasifikuar, si personi përgjegjës për aspektet e sigurisë që lidhen me implementimin, instalimin dhe operimin e këtij sistemi.</p> <p>- Nga ana e APP-së të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga AKSHI me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i informacionit të klasifikuar, si dhe të marrë masa për nisjen e punës për verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit.</p>

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Mbi sigurimin e transparencës, bashkëpunimit me të tretët, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik, me entet e tjera për zbatimin e standardeve kombëtare në përgatitjen e specifikimeve teknike nga autoritet kontraktore me organet e auditimit publik, si KLSH, strukturat e Auditimit Brendshëm, Inspektimin financiar mbi shqyrtimin e raporteve audituese të paraqitura prej tyre, u administrua informacioni si më poshtë: APP ka nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi, me institucione dhe ente të ndryshme publike në funksion të bashkëpunimit të ndërsjellë, sipas fushave respektive të veprimtarive, në funksion të rritjes së performancës së sistemit të prokurimit publik si dhe forcimit të kapaciteteve administrative. Me poshtë, evidentohen marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura përpara periudhës objekt auditimi por që vijnë zbatimin, duke sjellë rezultate konkrete në përmbushjen e objektivave të tyre përgjatë periudhës 2021-2023 si dhe marrëveshje të reja.

-Në kuadër të memorandumit me **Autoritetit Kombëtar të Ushqimit** nënshkruar në 26.07.2018, përmes bashkëpunimit institucional dhe raportimit të ndërsjellë, gjatë vitit 2021 kanë nisur 2 procedime administrative për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike për keqinformim për qëllime kualifikimi në procedurat e prokurimit. Të dyja këto procedime janë mbyllur me vendim përjashtimi të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar

kontrata publike.

Ndërsa, **gjatë vitit 2022** nga komunikimi ndërmjet dy institucioneve kanë rezultuar raste të një operatori ekonomik të listuar si fitues në procedurat e prokurimit me objekt produkte ushqimore, i cili nuk plotësonte kushtet për ushtrimin e aktivitetit.

APP nisi procedimin administrativ për përjashtimin e këtij operatori ekonomik, për shkak të pretendimeve për keqinformim, në plotësimin e deklaratës nga ky i fundit, se ushtron aktivitetin sipas kërkesave ligjore në fuqi, por në përfundim të këtij procedimi nuk u provua keqinformimi i pretenduar.

-Bazuar në memorandumin e bashkëpunimit me Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nënshkruar në datë 14.06.2019, me qëllim garantimin e zbatimit të rregullave të Kodit të Punës dhe të respektimit të parimit të mos-diskriminimit nga ana e bizneseve që operojnë në Shqipëri, APP përcjell pranë këtij institucioni, informacione periodike çdo 3 muaj, mbi operatorët ekonomikë që kanë lidhur kontrata për periudhat tre mujore, gjatë gjithë vitit kalendarik.

Bashkëpunimi me këtë institucion është i vazhdueshëm në drejtim të relatimit nga APP, të operatorëve ekonomikë që kanë përfituar fonde publike, dhe verifikimit nga ISHPSHSH nëse këta operatorë kanë qenë të penalizuar, për mosrespektim të kërkesave të legjislacionit të punës në fuqi. Në këtë kuadër, nga ana e ISHPSHSH janë relatuar pranë APP raste, ku subjekte të ndryshëm janë dënuar me gjobë për shkelje të legjislacionit të punës nga ky institucion.

Në vijim, pas verifikimeve paraprake, APP ka nisur procedimet administrative përkatëse për përjashtimin e këtyre operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike pasi, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se një pjesë e mirë e tyre kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues në procedura prokurimi, duke deklaruar se, nuk kanë masë ligjore në fuqi.

Vlen të theksohet se, gjatë **vitet 2021** nga ky bashkëpunim institucional dhe raportim i ndërsjelltë kanë nisur 6 procedime administrative për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike për keqinformim për qëllime kualifikimi në procedurat e prokurimit.

Nga këto procedime, njëri prej tyre është mbyllur me vendim mospërjashtimi, për shkak se nga hetimi administrativ është provuar se subjekti në fjalë e ka paguar masën e gjobës para se të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të hetuar, dhe për 5 raste të tjera, hetimi administrativ i të cilave është mbyllur me vendim gjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022, ka pasur raste të reja të raportuara dhe ka nisur procedimi për përjashtimin e 4 operatorëve ekonomikë, nga të cilët:

- 3 procedime janë mbyllur me vendim përjashtimi
- 1 procedim është mbyllur me vendim pezullimi.

Gjatë vitit 2023, nga informacionet e dërguara ka rezultuar se, nga ISHPSHSH janë relatuar dy raste ku subjekti ka rezultuar se është dënuar me gjobë. Nga këto dy procedime administrative të nisura, në përfundim është marrë vendimi për përjashtimin e të dy operatorëve ekonomikë.

➤ **Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar në datë 02.04.2019 me Autoritetin e Konkurrencës.**

Në kuadër të këtij Memorandumi, APP komunikon me këtë institucion, herë pas here duke i përcjellë për hetim disa raste të denoncuar nga subjekte të ndryshëm, me pretendime për marrëveshje të fshehta në oferta, duke vënë theksin se, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, në procesin e prokurimit publik është një nga parimet kryesore të këtij procesi, në funksion të mirëpërdorimit të fondeve publike, dhe rritjes së efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Gjatë vitit 2022, APP në kuadër të organizimit të takimeve shumëpalëshe si dhe bashkëpunimit me institucionet e treta ka realizuar në dhjetor 2022 një tryezë diskutimi dypalëshe me Autoritetin e Konkurrencës të cilat kanë konkluduar në firmosje e përbashkët të një Udhërrëfyesi nga dy institucionet.

Ky udhërrëfyes synon mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në prokurimet publike, me fokus parandalimin e marrëveshjeve të fshehta në prokurimet publike. Në këtë takim përveç

përfaqësuesve të Autoritetit të Konkurrencës dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik morën pjesë edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, dhomave të tregtisë dhe industrisë, studiove ligjore, etj. Gjithashtu, **gjatë vitit 2023** është organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve edhe të APP workshop me temë “Marrëveshjet në Oferta në procedurat e prokurimit publik në kuptim të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar. Workshop u zhvillua edhe me bashkëpunimin e Shoqatës “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të kësaj shoqate, si përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe njëkohësisht operatorë ekonomikë në treg. Eventi synoi të trajtonte konceptin e marrëveshjes në oferta, rolin e Autoritetit të Konkurrencës dhe APP në zbulimin e marrëveshjeve të fshehta në oferta etj.

➤ **Memorandumi i Bashkëpunimit nr.6592 prot, datë 15.10.2021 i nënshkruar me Komisionin e Prokurimit Publik.**

Qëllimi kryesor i këtij memorandumi është bashkëpunimi midis palëve për çështje të përbashkëta të sistemit të prokurimeve publike, si dhe ndarjes së vazhdueshme të eksperiencave ndërmjet stafeve teknike përkatëse.

Në vijim të këtij Memorandumi është hartuar edhe një Rekomandim i përbashkët, drejtuar autoriteteve kontraktore, duke sjellë në vëmendje detyrimin ligjor për zbatimin e vendimeve të KPP, (në rastet kur nuk kontestohen në rrugë gjyqësore), duke theksuar gjithashtu, që procedura e prokurimit në këtë rast nuk do të finalizohet me shpalljen e fituesit nëse, AK nuk i reflektojnë të gjitha ndryshimet që përmban vendimi i KPP.

Midis APP dhe KPP ka komunikim dhe bashkëpunim të vijueshëm në kuadër të realizimit të detyrimeve ligjore dhe angazhimeve të përbashkëta.

➤ **Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar në datë 22.12.2021 me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave.**

APP, ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me ILDKPKI nr.7889 prot, datë 22.12.2021, e cila ka si qëllim rritjen e integritetit të zyrtarëve në prokurimet publike dhe ndërgjegjësimin e tyre për zhvillimin e procedurave të prokurimit në mënyrë të pavaruar dhe të pandikuar nga interesat private. APP angazhohet në hartimin e njoftimeve apo manualeve shpjeguese për autoritetet/entet kontraktore apo operatorët ekonomikë, me qëllim evidentimin e rasteve për konflikt interesi si dhe shmangien e veprimeve që mund të kryejnë këto të fundit gjatë procedurave të prokurimit që mund të çojë në konflikt interesi.

Në këtë kuadër, APP ka punuar për rishikimin dhe përshtatjen e Udhëzimit Nr. 03, datë 24.06.2016 “*Mbi deklarimin e konfliktit të interesit nga zyrtarët/nëpunësit në procesin e prokurimit dhe zbatimin të kontratës*” me parashikimet e reja ligjore.

Për këtë qëllim, APP ka bashkëpunuar me ILDKPKI, si institucioni kompetent për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, i cili ka dhënë sugjerimet përkatëse, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Udhëzimi i hartuar nr.1 datë 21.1.2022 ka si qëllim të parandalojë konfliktin e interesit në procedurat e prokurimit, në çdo situatë, ku titullari ose punonjës të autoritetit ose entit kontraktor ose ofruesit e shërbimit të prokurimit, që veprojnë në emër të autoritetit/entit kontraktor të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit, mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure, duke cënuar paanësinë dhe pavarësinë e tyre në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit.

➤ **Midis APP dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është nënshkruar në 11.2.2022, një memorandum Bashkëpunimi.**

Ky Memorandum ka si qëllim rritjen e shkallës së ndërveprimit për një funksionim efektiv të bashkëpunimit përmirësimin e veprimtarisë dhe reduktimin e kostove të institucioneve. Objekti i këtij Memorandumi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të ushtrimit të së drejtës së aksesit në sistemin e prokurimit elektronik për nevoja të ushtrimit të ndjekjes penale dhe zhvillimin

e hetimeve nga ana e organit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

➤ **Midis APP dhe Shkollës së Magjistraturës, në tetor 2022 është firmosur memorandumi i Bashkëpunimit,** i cili synon rritjen e bashkëpunimit midis Shkollës së Magjistraturës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik në fusha me interes të përbashkët.

Palët angazhohen për të bashkëpunuar ngushtësisht për çështjet me interes të përbashkët, me qëllim arritjen e këtyre objektivave të tilla si vijimin e bashkëpunimit për përfshirjen e temave mbi prokurimin publik në programin e trajnimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës; vijimin e bashkëpunimit për përfshirjen e temave mbi prokurimin publik në programet e trajnimit të vazhdueshëm për magjistratët, gjyqtarë e prokurorë, të cilët shqyrtojnë çështje që lidhen me procesin e prokurimit; Organizimin e konferencave të përbashkëta, leksioneve të hapura apo takimeve në lidhje me zhvillimet në fushën e prokurimit dhe problematikat e konstatuara; Shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit në lidhje me tematika të ndryshme në fushën e prokurimit publik, etj.

Në vijim është hartuar një kurrikul për prokurimet publike dhe janë zhvilluar sesione trajnimesh pranë Shkollës së Magjistraturës me temë *“Prokurimi publik, Trajtimi i rasteve dhe hetimi efektiv i veprave penale që lidhen me fushën e prokurimeve publike, prishjen e barazisë në tender dhe me mospagimin e taksave dhe tatimeve, Pabarazia në tendera, Marrëveshjet në oferta në procedurat e prokurimit publik”*. Përfaqësues në këto trajnime kanë qenë gjyqtarë të gjykatave të ndryshme, anëtarë të BKH dhe të prokurorisë së posaçme.

➤ **Midis APP dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Qershor të vitit 2022 është firmosur Memorandum Bashkëpunimi,** i cili ndër të tjera synon forcimin e bashkëpunimit midis palëve, në funksion të zbatimit të parashikimeve të Kodit Zgjedhor si dhe të legjislacionit të prokurimit publik, në kuadër të mirëpërdorimit të fondeve publike në procedurat e prokurimit publik.

➤ **Memorandumi me Agjencinë Kombëtare të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (AKSIK)**

Duke qenë se APP dhe AKSIK, në përbushje të funksioneve dhe detyrave institucionale, kryejnë veprimtari në fusha të përbashkëta, që lidhen me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, në vitin 2023, ndërmjet dy institucioneve u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshja ka si qëllim bashkëpunimin në funksion të ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore në mirëzbatimin e legjislacionit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për mirëzbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë kryerjes së këtyre procedurave. Bashkëpunimi do të realizohet ndër të tjera, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të përbashkëta për autoritetet kontraktore që kryejnë prokurime në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përbajnë informacion të klasifikuar, si dhe nëpërmjet kryerjes së monitorimeve të përbashkëta, me qëllim verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e autoriteteve kontraktore, gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si përsa i përket zbatimit të rregullave të prokurimit, ashtu edhe zbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave që lidhen me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë kryerjes së këtyre procedurave.

APP, në bashkëpunim me AKSIK, zhvilluan trajnimin me temë: “Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, rastet e prokurimeve që përbajnë informacion të klasifikuar”. Ku nga përfaqësues të APP u prezantuan çështjet e përzgjedhura si me interes nga APP, për temën e trajnimit.

Qëllimi i këtij trajnimi, ishte njohja me ligjin nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, si dhe sqarimi i problematikave të hasura nga institucionet në cilësinë e autoriteteve kontraktore, që zhvillojnë procedura në fushën

e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në trajnim morën pjesë përfaqësues të institucioneve si: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Institucioni i Presidentit, Kuvendi, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit, Shërbimi Informativ i Shtetit, dhe Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit Dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Problematikat e ngritura nga përfaqësuesit e autoriteteve kontraktore kishin të bënin me paqartësitë që hasnin gjatë zbatimit të rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, kryesisht lidhur me afatet që duhet të respektohen në zbatim të legjislacionit, si dhe me përzgjedhjen e procedurës përkatëse të prokurimit, për të cilat u sqaruan nga përfaqësuesit e AKSIK dhe të APP.

Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 1, datë 29.01.2024.

2.1.2. Mbi përgatitjen e projekt- propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit Nr.1037/2, datë 14.12.2023 i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Ligji Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
2. VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
3. ProjektLigji me datë 21.06.2023;
4. Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
5. VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;
6. Udhëzimit Nr.2, datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje reigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”;
7. VKM Nr.1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”.

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

1. Veprimtaria e Agjencisë së Prokurimit Publik:

-Mbi përgatitjen e projekt- propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumentave Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura.

❖ Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë së Prokurimit Publik

Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe Ligjin Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar. Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik fokusohen kryesisht në:

-Përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumentave Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura;

-Monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, si dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private;

-Hartimin dhe nxjerrjen e Buletinit të Njoftimeve Publike;

-Përfshirjen e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionare apo të ankandit publik për një periudhë nga një deri në tre vjet;

-Nxitjen dhe organizimin e kualifikimit të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

❖ ***Draftligji dhe objektivat që synohen të arrihen.***

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”, është një ligj i harmonizuar dhe i integruar me Direktivat e Bashkimit Europian (2014/24, Direktivën 2014/25 dhe Direktivën 89/665 EEC, 92/13/EEC mbi mjetet juridike dhe rishikimin administrativ) dhe në këtë kuadër lind nevoja e përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar të prokurimit me acquis përkatëse të BE-së.

Qëllimi i këtij projektligji është të përmirësojë kuadrin rregullator të prokurimit publik në Shqipëri, duke synuar përafrimin e mëtejshëm të Ligjit me Direktivat e BE, kjo edhe si pjesë dhe e angazhimeve të marra në vijim të takimit dypalësh në kuadër të procesit “screening” për Kapitullin 5 “Prokurimi Publik”, të zhvilluar më datë 18 Nëntor 2022, në Bruksel, por edhe duke analizuar problematikat e dala gjatë zbatimit të këtij ligji në praktikë prej muajit Mars 2021 nga Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë, me qëllim lehtësimin e procesit të prokurimit për të gjitha palët e përfshira në të.

• ***Argumentimi i projekt aktit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme.***

Nga grupi i auditimit është konstatuar, nevoja për hartimin dhe argumentimin e këtij projektligji me ndryshime, i cili erdhi si rezultat i domosdoshmërisë së rregullimit të kuadrit legjislativ për prokurimin publik. Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me institucione të tjera siç janë, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit dhe Komisioni i Prokurimit Publik, duke analizuar problematikat e dala gjatë zbatimit të këtij ligji në praktikë nga Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë dhe organet audituese, me qëllim lehtësimin e procesit të prokurimit, por edhe duke synuar përafrimin e mëtejshëm të Ligjit me Direktivat e BE solli nevojën për ndryshime të reja ligjore.

Grupi i auditimit identifikoi, risitë në disa drejtime të Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për prokurimin publik”:

- Parashikimi për herë të parë i konceptit të veprimtarisë ndihmëse dhe ofruesit të shërbimit të prokurimit;

- Shfuqizimi i llojit të procedurës së prokurimit “Shërbim Konsulence”, si një procedurë që nuk përcaktohet nga Direktivat;

- Përcaktimi i konceptit të Urdhrit të Prokurimit në përkufizimet e ligjit, si moment procedural për iniciimin e një procedure prokurimi;

- Mundësinë që Zëvendëskryeministri ose ministri, nën përgjegjësinë e të cilit është Departamenti i Administratës Publike t’i propozojë KM vendosjen e një mase shpërblimi për punonjësit e autoriteteve ose enteve kontraktore ose punonjësit e tjere, që përfshihen në procesin e prokurimit;

- Parashikimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit, të kryerjes së ankesave dhe menaxhimit të zbatimit të kontratave duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit.

- Përfshirja nga zbatimi i LPP i prokurimit mallrave/punëve/shërbimeve me vlerë nën kufirin e lartë monetar për nevojat e secilit mision diplomatik dhe post konsullor të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit;

- Rishikimi i nenit të Konfliktit të Interesave, duke parashikuar edhe rastin e marrjes së masave në rast të evidentimit të tij gjatë zbatimit të kontratës;

- Rishikimi i kompetencave të Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim “APP”), të parashikuara në nenin 23 të ligjit, lidhur me monitorimin e kontratave, administrimin e bazës së të dhënave, si dhe rasteve të përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike;

- Riformulim i nenit lidhur me blerjen e përqendruar;

- Plotësim i përcaktimit të momentit të skualifikimit të një operatori ekonomik kur është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës;
- Saktësim i termit kur një operator ekonomik përjashtohet nga procedurat e prokurimit, ose pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, duke u përcaktuar togfjalëshi “nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik”;
- Rishikim i nenit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit;
- Saktësimi i rasteve se, kur një autoritet/ent kontraktor raporton pranë APP lidhur me tërheqjen e operatorëve ekonomikë;
- Rishikim i nenit të Kriteve Detyruese për Përjashtim;
- Rishikimi i nenit të Sistemit Dinamik të blerjes;
- Parashikimi i përdorimit të katalogëve elektronike;
- Riformulim në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” dhe 96 “Periudha e pritjes” të ligjit.
- Për sa i përket aspekteve të ndryshme të zhvillimit të procedurës së prokurimit nëpërmjet sistemeve elektronike, ndryshimet e nevojshme vijnë në kuadër të rritjes të transparencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit. Në kuadër të zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit në fushën e shërbimeve publike, me qëllim lehtësimin procedurave, rritjen e transparencës dhe shmangien e konfliktit të interesit është e domosdoshme përfshirja në këtë zhvillim teknologjik edhe të procesit të prokurimit publik.
- Në kuadër të rritjes së transparencës dhe efikasitetit, disa procese të prokurimit publik, sikurse janë: përllogaritja e vlerës limit të kontratës, studimi i tregut, hartimi i specifikimeve teknike duhet të kryhen në sisteme elektronike të çertifikuara, mbështetur në ndërveprim me sisteme të tjera të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit. Për këtë qëllim, propozohet që SPE të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të Inteligjencës Artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet Europiane.
- Në kuadër të rritjes së transparencës dhe përgjegjësisë në procesin e vlerësimit është e nevojshme kryerja e vlerësimit automatik të plotësimit të kriteve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të ofertuesve për fazën e parë të parakualifikimit, si dhe zhvillimit të Sistemit dinamik i blerjes dhe ankandit elektronik, duke përdorur teknologji të avancuar të Inteligjencës Artificiale dhe procese të robotizuara.
- Ndryshime në nenin 83 “Sigurimi i ofertës”, në nenin 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, në nenin 99 “Raporti përmbledhës”, në nenin 104 “Zbatimi”, në nenin 109 “E drejta e ankimit”, nenet 110,111,112,114,115,118 në nenin 119 “Pavlefshmëria e kontratave”, në nenin 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, në nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, në nenin 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, në nenin 126 “Nënkontraktimi” në nenin 127 “Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre”; në nenin 129 “Procedura e hetimit Administrativ”, nenin 130 dhe 131, si dhe nenin 132 “Kundravajtjet administrative” të ligjit.

➤ **Problematikat gjatë procedurave të prokurimit të fondeve publike, të cilat sollën nevojën për ndryshimet në dispozita ligjore, në rastet kur indicia ka qenë nga OE dhe Autoritete Kontraktore, në rastet e bashkëpunimit institucional me AKSHI-N dhe KPP.**

Nga ana e grupit të auditimit, konstatohet se me shkresën Nr.2164 prot., datë 09.03.2023 Kryeministria, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, kërkon mendim për ndryshimet në këtë prrojektiv gjatë bashku me relacionin shoqërues së tij të propozuar si nismë deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme dhe APP.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për prokurimet publike, APP ka analizuar krijimin e problematikave në lidhje me vijimin e procedurave të prokurimit, që kishin nisur me parashikimet e ligjit të shfuqizuar, të cilat ende nuk ishin publikuar në SPE, por që urdhri i prokurimit ishte nënshkruar nga titullari i AK dhe kishte nisur procesi i prokurimit me krijimin e grupeve të punës. Koncepti i Urdhrit të Prokurimit, është dhënë për të përcaktuar momentin procedural të nisjes të një

procedure prokurimi, moment nga i cili varen më pas veprime apo vendime, që merren në lidhje me procedurën përkatëse.

-Në bazë të LPP, një Autoritet Kontraktor mund të nënshkruajë një kontratë me një operator ekonomik, në rast se ai nuk është në listën e OE të përjashtuar nga APP, por me ndryshimet e reja saktësohet përsa i përket rasteve kur ka një kontratë mes OE dhe AK dhe gjatë zhvillimit të kontratës së prokurimit të fondeve publike, OE përjashtohet. Në këtë rast vendimi i përjashtimit të OE nga APP nuk i përfshin efektet për kontratat e lidhura përpara datës së vendimit, por nuk mund të lidhë më kontratë pas asaj date dhe deri në përfundim të afatit të përcaktuar në vendim. Gjithashtu në mbështetje të këtij ndryshime ka qenë edhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Nr.2512, datë 04.10.2022 ku një OE ka paraqitur padinë e tij, kur një prej kërkesave të padisë ka qenë dhe përcaktimi i momentit të përjashtimit nga sistemi i APP duke mos marrë pjesë në procedura të tjera prokurimi. Gjykata ka vendosur se vendimi i APP ka efekt vetëm pas datës së marrjes së vendimit dhe jo për procedura të prokurimit publik të përfunduara përpara kësaj date dhe për të cilat OE ka qenë në fazë ekzekutimi të kontratave të lidhura me AK.

-Gjatë auditimit është konstatuar komunikimi i vazhdueshëm shkresor mes APP dhe AKSHI-t, përsa i përket “Ngritjes së Sistemit të Menaxhimit për ndjekjen e kontratave”. Si produkt i këtij sistemi do të jetë vërtetimi i realizimit të kontratave në mënyrë të suksesshme që ofrohet nga të gjithë AK ndaj OE të kontraktuar, në format elektronik me vullë digjitale. APP me shkresën Nr.506/1 prot., datë 08.03.2021 i është drejtuar AKSHI për marrjen e informacionit se kur do të filloj aplikimi i këtij sistemi. AKSHI në zbatim të Ligjit Nr.9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrim Elektronik” të nenit 4 dhe Ligjit Nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” neni 22, i dërgon shkresën Nr.506 prot., datë 18.01.2022 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni APP duke u bërë me dije implementimin e sistemit të menaxhimit për ndjekjen e kontratave. Me shkresën Nr.506/2 prot., datë 18.03.2022 AKSHI i propozon APP si institucioni përgjegjës për prokurimet, nëse është e nevojshme hartimi i një akti ligjor ose nënligjor në lidhje me këtë ndryshim të mund të vijojnë me propozimin e tyre.

-Në këtë pikë të nenit 19 të LPP është shtuar parashikimi i rastit të marrjes së masave për të parandaluar, identifikuar rastet e konfliktit të interesave, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, jo vetëm gjatë kryerjes së procedurës së prokurimit por edhe gjatë fazës së zbatimit të kontratave, pasi mungonte një parashikim i tillë.

Duke marrë shkas nga problematikat e hasura, APP ka propozuar ndryshimin ligjor në lidhje me parashikimin e konfliktit të interesit edhe pasi është nënshkruar kontrata.

-Sikurse janë të parashikuara në ndryshimet ligjore në Direktivë, përsa i përket dosjeve virtuale, nga APP është bërë ndryshime duke marrë në konsideratë edhe komentet e dhëna gjatë procesit të bashkërendimit nga AKSHI, duke vlerësuar të shtohen si përkufizime në nenin 1 të projektligjit, përkufizimet “e certis” dhe “dosje virtuale”.

-Gjithashtu përsa i përket unifikimit me Direktivën 24/2014 të Bashkimit Europian, për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulencë” nuk parashikohet si lloj i veçantë, por ky shërbim trajtohet si të gjitha llojet e tjera të shërbimeve. Në këtë mënyrë propozohet nga APP, shfuqizimi i përkufizimit të kontratave të konsulencës në të gjithë tërësinë e ligjit, i llojit të procedurës së prokurimit “Shërbim Konsulencë”. Në vijim, në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të ligjit me Direktivat e BE, duke dhënë përkufizimin e kërkesave të etiketës, e cila mungonte në dispozitën e përkufizimeve. Në këtë mënyrë duke plotësuar edhe karakteristikat që i jepen “Ofertuesit”.

-Pikënisja për të shtuar konceptin e pasaportës së prokurimit publik, ka ardhur nga një propozim i dërguar pranë Kuvendit, për mendim nga Komisioni për Cështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili ka propozuar *disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik.”* Sipas këtij propozimi kërkohet krijimi i “pasaportës së prokurimit publik” si një hapësirë të dedikuar në sistemin e prokurimit elektronik për dokumentacionin e plotë të një procedure prokurimi, e cila është e identifikuar nga numri i referencës.

-Në nenin 7 të Ligjit aktual, është përjashtuar nga zbatimi i tij të prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve, për nevojat e përfaqësive diplomatike konsullore të Republikës së Shqipërisë

jashtë vendit. Me qëllim përafrimin e mëtejshëm me këto Direktiva është vlerësuar nga APP, nevoja e rishikimit të gjërës “i”, duke parashikuar përjashtimin nga zbatimi i ligjit për prokurimin publik vetëm prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve me vlerë nën kufirin e lartë monetar, pasi mbi këtë vlerë ato do të duhet të prokurohen sipas ligjit.

-Gjatë auditimit është konstatuar se është marrë në konsideratë nga APP, se për ato institucione që kanë një numër të vogël punonjësish (nën 15 punonjës) dhe ato AK të cilat nuk kanë mundësi të ngrenë strukturat e nevojshme për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të kenë mundësinë e mos kryerjes së procedurës nga vetë institucioni. Kjo, referuar parashikimeve në fuqi për prokurimin publik, ku rolet dhe përgjegjësitë e grupeve që ngrihen gjatë procesit të prokurimit janë të ndara, ku në cdo strukturë ka një numër i cili varion nga 1 deri në 3 persona, të cilët duhet të jenë persona të ndryshëm (*personi përgjegjës për prokurimin, grupi i punës për hartimin e specifikimeve/fondin limit, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të oferta, komisioni i shqyrtimit të ankesave*).

-Bazuar në auditimin e kryer nga KLSH në institucionin e APP-së me objekt: “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*” si dhe propozimit të dhëna nga AKSHI, nga ana e grupit të punës është rekomanduar për riformulimin e kompetencës që APP ka në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratave të nënshkruara. Bazuar në rekomandimet e lena, ky parashikim duhet të vijë në një linjë edhe me parashikimet e përcaktuara në nenet 3/a/ç, 5, 10, të Ligjit Nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, nenin 5/y të Kreut I të Vendimit Nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*”, të ndryshuar. Ky rekomandim i lënë nga KLSH është pranuar dhe është reflektuar në draftligj.

Autoriteti ose enti kontraktor, bazuar në nenin 124 të LPP, për të garantuar që kontrata të zbatohet në kohë, cilësi dhe në vlerën e përcaktuar, ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar. Në zbatim të këtij neni, autoritetet/entet kontraktore kanë detyrimin për hartimin dhe administrimin e dokumentacionit të nevojshëm që dëshmon zbatimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës në përputhje me kushtet e prokuruar.

Me riformulimin e bërë këtij neni, saktësohet kompetenca e institucionit të APP-së për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura prej tyre, bazuar në dokumentacionin e administruar nga autoritetet/entet kontraktore gjatë zbatimit të kontratës.

-Nga ana e grupit të punës të ngritur nga APP, është konstatuar se në të gjithë përmbajtjen e projektligjit, ku propozohen një sërë ndryshimesh në kuadër të rritjes së transparencës dhe eficensës në kryerjen e procedurave në prokurimet publike, ku ndër të tjera propozohet zhvillimi i sistemit të prokurimit elektronik aktual, duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara. Por, mungon një analizë dhe relacion shpejgues se pse është vlerësuar kjo asistencë si dhe nuk ka një përlllogaritje të kostos së shtuar buxhetore se sa do mund të jetë.

Konstatohet, se në lidhje me “Blerjet e përqendruara”, pas propozimeve të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në komunikimin elektronik të datës 04.12.2023 dhe 06.12.2023 kundrejt APP-së, janë riformuluar pikat 1 dhe 2 të nenit 53. Konkretisht, me rregullimet e propozuara parashikohet që, Këshilli i Ministrave me nismën e tij krijoi një organ qendror blerës dhe për procedura të veçanta prokurimi mund të ngarkojë një autoritet ose ent kontraktor përveçse në cilësinë e një organi qendror blerës, edhe në cilësinë e një organi që do të zhvillojë një procedurë prokurimi për objekte të caktuara.

-Në nenin 100 “E drejta e animimit” është shtuar në draft ligj pika e parë. Ku shprehet, se ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik palët e interesuara kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Pra, përpara përcaktimit se operatori ekonomik duhet të paraqesë ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, është saktësuar se, fillimisht operatori ekonomik i interesuar për çdo pretendim të tij lidhur me veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor që gjykon se vijnë në kundërshtim me ligjin, pasi të përfundojë shqyrtimin administrativ, gëzon të drejtën e ankimit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit

kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu. Gjithashtu është propozuar që nëSPE të njoftojë në mënyrë automatike operatorët ekonomikë për datën e fillimit dhe përfundimit të afateve të ankimit, duke shmangur kështu të gjitha paqartësitë që shfaqen në përlllogaritjen e këtyre afateve si nga AK ashtu edhe Operatorët Ekonomike.

Në vijim të saktësisimit të kompetencës së APP, sipas nenit 23, shkronja “dh”, saktësohen edhe parashikimet e mësipërme, ligjore në lidhje me kryerjen e hetimit administrativ nga ana e APP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, bazuar në dokumentacionin e administruar nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Gjithashtu, në vijim të ndryshimeve të nenit 17, të LPP, lidhur me detyrimin për përdorimin e mjeteve elektronike për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit gjatë zbatimit të kontratës, shtohet në draftligj germa “a”, të pikës 2, të nenit 129, parashikimi për të drejtën e APP që të kryejë hetime administrative edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave.

- **Ankimi administrativ në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.**

Sipas parashikimeve ligjore të Ligjit nr.162/2020, në nenin 12 të tij përcaktohet se:

“1. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, që edhe pse nuk përjashtohen nga zbatimi i pikës 1, në rast se interesat thelbësorë të shtetit nuk mund të garantohen me mënyra më pak ndërhyrëse si vendosja e kriterëve, që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit.

3. Në rastin e kontratave të përziera, që kanë si objekt të tyre prokurimin që mbulohet nga ky ligj dhe prokurimin që mbulohet nga legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zbatohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.”

Duke patur në vëmendje së për këto lloj kontratash publike, përvec Ligjit Nr.162/2020, operojnë në përputhje me normat e legjislacionit të veçantë. Konkretisht sipas Ligjit Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes” dhe VKM Nr.1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar një mungesë koherence të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, përse i takon afateve të ankimit administrative. Konkretisht, sipas Ligjit Nr.36/2020 në neni 53 pika 2 dhe 3, përcaktohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Afatet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, shkurtohen me 5 ditë në rastet e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike.

Ndërkohë që ne VKM Nr.1170, datë 24.12.2020 neni 62 pika 4 dhe 5, përcaktohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi dhe konfuzion për OE në lidhje me afatin përfundimtar në rastin e ankesave, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacion me shkresën nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024 nga Agjensia e Prokurimit Publik.

Pretendimet e paraqitura janë si më poshtë vijon:

Në kushtet kur, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, APP nuk ka kompetencë për të ndërmarrë nisma legjislative në këtë fushë, APP

nëpërmjet shkresës Nr. 1902 prot., datë 23.02.2024, me lëndë: “Mbi zbatimin e rekomandimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e ka adresuar këtë problematikë dhe rekomandimin tuaj pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si institucioni, i cili ka propozuar miratimin e VKM Nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pasi lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet në lidhje me situatën, e cila është reflektuar në këtë pjesë të raportit, ku APP ka marrë në konsideratë këtë problematikë dhe ka adresuar tek Ministria e Mbrojtjes, në rolin e institucionit përgjegjës për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Konkretisht, gjetja nuk është kundërshtuar, grupi i auditimit vlerëson se përgjegjësia e drejtpërdrejtë, për shkak të kompetencave që dikton ligji, është Ministria e Mbrojtjes.

Titulli i gjetjes	<i>Moskoherenca mes kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, përsa i takon afateve të ankimimit administrative, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.</i>
	Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar një mungesë koherence të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, përsa i takon afateve të ankimimit administrative. Konkretisht, sipas Ligjit Nr.36/2020 në neni 53 pika 2 dhe 3, përcaktohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Ndërkohë që në VKM Nr.1170, datë 24.12.2020 në neni 62 pika 4 dhe 5, përcaktohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.
Kriteri	-Ligjit Nr.36/2020 në neni 53 pika 2 dhe 3; -VKM Nr.1170, datë 24.12.2020 në neni 62 pika 4 dhe 5.
Ndikimi/Efekti	Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi dhe konfuzion për OE në lidhje me afatin përfundimtar në rastin e ankesave, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës. Duke mos pasur një koherencë dhe përputhje të bazës ligjore dhe statutit të institucionit, në këtë mënyrë lihet një hapësirë e gjerë interpretative mbi afatet e ankimimit.
Shkaku	Mospërputhja mes dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga APP në bashkëveprim me Ministrinë e Mbrojtjes në rolin e institucionit përgjegjës për prokurimet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të merren masa të menjëhershme për propozimin e miratimit e ndryshimeve të nevojshme, me qëllim që të shmanget kjo papajtueshmëri dhe mungesë koherence ligjore.

- ***Nevoja për përmirësimin të kuadrit rregullator për Ankandin Publik.***

Agjencia e Prokurimit Publik, i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj, ndër të tjera, në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar. Konkretisht, kompetencat që institucioni i APP-së ka në fushën e ankandëve publike parashikohen në nenin 7 të LAP. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të shitjes me ankand bëhet nga APP, në ushtrim të funksioneve për ankandet ka këto kompetenca : u kërkon autoriteteve shitëse raportime periodike, një herë në 6 muaj, për ankandet publike të realizuara dhe zbatimin e procedurave të tyre; verifikon zbatimin e procedurave të ankandëve publike pas nënshkrimit të kontratës, në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve shitëse të gjithë informacionin e nevojshëm; i propozon autoritetit shitës marrjen e masave disiplinore dhe vendos gjoba nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji; shpall përjashtimin 1 deri në 3 vjet nga procedurat e ankandit publik të ofertuesve, të cilët gjatë një procedure shitjeje kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë; raporton një herë në 6 muaj pranë Këshillit të Ministrave për kontratat e shitjes, të realizuara me ankand publik.

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se institucioni i APP-së në kuadër të zbatimit të detyrave të saj, gjatë komunikimit me autoritetet shitëse lidhur me problematikat e evidentuara gjatë zhvillimit të ankandit, pas analizimit të informacionit të marrë, ka bërë raportimin tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë. APP në shkresën e drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.6538 prot., datë 26.08.2022, vlerëson se kuadri rregullator i ankandit publik referuar problematikave të ardhura ka nevojë duhet të ketë disa përmirësime. Duke marr shkas nga shfaqja e problematikave nga APP dhe se APP është organi mbikëqyrës për zbatimin e këtyre lloj procedurave, grupi i auditimit vlerësoi të nevojshme të shikohej edhe mospërputhja e Ligjit të Ankandit Publik.

Legjislacioni në fuqi për Ankandin Publik është ai me Nr.9874, datë 14.02.2008, ku në tërësinë e tij ka referenca me Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”.

-Konkretisht, nga ana e grupit të auditimit konstatohet se ka një mos përputhje ndërmjet nenit 4 pika 1 d) të LAP Nr.9874/2008, ku citohet se ky ligj zbatohet edhe për objekte të përcaktuara me ligj të veçantë, ndërkohë që pika 3, e po këtij neni, përcakton se ky ligj nuk zbatohet për rastet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji dhe për ato të cilat rregullohen me ligj tjetër. Rastet kur nuk zbatohen janë kur objekti i shitjes është një objekt i trashëgimisë kulturore me vlera historike, kombëtare, shkencore, kulturore, arkeologjike; kur shitja e objektit publik rregullohet me akte të tjera ligjore; në shitjen e monedhave prej ari, argjendi, platini; në shitjen e armëve, të teknikës, pajisjeve, municioneve, lëndëve eksplozive dhe të materialeve luftarake e të shërbimeve të lidhura me to, të hequra nga armatimi dhe përdorimi, që do të shiten për përdorim ushtarak; kur autoriteti shitës rrezikon të botojë të dhëna, që mund të çënojnë interesat thelbësorë të sigurisë kombëtare; ky ligj nuk zbatohet për shitjet publike, të cilat kërkojnë masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; në rast se ky ligj bie ndesh me një detyrim, që shteti ka në bazë të një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera apo me një organizatë ndërkombëtare, që është ratifikuar me ligj, atëherë zbatohen dispozitat e marrëveshjes në fjalë. Në të gjitha rastet e tjera, procedurat e ankandit publik i nënshtrohen këtij ligji; procedura e ankandit publik nuk zbatohet në rastet kur objekt i shitjes publike janë ndihmat, kreditë për aq sa ato bien në kundërshtim me kushtet dhe marrëveshjet e miratuara me donatorët. Pra Neni 4 i Ligjit, ka një moskoherencë mes pikës 1 d) dhe 3 të tij, duke lejuar zbatimin e ligjit për objekte me ligj të veçantë dhe në pikën tjetër duke i përjashtuar.

-Në nenin 8, të LAP, përcaktohet se: *“Të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kandidatëve blerës nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të autoriteteve shitëse në fushën e ankandit publik mbrohen nga Avokati i Prokurimeve”*. Por, Avokati i Prokurimeve Publike e ka përfunduar veprimtarinë e tij, pas miratimit të Ligjit Nr.131/2012, duke sjellë paqartësi dhe konfuzion tek kandidatët blerës, në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të tyre, duke ju drejtuar një organi i cili ka përfunduar veprimtarinë e tij.

- Sa i takon organizimit të Ankandit Publik, në pikën 4 të nenit 6 të LAP, përcaktohet se *“Autoriteti*

shitës, çdo 6 muaj, duhet të dorëzojë në Agjencinë e Prokurimit Publik një raport për veprimtarinë e tij të ankandit. *Formati dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e ankandit.*”, ndërkohë që në pikën 2 të gërmës a) të nenit 7, përcakton se “Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrimin e funksioneve për ankandet, ka këto kompetenca: a) u kërkon autoriteteve shitëse raportime periodike, një herë në 6 muaj, për ankandet publike të realizuara dhe zbatimin e procedurave të tyre.” Sa më sipër, ligji nuk ka përcaktime të qarta përsa i përket procesit të raportimit mbi veprimtarinë e ankandit publik. Gjithashtu, në pikën 4, të nenit 6 të LAP përcaktohet se: “...*Formati dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e ankandit*”.

Por, rregullat e ankandit publik nuk kanë përcaktime në lidhje me formatin e raportit, pra nuk ka një dokument standard, gjë e cila në praktikë do të sjellë vështirësi në përpilimin e dokumentit jo vetëm për autoritetet shitëse, por edhe vetë për APP-në në lidhje me raportimin kombëtar të realizimit të ankandëve për vitin pasardhës.

-Sikur në Ligjin e Prokurimeve Publike janë të përcaktuar kriteret detyruese për skualifikim, siç janë mos qënia i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të cilat ligji i përcakton. Por ligji për Ankandet nuk parashikon asnjë kriter të tillë, e në këtë mënyrë me anë të këtij mosveprimi padashur lejohen që subjekte ose persona të cilët kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë të kenë mundësinë e përfitimit në kontrata publike.

-Në pikën 2 të nenit 1 të LAP, përcaktohen se qëllimi i këtij ligji janë: “a) rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e ankandit publik, të kryera nga autoritetet shitëse; b) nxitja e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik; c) nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve; ç) sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e ankandit publik; d) sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e ankandit publik.”, por në rregullat e ankandit publik nuk ka përcaktime lidhur me detyrimin e autoriteteve shitëse, për të argumentuar kriteret e kualifikimit, mbi bazën e të cilave bëhet përzgjedhja e ofertuesve të suksesshëm.

Në funksion të shmangies së vendosjes së kriterëve joproportionale, të cilat kufizojnë konkurrencën, në Ligjin e Prokurimeve Publike, parashikohet si detyrim argumentimi i kriterëve të kualifikimit, ligjërishit dhe teknikisht). Përsa kohë qëllimi i këtij ligji është rritja e efikasitetit dhe efikasitetit, lind nevoja e këtyre ndryshimeve ligjore. Sa më sipër, institucioni i APP-së nuk ka kompetenca të ndërmarrë iniciativë legislative në fushën e ankandëve publike, dhe kuadri rregullator aktual përcakton Ministrinë përgjegjëse për ekonominë si institucionin që mund të propozojë pranë Këshillit të Ministrave, shitjen nëpërmjet ankandit publik edhe për objekte të tjera, pronë publike, si dhe hartimin e dokumenteve standarde të ankandit.

• ***Mos përputhja me Dokumenteve standarde të Ankandit dhe Ligjit Nr.9874. datë 14.02.2018 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.***

-Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në lidhje me Dokumentet standarde të ankandit, ka një mospërputhje ndërmjet pikës 3 të nenit 20, ku përcaktohet se autoriteti shitës negocion me ofertuesit, për t’iu përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftim në mënyrë që të kenë si rezultat përzgjedhjen e ofertës më të mirë. Por, në pikën 5.1 të DSA shprehet se “Nuk do të kryhet asnjë negociatë me Ofertesin në lidhje me ofertën e tij”, përsëri ka një mospërputhje ligjore, e cila sjellë problematika në praktik.

- Nga ana e grupit të auditimit konstatohet një mos përputhje në afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimi të tij, konkretisht në shtojcën 7 të DSA përcaktohet se subjekti fitues ka afat 30 ditë kohë për tu paraqitur për formulimin e sigurimit të kontratës. Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi në lidhje me afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimi të tij, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës.

Nga ana tjetër, në nenin 39, pika 3 e LAP, përcaktohet se “Autoriteti shitës dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën brenda 10 ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike. Kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit”.

Lidhur me problematiken e DSA, të trajtuara më sipër, në pikën 3, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “*Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dokumentet standarde të ankandit publik, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.*”

-Gjithashtu duke pasur në vëmendje së sipas përcaktimeve të këtij ligjit, autoriteti shitës shet pronën publike nëpërmjet 4 formave, kjo sipas nenit 17 të LAP. Por, ka vetëm 1 standard Dokumenteve Standarde të Ankandit, edhe pse janë 4 procedura të ndryshme edhe pse VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 përcakton se: “*Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dokumentet standarde të ankandit publik, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.*”. Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se në zbatim të kësaj VKM, MFE nuk ka ndërmarrë veprim për hartimin e DSA në katër forma të ndryshme.

Me anë të shkresave Nr. 6511/4 prot., datë 26.04.2023 dhe Nr.6561/1 prot., datë 25.08.2023, APP përsëri ka parashtruar para Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nevojën e menjëhershme për përmirësim të kuadrit rregullator të Ankandit Publik duke qenë se nga e MFE nuk është marrë asnjë iniciativë për përmirësim në këtë fushë të kuadrit ligjor.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacion me shkresën nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024 nga Agjensia e Prokurimit Publik.

Pretendimet e paraqitura janë si më poshtë vijon:

Në kushtet kur, APP nuk ka kompetenca të ndërmarrë iniciativa legislative në fushën e ankandëve publike, dhe kur kuadri rregullator aktual përcakton ministrinë përgjegjëse për ekonominë si institucionin që mund të propozojë pranë Këshillit të Ministrave, shitjen nëpërmjet ankandit publik edhe për objekte të tjera, pronë publike (përveç atyre të përcaktuara në LAP), si dhe hartimin e dokumenteve standarde të ankandit, APP nëpërmjet shkresës Nr. 1802/2 prot., datë 23.02.2024, me lëndë: “Mbi nevojën për përmirësimin e kuadrit rregullator të ankandit publik”, e ka adresuar këtë problematikë dhe rekomandimin tuaj pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Referuar VKM Nr. 30, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është ministria përgjegjëse për ekonominë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pasi lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet në lidhje me situatën, e cila është reflektuar në këtë pjesë të raportit, ku APP ka konstatuar se, kuadri rregullator dhe dokumentet standarde të ankandit mbartin një sërë problematikash dhe i ka marrë në konsideratë. Konkretisht, gjetja nuk është kundërshtuar, grupi i auditimit vlerëson se përgjegjësia e drejtëpërdrejtë, për shkak të kompetencave që dikton ligji, është Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe APP të riadresoje përsëri problematikën. Përsa kohë qëllimi këtij ligji është rritja e efikasitetit dhe efikasitetit, lind nevoja e këtyre ndryshimeve ligjore.

Titulli i gjetjes	<i>Problematikat e hasura me kuadri rregullator dhe dokumentet standarde në fushën e prokurimeve të ankandëve publike.</i>
Situata	-Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në lidhje me Dokumentet standarde të ankandit, ka një mospërputhje ndërmjet pikës 3 të nenit 20, ku përcaktohet se autoriteti shitës negocion me ofertuesit, për t’iu përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftim në mënyrë që të kenë si rezultat përzgjedhjen e ofertës më të mirë. Por, në pikën 5.1 të DSA shprehet se “Nuk do të kryhet asnjë negociatat me Oferuesin në lidhje me ofertën e tij”, përsëri ka një mospërputhje ligjore, e cila sjellë problematika në praktik. - Nga ana e grupit të auditimit konstatohet një mos përputhje në afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimi të tij, konkretisht në

	<p>shtojcën 7 të DSA përcaktohet se subjekti fitues ka afat 30 ditë kohë për tu paraqitur për formulimin e sigurimit të kontratës. Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi në lidhje me afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimi të tij, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Nga ana tjetër, në nenin 39, pika 3 e LAP, përcaktohet se “<i>Autoriteti shitës dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën brenda 10 ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike. Kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit</i>”.</p> <p>Lidhur me problematiken e DSA, të trajtuara më sipër, në pikën 3, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “<i>Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dokumentet standarde të ankandit publik, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.</i>”</p> <p>-Ka vetëm 1 standard Dokumenteve Standarde të Ankandit, edhe pse janë 4 procedura të ndryshme. Pavarësisht faktit se VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 përcakton se: “<i>Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dokumentet standarde të ankandit publik, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.</i>”.</p> <p><i>Me anë të shkresave Nr. 6511/4 prot., datë 26.04.2023 dhe Nr.6561/1 prot., datë 25.08.2023, APP përsëri ka parashtruar para Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nevojën e menjëhershme për përmirësim të kuadrit rregullator të Ankandit Publik duke qenë se nga e MFE nuk është marrë asnjë iniciativë për përmirësim në këtë fushë të kuadrit ligjor.</i></p>
Kriteri	-Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar; -VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar.
Ndikimi	Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi dhe konfuzion për OE, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës.
Shkaku	Mospërputhja mes dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga APP në bashkëveprim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e institucionit përgjegjës për prokurimet në fushën ankandeve publike, të merren masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve të kuadrit rregullator në fuqi dhe hartimin e dokumenteve standarde të ankandeve.

- ***Mbi problematikat e Udhëzimit Nr.2, datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje reigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje të mjedisit”.***

Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se Agjencia e Prokurimit Publik, gjatë periudhës kohore Shtator 2022 - Mars 2023, ka verifikuar disa procedura ankandi publik, të zhvilluara nga autoritete të ndryshme shitëse për vitin 2021, ku një ndër procedurat e verifikuara ka për objekt; “Shitjen e materialit drusor të vlerësuar në ngastrat e dëmtuara nga faktorë të ndryshëm natyrore dhe nga zjarret” në përputhje me nenin 7, pika 2, gërma “b”, të LAP.

Nga procesi i verifikimit ka rezultuar se, disa nga kriteret e pranimit të përcaktuara nga autoriteti shitës në dokumentet e ankandit, janë bazuar në Udhëzimin nr. 2, date 03.03.2017, të Ministrisë së Mjedisit. Konkretisht, në pikën I, kreu XI të udhëzimit, përcaktohen kriteret që duhet të

plotësojnë subjektet për shfrytëzimin e ngastrave me rrugë auto pyjore.

Legjislacioni i ankandit publik ka ndër qëllimet kryesore të tij, nxitjen e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik dhe në veçanti të biznesit të vogël dhe të mesëm. Gjithashtu, legjislacioni i ankandit publik i jep mundësinë si personave fizikë, ashtu edhe atyre juridike për të qenë ofertues në një procedurë ankandi.

Sa më sipër, u konstatua se disa nga kriteret e përcaktuara në udhëzim nuk janë në harmoni me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik dhe konkretisht: pika 1 e kreut XI të udhëzimit, i referohet **“vetëm”** subjekteve juridike, ndërkohë kjo bie në kundërshtim me pikën 3 të nenit 3 të LAP Nr.9874, datë 14.02.2008, ku përcakton se *“Kandidatë Blerës janë të gjithë personat fizikë ose juridikë që kërkojnë të marrin pjesë me ofertën e tyre në procedurën e shitjes publike nëpërmjet ankandit publik”*. Pra kemi një mungesë koherence ndërmjet Udhëzimit të nxjerrë nga Ministria e Turizmit dhe Ligjit të Ankandive Publike.

Konstatohet, se në pikën 1/a të kreut XI të po këtij udhëzimi është përcaktuar përvoja e mëparshme të cilën duhet të këtë subjekti, por nuk është vendosur një vlerë minimale e lejuar, në të cilën kontratat për trajtimin dhe vjeljen e materialit drusor në pyje duhet të paraqiten, në mënyrë që kandidatët ofertues të konsiderohen të kualifikuar. Mos përcaktimi i një vlerë minimale të lejuar, shkakton një konfuzion të kandidatët blerës të interesuar, si dhe krijon problematika gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

-Në pikën 1/b dhe 1/c të kreut XI të udhëzimit, është përcaktuar që subjektet të kenë në pronësi kapacitete teknike e teknologjike për punime pyjore e me impakte të ulëta mjedisore, si dhe makineri e pajisje të përshtatshme për ndërtimin e mirëmbajtjen e rrugëve autopsyjore. Në funksion të nxitjes së pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik, është e nevojshme që të mund të parashikohet edhe mundësia e marrjes së mjeteve me qira nga të tretët. Ku në një formë tjetër mund të përdoret duke nënkontraktuar subjekte të tjera. Sic edhe Ligji i Prokurimeve Publike, lejon nënkontraktimin e mundshëm përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, për sa kohë nuk cenohen parimet e ligjit.

- Në pikën 1d) të kreut XI të udhëzimit, është përcaktuar numri i punonjësve që duhet të kenë subjektet për realizimin e kontratës. Përcaktimi i numrit të punonjësve duhet të bëhet nga autoriteti shitës mbi bazën e analizave teknike, ku të parashikohen fuqia punëtore që nevojitet për realizimin e kontratës, sipas grafikut të zbatimit të kontratës, si dhe afatit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës. Me shkresën Nr. 6511/3 prot., datë 26.04.2023, APP i drejtohet Ministrisë së Turizmit për problematikën e konstatuara. Por nuk ka gjurmë dokumentacioni nëse ka një kthim përgjigje nga ministria përkatëse.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacion me shkresën nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024 nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Pretendimet e paraqitura janë si më poshtë vijon:

Sikurse është vlerësuar edhe nga APP, disa nga kriteret e përcaktuara në udhëzim nuk janë në harmoni me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik. Për këtë qëllim, me shkresën nr. 6511/3 prot., datë 26.04.2023, ia ka adresuar këtë problematikë Ministrisë së Turizmit dhe i ka sugjeruar marrjen në konsideratë të iniciativës për rishikimin e këtij Udhëzimi, ndërkohë që nuk ka pasur një përgjigje të kësaj shkrese.

APP, nëpërmjet shkresës Nr. 1802/1 prot., datë 23.02.2024, me lëndë: *“Mbi problematikën e Udhëzimit nr. 2, datë 03.03.2017”*, e ka ri adresuar këtë problematikë dhe rekomandimin tuaj pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pasi lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet në lidhje me situatën, e cila është reflektuar në këtë pjesë të raportit, ku APP ka konstatuar se, disa nga kriteret e përcaktuara në udhëzim nuk janë në harmoni me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik dhe i ka marrë në konsideratë duke i ri adresuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Konkretisht, gjetja nuk është kundërshtuar, grupi i auditimit vlerëson se përgjegjësia e drejtëpërdrejtë, për shkak të kompetencave që dikton ligji, është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe APP të riadresoje

3. Titulli i gjetjes	<i>Mos koherenca ligjore mes kritereve të përcaktuara në Udhëzim nr. 2, datë 03.03.2017 me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik.</i>
Situata	<p>Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se Agjencia e Prokurimit Publik, gjatë periudhës kohore Shtator 2022 - Mars 2023, ka verifikuar disa procedura ankandi publik, të zhvilluara nga autoritete të ndryshme shitëse për vitin 2021, ku një ndër procedurat e verifikuara ka për objekt; “Shitjen e materialit drusor të vlerësuar në ngastrat e dëmtuara nga faktorë të ndryshëm natyrore dhe nga zjarret” në përputhje me nenin 7, pika 2, gërma “b”, të LAP. Nga procesi i verifikimit ka rezultuar se, disa nga kriteret e pranimit të përcaktuara nga autoriteti shitës në dokumentet e ankandit, janë bazuar në Udhëzimin nr. 2, date 03.03.2017, të Ministrisë së Mjedisit. Konkretisht, në pikën I, kreu XI të udhëzimit, përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për shfrytëzimin e ngastrave me rrugë autopsyjore.</p> <p>Legjislacioni i ankandit publik ka ndër qëllimet kryesore të tij, nxitjen e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik dhe në veçanti të biznesit të vogël dhe të mesëm. Gjithashtu, legjislacioni i ankandit publik i jep mundësin si personave fizikë, ashtu edhe atyre juridike për të qenë ofertues në një procedurë ankandi.</p> <p>Sa më sipër, u konstatua se disa nga kriteret e përcaktuara në udhëzim nuk janë në harmoni me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik dhe konkretisht: pika 1 e kreut XI të udhëzimit, i referohet “<i>vetëm</i>” subjekteve juridike, ndërkohë kjo bie në kundërshtim me pikën 3 të nenit 3 të LAP Nr.9874, datë 14.02.2008, ku përcakton se “<i>Kandidatë Blerës janë të gjithë personat fizikë ose juridikë që kërkojnë të marrin pjesë me ofertën e tyre në procedurën e shitjes publike nëpërmjet ankandit publik</i>”. Pra kemi një mungesë koherence ndërmjet Udhëzimit e nxjerrë nga Ministria e Turizmit dhe LAP.</p> <p>Gjithashtu, në pikën 1/a të kreut XI të po këtij udhëzimi është përcaktuar përvoja e mëparshme të cilën duhet të ketë subjekti, por nuk është vendosur një vlerë minimale e lejuar, në të cilën kontratat për trajtimin dhe vjeljen e materialit drusor në pyje duhet të paraqiten, në mënyrë që kandidatët ofertues të konsiderohen të kualifikuar. Mospërcaktimi i një vlerë minimale të lejuar, mund të shkaktojë konfuzion të kandidatët blerës të interesuar, si dhe të krijojë problematika gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.</p> <p>-Në pikën 1/b dhe 1/c të kreut XI të udhëzimit, është përcaktuar që subjektet të kenë në pronësi kapacitete teknike e teknologjike për punime pyjore e me impakte të ulëta mjedisore, si dhe makineri e pajisje të përshtatshme për ndërtimin e mirëmbajtjen e rrugëve autopsyjore. Në funksion të nxitjes së pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik, është e nevojshme që të mund të parashikohet edhe mundësia e marrjes së mjeteve me qira nga të tretët. Ku në një formë tjetër mund të përdoret duke nënkontraktuar subjekte të tjera. Sic edhe Ligji i Prokurimeve Publike, lejon nënkontraktim e mundshëm përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, për sa kohë nuk cenohen parimet e ligjit.</p> <p>- Në pikën 1d) të kreut XI të udhëzimit, është përcaktuar numri i punonjësve që duhet të kenë subjektet për realizimin e kontratës. Përcaktimi i numrit të punonjësve duhet të bëhet nga autoriteti shitës mbi bazën e analizave teknike, ku të parashikohen fuqia punëtore që nevojitet për realizimin e kontratës, sipas grafikut të zbatimit të kontratës, si dhe afatit përfundimtar të</p>

	ekzekutimit të kontratës. Me shkresën Nr. 6511/3 prot., datë 26.04.2023, APP i drejtohet Ministrisë së Turizmit për problematikat e konstatuara. Por nuk ka gjurmë dokumentacioni nëse ka një kthim përgjigje nga ministria përkatëse.
Kriteri	-Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar; -Udhëzimi Nr.2, datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje reigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje të mjedisit”.
Ndikimi	Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi dhe konfuzion për OE, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës.
Shkaku	Mospërputhja mes dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga APP, në bashkëveprim me Ministrinë e Turizmit, të merren masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve në kuadër të harmonizimit me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik rregullator në fuqi dhe udhëzimit të nxjerrë.

2.2 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.

1- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2021-2023, 2022-2024 dhe 2023-2025;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2021 dhe vitin 2022, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Agjencia e Prokurimit Publik e ushtron aktivitetin financiar në grupin 87 në programin buxhetor “01130 - Shërbimi i Prokurimit Publik” me kod programi 98702AA për shpenzimet korrente dhe 18AM201 për shpenzimet për investime.

APP është institucion qendror në varësi të Kryeministrit dhe i ushtron detyrat e saj në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik, koncesioneve dhe PPP-ve, si dhe ankandit publik.

Programimi i PBA-së 2021-2024 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2021

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimit plotësues nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2021-2023

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 janë miratuar me VKM nr. 577 datë 22.07.2020 “Për miratimin e taveveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”.

Me shkresën nr. 4670/1 prot., datë 28.08.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP-së, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2021 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionin e APP-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023.” Me Urdhrin të DP nr. 6402/2, datë 20.08.2019 “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programeve në APP”, u ngrit EMS për programin buxhetor “Shërbimi i Prokurimit Publik.”

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I^ë të PBA 2022-2024

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”, APP ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, i cili është dërguar me shkresën nr.1905/1 prot., datë 29.04.2021. Bazuar në VKM nr. 119 datë 3.3.2021 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, u miratuan tavanet përgatitore për ministritë dhe institucionet buxhetore.

Me Urdhrin të DP nr. 6402/2, datë 20.08.2019 “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programeve në APP”, u ngrit EMS për programin buxhetor “Shërbimi i Prokurimit Publik”.

Me shkresën nr. 1905/1 prot., datë 28.04.2021, APP dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE “Program Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, faza strategjike.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2022-2024

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 janë miratuar me VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Me shkresën nr. 4952/1 prot., datë 30.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm në APP, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2022 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionin e APP-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”.

Tabela nr./1 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2022-2024 të hartuar nga APP, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2021), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Fakti 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
600. Pagat	39,762	44,000	44,000	44,000
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore	6,568	7,300	7,300	7,300
602. Mallrat dhe shërbimet	3,294	10,892	8,500	9,000
606. Transferata për familjet dhe individët	94.0	-	-	-
231. Aktivët e trupëzuara	38	1,000	1,000	1,000
TOTALI	49,756	63,192	60,800	61,300

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shuma e planifikuar prej **63,192** mijë lekë për vitin 2022 në PBA është më e lartë krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2021 në shumën **49,756** mijë lekë, ose me një rritje në masën prej **24%**.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I^ë të PBA 2023-2025

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE

nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, APP ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Bazuar në VKM nr. 130 datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, u miratuan tavanet përgatitore për ministritë dhe institucionet buxhetore.

Me shkresën nr.1728/3 prot., datë 29.04.2022, APP dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE “Program Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, faza strategjike.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2023-2025

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKM nr. 535 datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Me shkresën nr. 5497/1 prot., datë 30.08.2022 të DP në APP, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2023 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionin e APP-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”.

Tabela nr./2 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2023-2025 të hartuar nga APP, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2022), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025
600. Pagat	44,662	55,200	55,200	55,200
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	7,378	8,980	8,980	8,980
602. Mallrat dhe shërbimet	4,556	11,500	11,620	11,620
606. Transferata për familjet dhe individët	884	-	-	-
231. Aktivitetet e trupëzuar	976	1,000	1,000	1,000
TOTALI	58,456	76,680	76,800	76,800

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shuma e planifikuar prej **76,680** mijë lekë për vitin 2023 në PBA është më e lartë krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2022 në shumën **58,456** mijë lekë, ose **me një rritje në masën prej 24%**.

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2021

Në zbatim të Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr. 8255 prot., datë 23.12.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresat nr.23724/97, datë 18.01.2021 dhe nr.23724/107, datë 18.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale.

Në mijë lekë

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2021-2023	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2021	Buxheti i Rishikuar i vitit 2021	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
87	Shërbimi i Prokurimit publik	62,300	62,300	57,800	4,500

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Për vitin 2021, janë planifikuar në PBA 2021-2023, shuma prej 62,300 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2021, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 57,800 mijë nga APP, pra 4,500 mijë lekë më

pak se plani në PBA.

Rishikimet e buxhetit gjatë vitit 2021

Me anë të shkresës nr.1375 prot., datë 16.02.2021, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka kërkuar pakësimin e llogarisë ekonomike 602 “Shpenzime operative” dhe shtimin e llogarisë ekonomike 606 “Transferta për familjet dhe individët” në vlerën 120 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 3354/1 Prot., datë 22.02.2021.

Me anë të shkresës nr.4182 prot., datë 23.06.2021, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka kërkuar pakësimin e llogarisë ekonomike 602 “Shpenzime operative” dhe shtimin e llogarisë ekonomike 600 dhe 601 “Shpenzime për paga” në vlerën 2,400 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 11435/1 Prot., datë 08.07.2021.

Viti 2022

Në zbatim të Ligjit nr.115, datë 16.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr.6246 prot., datë 28.12.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresat nr.22922/97, datë 18.01.2022 dhe nr.22922/107, datë 18.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale.

Në mijë lekë

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2022-2024	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2022	Buxheti i Rishikuar i vitit 2022	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
87	Shërbimi i Prokurimit publik	63,192	63,192	62,620	572

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Për vitin 2022, janë planifikuar në PBA 2022-2024, shuma prej 63,192 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2022, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 62,620 mijë lekë nga APP, pra 572 mijë lekë më pak se plani në PBA.

Rishikimet e buxhetit gjatë vitit 2022

Me anë të shkresës nr.773 prot., datë 27.01.2022, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka kërkuar pakësimin e llogarisë ekonomike 602 “Shpenzime operative” dhe shtimin e llogarisë ekonomike 606 “Transferta për familjet dhe individët” në vlerën 140 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 1568/1 Prot., datë 02.02.2022.

Me anë të AN nr.3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i rishikuar i institucionit të APP ka ndryshuar nga 63,192 mijë lekë, në 60,820 mijë lekë, i dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me anë të shkresës nr.4934/3 prot., datë 17.03.2022.

-Me anë të shkresës nr.5872/1 prot., datë 31.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka kërkuar pakësimin e llogarisë ekonomike 600 “Shpenzime për paga” dhe shtimin e llogarisë ekonomike 601 “Shpenzime për sigurime shoqërore” në vlerën 300 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 14405/136 Prot., datë 08.09.2022.

Me anë të AN nr.17, datë 05.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i rishikuar i institucionit të APP ka ndryshuar nga 60,820 mijë lekë, në 62,620 mijë lekë, i dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me anë të shkresës nr.22351 prot., datë 05.12.2022.

Viti 2023

Në zbatim të Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr.6231 prot., datë 28.12.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresat nr.22851/116, datë

20.01.2023 dhe nr. 22851/148, datë 25.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale.

kapitale.

Në mijë lekë

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2023-2025	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2023	Buxheti i Rishikuar i vitit 2023	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
87	Shërbimi i Prokurimit publik	76,680	76,680	76,680	-

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Për vitin 2023, janë planifikuar në PBA 2023-2025, shuma prej 76,680 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2023, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 76,680 mijë lekë nga APP, pra nuk ka ndryshime.

Rishikimet e buxhetit gjatë vitit 2023

-Me anë të shkresës nr.792 prot., datë 23.01.2022, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka kërkuar pakësimin e llogarisë ekonomike 606 “*Transferta për familjet dhe individët*” dhe shtimin e llogarisë ekonomike 602 “*Shpenzime operative*” në vlerën 144 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 1644/1 Prot., datë 06.02.2023.

-Me anë të shkresës nr.4176 prot., datë 29.05.2023, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka kërkuar pakësimin e llogarisë ekonomike 602 “*Shpenzime operative*” dhe shtimin e llogarisë ekonomike 600 dhe 601 “*Shpenzime për paga*” në vlerën 2,800 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 9849/1 Prot., datë 05.06.2023.

-Me anë të shkresës nr.4189 prot., datë 27.06.2023, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka kërkuar pakësimin e llogarisë ekonomike 602 “*Shpenzime operative*” dhe shtimin e llogarisë ekonomike 600 dhe 601 “*Shpenzime për paga*” në vlerën 3,100 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 11958/1 Prot., datë 27.06.2023.

-Me anë të shkresës nr.5807 prot., datë 27.07.2023, Drejtori i Përgjithshëm në APP ka paraqitur kërkesën për akordim të fondit rezervë në zbatim të VKM nr.325 datë 31.05.2023 “*Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë*”, duke pakësuar e llogarinë ekonomike 609 “*Fondi rezervë*” dhe duke shtuar e llogarinë ekonomike 600 dhe 601 “*Shpenzime për paga*” në vlerën 7,450 mijë lekë, e cila është miratuar nga SP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës 13902/1 Prot., datë 03.08.2023.

c) Realizimi i planit të buxhetit

Nga auditimi u konstatua se nga APP, si njësi shpenzuese, janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Raportet e monitorimit janë hartuar në bazë të programeve buxhetore nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve, ku monitorimi është kryer për programin buxhetor “Shërbimi i prokurimit publik” duke hartuar raportet 4 mujore monitorimi në përputhje me Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ*” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar të nenit 65.

Viti 2021

Raportet katër mujore të monitorimit për vitin 2021 janë dërguar si vijon:

- Me anë të shkresës nr.3461/2, datë 20.05.2021, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për

periudhën Janar-Prill 2021 në MFE;

- Me anë të shkresës nr.5934, datë 24.09.2021, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar-Gusht 2021 në MFE;

- Me anë të shkresës nr.1587, datë 28.02.2022, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar-Dhjetor 2021 në MFE;

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2021 rezulton si vijon:

Në lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	43,000	41,400	39,762	96%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	7,300	7,200	6,568	91%
602. Mallra dhe shërbime	11,000	8,080	3,294	41%
603.Subvencion	0	0	0	-
604. Transfera të brendshme	0	0	0	-
605. Transfera të jashtme	0	0	0	-
606. Transfera për familjet dhe individët	100	220	94	43%
231.Investim me financim të brendshëm	1,000	1,000	38	4%
231.Investim me financim të huaj	0	0	0	-
TOTALI	62,400	57,900	49,756	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Sa më sipër, vihet re se shpenzimet operative(artikulli 602-606) janë realizuar në shumën 3,388 mijë lekë ose 41%. Shkak për mosrealizimin e planit të shpenzimeve operative, janë bërë masat kufizuese që u ndërmorën për parandalimin e pandemisë Covid-19, duke mos realizuar zërat si: blerje bileta jashtë vendit, dieta brenda dhe jashtë vendit, qera salle etj.

Sa i takon artikullit 231 “Investime me financim të brendshëm”, e cila ishte planifikuar dhe çelur në shumën prej 1,000 mijë lekë për blerje pajisje elektronike dhe orendi zyre, rezulton se është realizuar në shumën prej 38 mijë lekë, për shkak të mosrealizimit të procedurës për blerjen e pajisjeve kompjuterike.

Viti 2022

Raportet katër mujore të monitorimit për vitin 2022 janë dërguar si vijon:

- Me anë të shkresës nr.3612, datë 23.05.2022, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar- Prill 2022 në MFE;

- Me anë të shkresës nr.6590, datë 28.09.2022, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar- Gusht 2022 në MFE;

- Me anë të shkresës nr.1516, datë 15.02.2023, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar- Dhjetor 2022 në MFE.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2022 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	44,000	46,430	44,662	96%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	7,300	7,818	7,378	94%
602. Mallra dhe shërbime	10,892	6,563	4,556	69%
603.Subvencion	0	0		
604. Transfera të brendshme	0	0		
605. Transfera të jashtme	0	0		
606. Transfera për familjet dhe individët	100	910	884	97%
231.Investim me financim të brendshëm	1,000	1,000	976	98%
231.Investim me financim të huaj	0	0	0	0%
TOTALI	63,292	62,720	58,456	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Sa më sipër, vihet re se shpenzimet operative(artikulli 602-606) janë realizuar në shumën 4,556 mijë lekë ose 69%. Shkak për mosrealizimin e planit të shpenzimeve operative, janë bërë masat kufizuese që u ndërmorën për parandalimin e pandemisë Covid-19, të cilat kanë ndikuar në mos realizimin në zërat si: dieta brenda dhe jashtë vendit, trajnime etj.

Sa i takon artikullit 231 “Investime me financim të brendshëm”, e cila ishte planifikuar dhe çelur në shumën prej 1,000 mijë lekë për blerje pajisje elektronike dhe orendi zyre, rezulton se është

realizuar në shumën prej 976 mijë lekë, fond i cili u përdor për blerjen e pajisjeve elektronike si kompjutera, printer, fotokopje etj.

- Me anë të shkresës nr.3821, datë 16.05.2023, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar- Prill 2023 në MFE;

Viti 2023

Raportet katër mujore të monitorimit për vitin 2023 janë dërguar si vijon:

- Me anë të shkresës nr.3821, datë 16.05.2023, APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar- Prill 2023 në MFE;

- Me anë të shkresës nr.7420, datë 27.09.2023 APP ka dërguar Raportet e monitorimit për periudhën Janar – Gusht 2023” në MFE;

Sa i takon raportit vjetor të monitorimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023, APP është në proces përgatitje.

Realizimi i 8 mujorit të vitit 2023

Sipas krahasimit të strukturës organizative dhe organikës në fakt në Tetor 2022 konstatohet se nga 48 punonjës në strukturë, dhe fakt janë 43 punonjës, pra 5 janë pozicione vakante, si dhe 10 punonjës me kontratë të përkohshme.

Raporti përmbledhës i monitorimit për periudhën Janar – Gusht 2023 i është dërguar MFE me shkresën me anë të shkresës nr.7420, datë 27.09.2023 “Raportet e monitorimit për periudhën Janar – Gusht 2023”.

Realizimi i buxhetit të APP-së për periudhën Janar – Gusht 2023 krahasuar me alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani 8 mujor	Realizimi faktik 8 mujor
600.Paga	46,180	38,840
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	0	6,356
602. Mallra dhe shërbime	5,456	1,736
606. Transfera për familjet dhe individët	244	183
231.Investim me financim të brendshëm	1,000.00	0
TOTALI	52,880	47,115

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të APP

Gjatë kësaj periudhe, fondet buxhetore janë realizuar në vlerën 47,115 mijë lekë dhe nga 52,880 mijë lekë të planifikuara, ose 89%.

- Realizimi i shpenzimeve për “Paga dhe sigurime shoqërore” është realizuar në masën 45,195 mijë lekë ose 98%, me një mosrealizim në shumën 985mijë lekë. Këto zëra shpenzimesh janë realizuar për një numër faktik prej 43 punonjës, nga 48 që ka miratuar ligji vjetor i buxhetit. Sipas krahasimit të strukturës organizative dhe organikës në fakt në gusht 2022 konstatohet se nga 145 punonjës në strukturë, 5 janë pozicione vakante, dhe mos realizimi i këtyre zërave shpenzimesh vjen për shkak të vendeve vakante në APP.

- Realizimi i shpenzimeve për “Mallra dhe shërbime” është realizuar në masën 1,736 mijë lekë ose 32%me një mosrealizim në shumën 3,720 mijë lekë.

Realizimi i llogarisë “602” konstatohet të jetë realizuar për shpenzime në përmbushje të detyrimeve të shtetit si shpenzimet për postë, telefon, siguracion mjete, taksa vendore etj. Mosrealizimi në shumën 3,720 mijë lekë ka ardhur si rezultat i moszhvillimit të disa procedurave të prokurimit si kancelari, materiale pastrimi etj.

- Realizimi i shpenzimeve për “Transfera” është realizuar në shumën 183 mijë lekë, të cilat kanë të bëjnë me kompensim për shpenzimeve për celular, shpërblim page për punonjës, etj.

- Sa i takon mosrealizimit të fondit prej 1,000 mijë lekë për investime për produktin “Blerje pajisje kompjuterike dhe pajisje zyre”, rezulton se ky fond është në proces prokurimi.

Sa i takon raportit vjetor të monitorimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023, APP është në proces përgatitje.

2.3 Auditimi i llogarive vjetore.

1.Mbi auditimin e llogarive vjetore

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

1. Formati 1:Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2:Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5:Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7:Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve).
8. Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Agjencia e Prokurimeve Publike, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- Për vitin 2022 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2396 Prot., datë 17.03.2023 “Mbi paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Auditimi i llogarive të performancës financiare

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në Pasqyrën e Performancës është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2022 paraqiten si vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 57,480 mijë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 57,617 mijë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85)= (137 mijë lekë)

Totali ii + iii= 57,480 mijë lekë

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepicës më 31.12.2021 me 31.12.2022, përkatësisht 1,227,021–1,089,876) rezulton -137,145 lekë, e cila rezulton e barabartë me shumatoren e llogarisë 63 dhe 73 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Performanca financiare e institucionit”. Nga analiza e llogarisë 2 “Gjendje Inventari qarkullues” rezulton të jetë regjistruar llogaria 31 “Materiale”.

Të ardhurat

‘në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
1	A	TE ARDHURAT	57,480,111	49,718,213	7,761,898
53	72	V.GRANTE KORENTE	57,480,111	49,718,213	7,761,898
54	720	1.Grant korrent i Brendshëm	57,480,111	49,718,213	7,761,898
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	52,729,990	46,160,673	6,569,317
61	7206	Financim i prishëm nga buxheti	4,750,121	3,557,540	1,192,581

Burimi: APP/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën e mësipërme, përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2022, në vlerën 57,480,111 lekë, ku përfshijnë llogarinë 720 “Grant korrent i brendshëm” në shumën 52,729,990 lekë, përbëhet nga llogaria: 7200 “Nga buxheti për NJQP(Qendrore)” në shumën 52,729,990 lekë, 7206 “Financim i prishëm nga buxheti” në shumën 4,750,121 lekë.

Shpenzimet

‘në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
74	B	SHPENZIMET	57,617,256	49,774,847	7,842,409
75	600	LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	44,662,405	39,761,948	4,900,457
76	6001	Paga, personel i përhershëm	39,926,492	37,578,322	2,348,170

77	6002	Paga personel i përkohshëm	4,735,913	2,183,626	2,552,287
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	7,377,493	6,568,170	809,323
81	6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	6,618,174	6,166,175	451,999
82	6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	759,319	401,995	357,324
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	4,555,846	3,294,002	1,261,844
85	6020	Materiale zyre e te përgjithshme	1,269,840	1,529,344	-259,504
86	6021	Materiale dhe shërbime speciale	12,000	19,576	-7,576
87	6022	Shërbime nga të tretë	402,840	409,243	-6,403
88	6023	Shpenzime transporti	270,123	401,271	-131,148
89	6024	Shpenzime udhëtimi	1,403,543	209,268	1,194,275
90	6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	226,000	189,400	36,600
91	6026	Shpenzime për qiramarrje	353,400	84,000	269,400
94	6029	Shpenzime te tjera operative	618,100	451,900	166,200
101		V.TRANSFERIME KORENTE	884,367	94,093	790,274
112	606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	884,367	94,093	790,274
114	6061	Transferita Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	884,367	94,093	790,274
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	137,145	56,634	80,511
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati I Veprimtarisë se vitit Ushtrimor)	-137,145	-56,634	-80,511

Burimi: APP/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën e mësipërme përfshihen shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2022, në vlerën 57,617,256 lekë, analizuar si më poshtë:

- Llogaria 600 “Paga e shpenzimeve personeli” në shumën prej 44,662,405 lekë, përfaqëson pagat e personelit të përhershëm.

- Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” në shumën prej 7,377,493 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

- Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në pasqyrën e performancës financiare paraqitet në shumën prej 4,555,846 lekë, e cila përbëhet nga llogaria 6020 “Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme” në shumën prej 1,269,840 lekë, llogaria 6021 “” në shumën prej 12,000 lekë, llogaria 6022 “Shërbime nga të tretët” në shumën prej 402,840 lekë, llogaria 6023 “Shpenzime transporti” në shumën 270,123 lekë, llogaria 6024 “Shpenzime udhëtimi” në shumën prej 1,403,543, llogaria 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje” në shumën prej 226,000 lekë, llogaria 6026 “Shpenzime për qiramarrje” në shumën 353,400 lekë dhe llogaria 6029 “Shpenzime të tjera Operative” në shumën prej 618,100 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kriterëve të klasifikimit buxhetor.

- Llogaria 606 “Transferita për buxhetet familjare dhe individët” në shumën prej 884,367 lekë përfaqëson shpenzime për pensione dhe shpenzime të tjera familjare.

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 137,145 lekë.

Pasqyrat Financiare viti 2022

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Agjencisë së Prokurimit Publik rezultoi:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=29,944 mijë lekë.**
- Aktivet 37,053 mijë lekë
- Pasivet 7,109 mijë lekë
- Aktivet neto 29,944 mijë lekë

I. Aktivet Afatshkurtra

Aktivitet afatshkurta më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **8,199,329 lekë** dhe përbëhen nga:
në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
2		I.Aktivitet Afatshkurtra	8,199,329	6,450,883
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	1,089,876	1,227,021
12	31	Materiale	392,799	532,944
13	32	Inventar i imët	697,077	694,077
21		3.Llogari te Arkëtushme	7,109,453	5,223,862
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	158,509	158,509
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	6,950,944	5,065,353

Burimi: APP/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 1,089,876 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 7,109,453 lekë.

▪ **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	1,089,876	1,227,021	-137,145
12	31	Materiale	392,799	532,944	-140,145
13	32	Inventar i imët	697,077	694,077	3,000

Burimi: APP/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të APP në 31.12.2022 paraqiten në shumën 1,089,876 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 392,799 lekë dhe llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 697,077 lekë.

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 137,145 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 137,145 lekë.

Për vitin 2022, është kryer inventarizimi i aktiveve, bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të APP nr. 114 , datë 22.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të APP për vitin 2022.”

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

▪ **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:**

Në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
21		3.Llogari te Arkëtushme	7,109,453	5,223,862	1,885,591
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	158,509	158,509	0
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	6,950,944	5,065,353	1,885,591

Burimi: APP/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në shumën 158,509 lekë përfaqëson të drejtat që i kanë lindur institucionit të APP-së për të arkëtuar debitorë, e cila daton që në vitin 2000. Kjo shumë përfaqëson gjoba të vena kundrejt punonjësve si vijon:

-A.	Z.	58,130 lekë
-S.	M.	50,379 lekë
-E.	A.	50,000 lekë
	Shuma	158 509 lekë

Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto të drejta nuk janë arkëtuar dhe kanë kaluar afatin e parashkrimit për arkëtimin e tyre. Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë kjo shumë rezulton e paarkëtueshme, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës.”

Nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Sa i takon rekomandimit tuaj, APP do ta mbajë në konsideratë, duke bërë sistemimet e llogarive në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare në vazhdim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër, nga subjekti i audituar janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna, të cilat janë pranuar dhe nga institucioni i APP-së do të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

Titulli i Gjetjes:	<i>Llogari të arkëtueshme</i>
Situata:	Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në shumën 158,509 lekë përfaqëson të drejtat që i kanë lindur institucionit të APP-së për të arkëtuar debitorë, e cila daton që në vitin 2000 dhe përfaqësojnë gjoba ndaj punonjësve. Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto të drejta nuk janë arkëtuar dhe kanë kaluar afatin e parashkrimit për arkëtimin e tyre. Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë <u>kjo shumë rezulton e paarkëtueshme</u> , pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 114.
Kriteri:	Kodi Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës.”
Ndikimi/Efekti:	Detyrime të cilat nuk kanë shpresë arkëtim, pasi ka humbur fuqia ligjore për ti kërkuar
Shkaku:	Mos marrja e hapave ligjor me kohë për të parandaluar parashkrimin tyre sipas përcaktimeve në Kodin Civil
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkuara dhe të parkëtueshëm, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Te drejta)” në shumën 6,950,944 lekë, përfaqëson detyrim ndaj një furnitori të hershëm në vlerën 1,507,813 lekë(viti 2007-2008), detyrimet për paga dhe sigurime shoqërore muaji Dhjetor 2022 në shumën 4,750,121 lekë dhe 693,010 lekë pagesa të kaluara me bankë në janar të vitit 2023, për për shërbim larje makina, shërbim posta etj. Kjo llogari ka si kundërpartit llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 dhe 437.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mospasqyrim i saktë i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”</i>
Situata:	Nga auditimi i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” u konstatua debitimi i shumës prej 1,507,813 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti.” Vlera prej 1,507,813 lekë e paraqitur në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është kontabilizuar jo në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë, vlerë e cila është e pidentifikuar dhe s’ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor.
Kriteri:	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”
Ndikimi/Efekti:	Nuk është vlerë që ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Spektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore së APP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 1,507,813 lekë, duke bërë veprimin kontabël kreditimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe debitimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

▪ **Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 28,853,670 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 30,468,347 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën (-1,614,677) lekë.

(Vlera kontabël neto)

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2022 (neto)	Shtesa 2022 (neto)	Pakësime 2022 (neto)	Gjendje në fund 2022 (neto)
	AAGJM	30,468,347	976,056	(2,167,754)	29,276,649
212	Ndërtesa e Konstruksione	24,842,524	0	(1,172,726)	23,669,798
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	476,222	87,600	(136,985)	426,837
215	Mjete transporti	1,310,534	0	(262,107)	1,048,427
218	Inventar ekonomik	3,839,067	888,456	(595,936)	4,131,587

Burimi: APP/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Ndërsa sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 67,532,880 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 66,556,824 lekë. Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

-Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto

23,669,798 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 24,842,524lekë. Nga auditimi i analitikut të llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, rezulton se gjatë vitit ushtrimor 2022 është pakësuar në vlerën 1,172,726 lekë, e cila përfaqëson amortizimin në normën 5%.

-Llogaria nr.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, paraqitet në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 426,837 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 476,222 lekë. Nga auditimi i analitikut të llogarisë nr.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, rezulton se gjatë vitit ushtrimor 2022 është shtuar në shumën 87,600 lekë, e cila përfaqëson blerjen e katër kompjuterëve Desktop, si dhe pakësuar në shumën 136,985 lekë, e cila përfaqëson amortizimin.

-Llogaria nr.218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 4,131,587 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 3,839,067 lekë. Nga auditimi i analitikut të llogarisë nr.218 “Inventar ekonomik”, rezulton se gjatë vitit ushtrimor 2022 është shtuar në shumën 888,456 lekë, e cila përfaqëson blerjen e pajisjeve elektronike, si dhe pakësuar në shumën 595,936 lekë, e cila përfaqëson amortizimin.

Titulli i Gjetjes:	Mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuar në planin kontabël publik
Situata:	Nga auditimi i llogarive 214 dhe 218 u konstatua se nga ana e Sektorit të Financës, pajisjet kompjuterike janë klasifikuar si në llogarinë 214, po ashtu dhe në llogarinë 218. Gjithashtu, nga analiza e zërave të aktiveve dhe amortizimin e tyre zë për zë u konstatua se artikulli “Kondicioner” është amortizuar me normën 25% duke e klasifikuar si “Kompjuteri, pajisje të ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni” ku norma e amortizimit llogaritet mbi bazë grupimi me normën 25%, Veprim jo në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 36, duke ndikuar në mos pasqyrimin e saktë të gjendjen neto të aktiveve, si dhe ndikimi i amortizimit vjetor në fondin neto të institucionit.
Kriteri:	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 36, si dhe VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik “.
Ndikimi/Efekti:	Mos evidentimi i saktë i vlerës neto të aktiveve që disponon institucioni, e cila ndikon në mos Planifikimin e saktë të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, qe janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.
Shkaku:	Aktivet, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, sipas planit kontabël, e cila ka ndikuar dh në mënyrën e përlllogaritjes së amortizimit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për riklasifikimin e artikullit “Kondicioner” në llogaritë kontabël 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune “, si dhe në ripërlllogaritjen e amortizimit të akumuluar me normën 20% të këtyre artikujve, me qëllim përcaktimin e vlerës reale neto të gjendjes së aktiveve që institucioni disponon.

-Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 1,048,427 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 1,310,534 lekë. Amortizimi i llogaritur rezulton në vlerën 262,107 lekë ose 20% mbi vlerën kontabël neto në çelje të vitit ushtrimor. Analitiku i llogarisë nr.215 “Mjete transporti” përbëhet nga një mjet transporti me vlerë historike 2,507,400 lekë, i cili është kalim kapitali nga institucioni i AKU.

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Agjencisë së Prokurimit Publik më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
66		I.Pasivet Afatshkurtra	7,109,453	5,223,862	1,885,591
67		Llogari të pagueshme	7,109,453	5,223,862	1,885,591
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	2,200,823	1,507,813	693,010
69	42	Detyrime ndaj personelit	3,178,885	2,384,678	794,207
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	324,354	240,611	83,743
75	435	Sigurime Shoqërore	988,672	735,932	252,740
76	436	Sigurime Shëndetësore	138,654	103,873	34,781
77	437,438	Organizma te tjerë shtetërore	119,556	92,446	27,110
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	158,509	158,509	0

Burimi: APP/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 401-408, “Furnitorë e llogari te lidhura me to”, në shumën 2,200,823 lekë, përfaqëson 693,010 lekë detyrim ndaj furnitorëve e krijuar në muajin Dhjetor 2022, si dhe detyrimi që ka institucionit i APP-së, në vlerën 1,507,813 lekë, furnitorë të palikuiduar për periudhën 2007-2008. Nga informacioni i vënë në dispozicion, rezulton se gjatë periudhës 2007-2008, është kryer shërbimi i botimit të Buletinit të Njoftimeve Publike nga subjekti “G”, dhe likuidimi i faturave nuk është bërë për shkak të mungesës së fondeve. Konkretisht fatura të pashlyera për vitin 2007 dhe 2008 janë:

- Fatura nr.16, datë 12.02.2007 shuma 349,188 lekë
- Fatura nr.24, datë 26.02.2007 shuma 444,822 lekë
- Fatura nr.28, datë 05.03.2007 shuma 120,233 lekë
- Fatura nr.31, datë 12.03.2007 shuma 129,768 lekë
- Fatura nr.32, datë 19.03.2007 shuma 169,591 lekë
- Fatura nr.21, datë 19.02.2007 shuma 36,605 lekë
- Fatura nr.20, datë 17.09.2007 shuma 31,724 lekë
- Fatura nr.09, datë 25.02.2008 shuma 60,584 lekë
- Fatura nr.11, datë 03.03.2008 shuma 165,298 lekë

Për faturat e datës 25.02.2008, 03.03.2008 dhe 17.09.2007 është bërë likuidim pjesor. Totali i pa likuiduar ndaj këtij subjekti është 1,507,813 lekë.

Nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Sa i takon rekomandimit tuaj, titullari i APP me urdhrin Nr. 35, datë 26.02.2024 ka ngritur një grup pune për këtë qëllim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër, nga subjekti i audituar janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna, të cilat janë pranuar dhe nga institucioni i APP-së do të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

Titulli i Gjetjes:	<i>Llogari të pagueshme</i>
Situata:	Në llogarinë 401-408, “Furnitorë e llogari te lidhura me to”, ndër të

	tjera, përfshihet dhe detyrimi që ka institucionit i APP-së, në vlerën 1,507,813 lekë, furnitorë të palikuiduar për periudhën 2007-2008. Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto detyrime nuk janë paguar, si dhe nga ana e furnitorit subjekti “G”, janë kaluar afatet e parashkrimit për pagesën e tyre. Nga ana e furnitorit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si dhe ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” ky detyrim është i parashkuar.
Kriteri:	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 114.
Ndikimi/Efekti:	Detyrime të cilat nuk kanë shpresë arkëtim, pasi ka humbur fuqia ligjore për t’i kërkuar.
Shkaku:	Mos marrja e hapave ligjor me kohë për të parandaluar parashkrimin tyre sipas përcaktimeve në Kodin Civil
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e titullarit të Agjencisë së Prokurimit Publik të merren masat për ngritjen e një grupi pune, me qëllim identifikimin e mundësive reale për pagesën e këtyre debitorëve apo për sistemimin e këtyre vlerave sipas parashikimeve në Kodin Civil

- Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë APP, paraqitet në vlerën 3,178,885 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor.
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatësisht në vlerat 324,354 lekë, 988,672 lekë dhe 138,654 lekë.
- Llogaria 437, 438 “Organizma te tjerë shtetërorë” në shumën 119,556 lekë përfaqëson kontributin e sigurimit suplementar Dhjetor 2022, të cilat paguhen në muajin Janar 2023.
- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin(detyrime)” përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme, e cila është kundërpartit e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 158,509 lekë.

Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto.

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” dhe rakordimi me pasqyrimin e vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim të drejtë të vlerave në pasqyrë.

Aktivët neto rakordojnë me fondet neto, por sa i takon zërit 1013 “Nga konsumi i AAGJ”, konstatohet një paraqitje jo e drejtë për shkak të përlllogaritjes së amortizimit të artikullit “Kondicioner”, i cili është amortizuar me normën 25% duke e klasifikuar si “Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni” ku norma e amortizimit llogaritet mbi bazë grupimi me normën 25%, Veprim jo në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 36, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar si vijon:

Nga auditimi u konstatua se Agjencia e Prokurimit Publik ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2023. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit në përputhje me Paragrafin nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar ku citon ... “ Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.”

-Llogaria nr.218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 4,131,587 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 3,839,067 lekë. Nga auditimi i analitikut të llogarisë nr.218 “Inventar ekonomik”, rezulton se gjatë vitit ushtrimor 2022 është shtuar në shumën 888,456 lekë, e cila përfaqëson blerjen e pajisjeve elektronike, si dhe pakësuar në shumën 595,936 lekë, e cila përfaqëson vlerën e amortizimit për vitin 2022.

- Inventarizimi fizik

Për vitet 2021-2023 janë ngritur komisionet e inventarizimit me urdhër e Drejtorit të Përgjithshëm të APP-së, përkatësisht:

Për vitin 2021, Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të APP nr. 52 , datë 21.12.2021 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të APP për vitin 2021”;

Për vitin 2022, Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të APP nr. 114 , datë 22.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të APP për vitin 2022.”

Për vitin 2023, Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të APP nr. 84 , datë 12.12.2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të APP për vitin 2023.”

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit është përgatitur relacioni mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorimi, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike) si vijon:

-Me anë të shkresës nr.7883/1 prot., datë 31.12.2021, komisioni i inventarizimit ka hartuar relacioni për inventarizimit e aktiveve për vitin 2021, ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues;

-Me anë të shkresës nr.9105 prot., datë 30.12.2022, komisioni i inventarizimit ka hartuar relacioni për inventarizimit e aktiveve për vitin 2022, ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues;

-Me anë të shkresës nr.9443/1 prot., datë 04.01.2024, komisioni i inventarizimit ka hartuar relacioni për inventarizimit e aktiveve për vitin 2023, ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues.

Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Në relacion komisioni është shprehur se nuk ka diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike.

2. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Agjencinë e Prokurimit Publik rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2021 janë në vlerën totale 49,756 mijë lekë;

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2022 janë në vlerën 58,456 mijë lekë;

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2023 janë në vlerën totale 51,288 mijë lekë.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër shpenzimeve të realizuara në muajin Prill, Nëntor, Dhjetor, viti 2021; Prill, Nëntor, Dhjetor, viti 2022; Korrik, Nëntor, Dhjetor, viti 2023.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*" veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Nga auditimi rezultoi:

-Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit përgjithësisht është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.

- Gjatë auditimit të transaksioneve me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë u përdorën teknikat e auditimit si: kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

Nga auditimi me zgjedhje të urdhër shpenzimeve konstatohet:

Proceset gjyqësore

Një ndër detyrat kryesore të APP, është vlerësimi i rasteve për përjashtim të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike, raste këto të evidentuara gjatë procesit të verifikimit apo shqyrtimit të raporteve të organeve të auditimit që kryen APP, ose si rezultat i propozimeve të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve të tjera audituese në ushtrim të funksioneve të tyre, të cilët kërkojnë përjashtimin e operatorëve ekonomikë.

Për vitin 2021 gjatë hetimit administrativ, nga ana e APP janë ndjekur në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë 59 çështje gjyqësore dhe për vitin 2022 janë ndjekur 50 çështje gjyqësore. Nga analiza e dokumentacionit të urdhër shpenzimeve për proceset gjyqësore për periudhën 01.01.2021-31.12.2023 u konstatua se, në urdhër shpenzimet e listuara si më poshtë janë paguar gjyqëfituesit dhe subjektet përmbaruese gjyqësore private për tarifën e shërbimit përmbarimor.

Në lekë

Vendimi gjyqësor	Urdhër shpenzimi	Përfituesi	Shpenzime gjyqësore	Tarife përmbarimi	Totali
Nr.2148 datë 04.06.2018	Ush. Nr. 42 datë 12.04.2021	Zyra përmbarimore Fier	20,000	2400	22,400
Nr. 1961 datë 22.06.2021	Ush nr.127 datë 12.11.2021	B.&I shpk	103,000	110,000	213,000
Nr. 2133 datë 05.07.2021	Ush nr. 128 datë 12.11.2021	R.B.S.shpk	100,000	18,000	118,000
Nr. 2973 datë 16.11.2020	Ush nr. 53 datë 11.05.2021	K.&Co B.	63,000	18,000	81,000
Nr.462 datë 02.03.2023	Ush nr. 92, 93 datë 12.07.2023	S. N.	53,200	61,200	114,400
Totali			339,200	209,600	548,800

Burimi: Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore APP

Sa i takon pagesave të vendimeve gjyqësore të mësipërme, pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga APP me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore në shumën prej 209,600 lekë, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin APP-së, veprime jo në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, neni 130 “Rregullat e njoftimit shkresor të akteve” ku citon se...”Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve”, neni 451/a ku citon se “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët” dhe neni 510/a “Titujt ekzekutivë”.

Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 130 “Rregullat e njoftimit shkresor të akteve” ku citon se... “Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve”, institucionit i lind e drejta për ti kërkuar gjyqëfituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë të tarifave të përmbaruesit gjyqësor.

Sa më sipër, nga ana e APP, janë dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë shkresat me nr.7825/2 datë 07.10.2019 dhe nr.8034/2 prot., datë 14.10.2019 duke ankimuar në lidhje me dy vendime të marra nga ana gjykatës, përkatësisht Vendimin nr.2409 datë 21.06.2018 dhe Vendimin nr. 1726 datë 07.05.2019 duke cituar se institucioni i APP-së është njohur me vendimet gjyqësore në momentin e dërgimit nga ana e përmbaruesit, pasi nuk janë vënë në dispozicion nga gjykata.

Me anë të shkresës me nr.7825/5 prot, date 17.10.2019, Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ka kthyer përgjigje në lidhje me pretendimet e mësipërme duke cituar se në dispozitivin e vendimeve, Gjykata nuk ka parashikuar të drejtën e ankimimit, madje e ka ndaluar atë, si dhe ka cituar se përfaqësuesi i APP-së ka qenë prezent në seancë duke qenë në dijeni të vendimmarrjes së Gjykatës. Përsa më sipër, Gjykata shprehet se nuk ka asnjë detyrim ligjor për të komunikuar vendime, kur nuk parashikohet e drejta e ankimimit.

Me anë të shkresës me nr.6769/10 prot.,datë 04.11.2019, Drejtori i Përgjithshëm i APP-së, ku është shprehur se referuar praktikave gjyqësore në seancat e shpalljes së dispozitivit të vendimit, në asnjë rast nga ana e gjykatës nuk përmendet vlera monetare e shpenzimit gjyqësor që duhet të paguajë pala që i ngarkohet ky detyrim, ku nga gjykata nuk ka me kthim përgjigje.

Nga ana tjetër, institucioni i APP-së i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, për dijeni të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr.5611/7 prot., datë 22.07.2019, nr.5611/12 prot., datë 19.09.2019, dhe nr.7825/8 prot., datë 24.10.2019, ku ka ngritur problemin në lidhje me pagimin e

shpenzimeve gjyqësore me përmbares privat, duke rënduar buxhetin e APP-së. Gjithashtu, APP citon se në çdo rast shpenzimet gjyqësore do të ekzekutohen nga APP, në cilësinë e palës së paditur me marrjen në dijeni të këtij vendimi, pa vlerësuar ndërhyrjen e menjëhershme të shoqërive përmbarimore. Sa më sipër, duke qenë se tarifat e shërbimit përmbarimor janë të përcaktuara në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe MFE, APP ka ngritur këtë problematikë, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e ndryshimeve të mundshme në aktet rregullatore që përcaktojnë këto tarifa.

Me anë të shkresës me nr.6476/3 prot., datë 11.11.2019 (prot., në APP me nr.8993, datë 13.11.2019), Sekretari i Përgjithshëm në MD, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe Dhomës Kombëtare të Përmbareseve Gjyqësor Privat, për dijeni të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, ka bashkëlidhur kërkesën e APP-së në lidhje me tarifat e larta të përmbarimit në raport me vlerën reale të detyrimit, duke kërkuar njëkohësisht jo vetëm rishikimin e nivelit tarifor, por edhe rishikimin e afateve kohore brenda të cilave duhet të ekzekutohen detyrimet. Për sa më sipër, Ministria e Drejtësisë, ka kërkuar qëndrimin dhe vlerësimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe Dhomës Kombëtare të Përmbareseve Gjyqësor Privat, përpara dhënies së orientimeve nga ana e MD konform legjislacionit organik dhe procedural në fuqi, duke bashkëlidhur shkresat e mësipërme. Edhe pse APP ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe Dhomës Kombëtare të Përmbareseve Gjyqësor Privat nuk ka patur asnjë reagim dhe situata vazhdon të mbetet e njëjta, ku APP është e detyruar që t'i ekzekutojë vendimet gjyqësore me përmbares, pasi ai është i vetmi moment kur njihet me detyrimin që i ka lindur nga shpenzimet gjyqësore dhe duke rënduar buxhetin e shtetit me tarifat përmbarimore.

e) Auditimi i procedurave të prokurimit

Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga Agjencia e Prokurimit Publik, në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Argumentimin dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimin e APP-së, brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

I. Regjistri i parashikimeve

- Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar, në Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 “Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik.”
- Regjistri i parashikimit për vitin 2021 është dërguar me shkresën nr. 8414/1, datë 28.12.2020;
Regjistri i parashikimit për vitin 2022 është dërguar me shkresën nr. 8048/1, datë 05.01.2022;
Regjistri i parashikimit për vitin 2023 është dërguar me shkresën nr. 8926/1 datë 30.12.2022.
Sa më sipër regjistrat e parashikimit janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar Udhëzimin nr. 4, datë

18.06.2021 pika 3 ku citohet se “Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga AK jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës”.

- Ligji i buxhetit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” është botuar në fletoren zyrtare nr.221 datë 17.12.2020.

- Ligji i buxhetit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është botuar në fletoren zyrtare nr.197 datë 21.12.2021;

- Ligji i buxhetit nr. 84, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” është botuar në fletoren zyrtare nr. 171 datë 21.12.2021;

- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

II. Regjistri i realizimeve

Në lidhje me regjistrin e realizimit u konstatua se është paraqitur me formën dhe mënyrën që është parashikuar, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 dhe nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Për periudhën objekt auditimi APP në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK) ka kryer prokurimet si vijon:

- Për vitin 2021, procedurat e prokurimit të realizuara paraqiten në vlerën totale prej 2,068,136 lekë dhe përbëhen nga: “Procedurë e hapur” në vlerën prej 597,000 lekë, cila është zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, “Blerje me vlerë të vogël” në vlerën prej 988,064 lekë pa TVSH, “Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” zë vlerën 72,900 lekë, dhe blerje nën vlerën 100,000 lekë zë vlerën 410,172 lekë.

- Për vitin 2022, procedurat e prokurimit të realizuara paraqiten në vlerën totale prej 3,072,128 lekë dhe përbëhen nga: “Procedurë e hapur” në vlerën prej 476,520 lekë, cila është zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, “Blerje me vlerë të vogël” në vlerën prej 1,591,080 lekë pa TVSH, “Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” zë vlerën 476,569 lekë, dhe blerje nën vlerën 100,000 lekë zë vlerën 527,959 lekë.

- Për vitin 2023, procedurat e prokurimit të realizuara paraqiten në vlerën totale prej 1,844,535 lekë dhe përbëhen nga: “Blerje me vlerë të vogël” në vlerën prej 1,336,515 lekë pa TVSH, ku “Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” zë vlerën 115,292 lekë, dhe blerje nën vlerën 100,000 lekë zë vlerën 392,728 lekë.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga Agjencia e Prokurimit Publik rezultoi se:

- Është përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përlloragitur e fondit limit ka qenë ndërmjet kufijve nga 100,000 (njëqind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

- AK në fillim të çdo vitit kalendarik ka ngritur “Komisionin e prokurimeve me vlerë të vogël” të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh.

- Përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga AK është bërë përlloragitja e fondit limit të procedurës blerje e vogël nga “Komisioni i përlloragitjes së fondit limit”, i cili është mbështetur në kërkesat për nevoja mallra/shërbime etj.

- Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë, që iu është drejtuar operatorëve ekonomikë, në të cilën janë përcaktuar të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit dhe janë publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, veprime në përputhje me pikën 4 të nenit nr. 56, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Për të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara u konstatua mungesa e inventarizimit, e për pasojë e arkivimit, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi).

Titulli i Gjetjes:	<i>Dosjet e prokurimeve të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara</i>
Situata:	Për të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara u konstatua mungesa e inventarizimit, e për pasojë e arkivimit, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi).
Kriteri:	- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”; -VKM.nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 12.
Shkaku:	Parregullsia në administrimin e dokumentacionit
Ndikimi/Efekti:	Mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masat në vijimësi, që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

2.4 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Agjencinë e Prokurimit Publik (në vijim APP) u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Në kuptimin e ligjit të sipërcituar, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Referuar Manualit të MFK, në nenin 19, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit” citohet se: “Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njesisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.*

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka hartuar dhe zbaton një kod etike, miratuar me vendimin nr. 16, datë 05.10.2018 “Për miratimin e Kodit të Etikës të Institucionit të Agjencisë së Prokurimit Publik”.

b. *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.*

Agjencia e Prokurimit Publik është person juridik në varësi të Kryeministrit, me seli qendrore në Tiranë, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe Ligjin Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar. Organika dhe struktura e APP-së përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit.

Struktura e APP-së e planifikuar dhe realizuar për periudhën objekt auditimi është si më poshtë vijon:


Viti	Struktura sipas Viteve	Plan	Fakt Dhjetor	Diferenca
2021	Punonjës në organikë	44	35	9
2022	Punonjës në organikë	44	39	5
2023	Punonjës në organikë	48	39	9

Burimi: APP

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

APP deri më 28.12.2021, ka kryer funksionet e saj me 44 punonjës, duke u bazuar në Ligjin Nr 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, si dhe organigramën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 54, datë 15.03.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”. Sipas kësaj strukture, APP është e organizuar mbi bazën e 3 drejtorive si Drejtoria Juridike, e Verifikimit dhe Integritetit, Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit, si dhe Sektorit të Financës dhe Burimeve Njerëzore. Referuar statistikave, vihet re se në katërmujorin e tretë të vitit 2021 organika e institucionit nuk është plotësuar me 9 punonjës, kjo për faktin se ka pasur largime nëpërmjet procedurës së dorëheqjes, pezullimit të statusit si dhe emërimesh në institucione të tjera, për të cilët është raportuar në Regjistrin Qendror të Personelit (HRMIS), dhe ka filluar procedura e rekrutimit për punonjës të rinj nga DAP.

Organigrama e APP-së ka funksionuar si më poshtë:




Burimi: APP

APP deri më 17.03.2023, ka kryer funksionet e saj me 44 punonjës, duke u bazuar në ligjin nr 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe organigramën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 54, datë 15.03.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”. Sipas kësaj strukture, APP është e organizuar mbi bazën e 4 drejtorive si Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit të Procedurave, Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave, Drejtoria e Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritimit, Drejtoria e Menaxhimit të Bazës së Dhënave dhe Publikimit, si dhe Sektorit të Financës dhe Burimeve Njerëzore.

Referuar statistikave, vihet re se në katërmujorin e tretë të vitit 2022 organika e institucionit nuk është plotësuar me 5 punonjës.


Organigrama e APP-së ka funksionuar si më poshtë:



Burimi: APP

Me hyrjen në fuqi të Urdhrit të Kryeministrit me nr.34 datë 19.10.2023, “Për miratimin e organikës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, i ndryshuar me Urdhër nr.172 datë 19.10.2023, numri total i punonjësve do të jetë gjithsej 48 punonjës. Sipas kësaj strukture, është shtuar me katër numri

total i punonjësve, pa ndryshime në organigramë
Organigrama e APP-së ka funksionuar si më poshtë:



Burimi: APP

- Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna

APP ka të implementuar Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) i cili i ndërtuar për të ndihmuar institucionet shtetërore në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistemi përmban të dhëna dhe informacion të zgjeruar për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet. Në dosjet personale të të punësuarve reflektohen të dhëna për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, pagat dhe sigurimet. HRMIS përmban informacion për strukturën dhe organikën e institucioneve. Strukturat e hedhura në sistem plotësohen nga personi përgjegjës i institucionit, bazuar në VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” parashikojnë se sistemi HRMIS duhet të ndërveprojë me bazat e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Sistemit të Thesarit në Ministrinë e Financave etj. HRMIS shërben si burim planifikimi dhe informacioni për pagat dhe pagesat e nëpunësve publikë, nëpërmjet ndërveprimit me Sistemin e Thesarit.

Gjatë periudhës objekt auditimi ka pasur disa procedura rekrutimi dhe disa procedura largimi. Lidhur me aktivitetin e aparatit për këto procedura paraqiten në pjesën e mëposhtme:

Emërimet

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e APP, drejtues dhe specialistë rregullohen në bazë të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, marrëdhëniet e punës për punonjësit e tjerë që nuk janë nëpunës civil rregullohen në bazë të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, në APP janë emëruar gjithsej 4 punonjës.

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, në APP janë emëruar gjithsej 10 punonjës.

Për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, në APP janë emëruar gjithsej 8 punonjës.

Largimet/

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në APP i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 7

punonjësve, për arsytet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	6	83%
Kërkesë pezullim statusi	1	27%
Totali	7	

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në APP i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 4 punonjësve, për arsytet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	3	75%
Dalje në pension	1	25%
Totali	4	

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në APP i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 4 punonjësve, për arsytet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	3	75%
Kërkesë pezullim statusi	1	25%
Totali	4	

Vendimet gjyqësore

Sa i takon marrëdhëniet e punës, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 – 31.12.2023 nuk ka çështje gjyqësore në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nuk ka asnjë vendim të formës së prerë.

- Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore duke u bazuar në VKM nr.117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”, e cila përcakton se:

- 1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.*
- 2. Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.*

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se:

Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

-Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.

-Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.

-Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë); certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicionin e punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota

mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i diplomimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; librezja e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 10 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi.

Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacion, si nga mungesa e dokumenteve plotësisht ose mungesa e noterizimit, të paraqitura si më poshtë:

- Në 6 dosje mungon fleta e inventarit, dhe në 2 nga 4 dosje është e pa firmosur nga i punësuar dhe nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore
- Në 3 dosje mungon Fotokopje e ID
- Në 2 dosje mungon Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (Dëshmia e Penalitetit)
- Në 4 dosje mungon Raporti mjekoligjor
- Në 1 dosje mungon Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës
- Në 6 dosje mungon Librezja e Punës

Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit , VKM nr 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, dokumentacioni në dosjet e personelit nuk është i plotë.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore.

Marrëdhëniet e pagave

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e APP, drejtues dhe specialistë rregullohen në bazë të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Procedura e rekrutimit të stafit mbështetës në APP është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve Prill, Nëntor, Dhjetor të vitit 2021, Prill, Nëntor, Dhjetor të vitit 2022 dhe Korrik, Nëntor, Dhjetor të vitit 2023. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listëprezencat në punë, të përgatitura nga Drejtorët e çdo Drejtorie dhe përgjegjësit respektiv, si dhe janë nënshkruar nga dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Në Sektorin e Financës dhe Burimeve Njerëzore, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Nga ana e Grupit të Auditimit është konstatuar se në APP ka një rregullore të brendshme të përditësuar, ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre veprime këto në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në APP, burimet njerëzore menaxhohen nga Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer dhe janë përfshirë në dosje vlerësimet e punonjësve për vitet 2021-2023.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimi, u konstatua se nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore në APP janë paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, veprim në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Punonjësit e institucionit kanë kryer trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, kryesisht të organizuara nga ASPA, për të cilat është siguruar informacion mbi trajnimet dhe ndjekjen e tyre nga ana e stafit të APP-së.

2. MENAXHIMI I RISKUT

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Nga auditimi u konstatua se janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut. APP ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, veprim në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”, ku citohet:...“*Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*”, si dhe me udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3.2.1 ku citohet:... “*Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut*”.3.2.2 “*Nëpunësi autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR (...)*”.

Mbështetur në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me shkresën nr. 1843/1 prot., datë 24.02.2023 APP ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE, Pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së nëpërmjet të cilit synohet ndërgjegjësim i mëtejshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm; Planin e veprimit; si dhe Regjistrin e riskut për vitin 2022.

Nga auditimi i regjistrit të riskut për vitin 2023, i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të APP-së, u konstatua se janë paraqitur dhe dërguar te NA, regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim ky në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar pika neni 11, ku citohet...“*Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:*

2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2023, rezultoi se APP ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së, i cili duhet të mblidhet të paktën 4 herë në

vit, veprime këto në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika nr. 1, e nenit 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, si dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, së, e cila përcakton se: “GMS duhet të mbliidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup, (...).Vendimet e GMS duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.”

Gjithashtu, GMS ka realizuar përgjegjësinë e rishikimit jo më pak se dy herë në vit të regjistrit të riskut, veprim ky në përputhje me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, ku përcakton se “GMS është përgjegjës të sigurojë se regjistri i riskut për programe/objektiva specifik rishikohet jo më pak se dy herë në vit”.

3. VEPRIMTARITË E KONTROLLIT

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsi dhe shkeljeve si dhe mos zbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Ndarja e detyrave në APP rregullohet me anë të Rregullores së Brendshme të përditësuar, miratuar me vendim nr. 5, datë 29.12.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Institucionit të Agjencisë së Prokurimit Publik”.

Rrjedhimisht, APP ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e saj, në përputhje me përcaktimet e pikave nr. 2 dhe 3, të nenit 16, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet... “2. Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

4. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë. Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësi. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Drejtuesit e programeve kanë raportuar tek nëpunësi autorizues për ecurinë e veprimtarisë, planeve të punës dhe objektivave të vendosur për realizimin e politikave, duke hartuar raporte monitorimi periodike në varësi të punës. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Agjencia e Prokurimit Publik ka faqen e saj zyrtare në internet dhe nëpërmjet kësaj të fundit të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth veprimtarisë së institucionit.

Punonjësit e APP janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij (*app.gov.al*).

5. MONITORIMI

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar

dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës.

Agjencia e Prokurimit Publik ka caktuar znj. R.K. (Drejtor i Përgjithshëm) si Nëpunës Autorizues me anë të shkresës nr. 5977/1 prot., datë 10.10.2017. Sa më sipër, në përmbushje të kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”.

APP, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar dhe dërguar pyetësonin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2021, 2022 me shkresat nr. 8070/5 prot., datë 28.02.2022, nr. 1843/1 prot., datë 24.02.2023 drejtuar strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me anë të shkresave të cituara, APP ka dërguar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportet për funksionimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Struktura e raportimit respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”.

Nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1037/5 prot., datë 01.03.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Sa i takon rekomandimit tuaj, APP ka marrë masat për të rishikuar të gjitha dosjet e personelit, dhe plotësimin e tyre me dokumentacionin përkatës, duke përfshirë edhe ato që janë në sistemin elektronik të administratës publike, në vijimësi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër, nga subjekti i audituar janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna, të cilat janë pranuar dhe nga institucioni i APP-së do të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mangësitë në menaxhimin e burimeve njerëzore</i>
Situata:	Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 10 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi. Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacion si më poshtë: - Fletë Inventari - Fotokopje e ID - Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës - Libreza e punës - Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore - Raport mjekoligjor Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, dokumentacioni në dosjet e personelit nuk është i plotë.
Kriteri:	- Ligji Nr.152/2023 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, - VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit;

	- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi sjell që dokumentacioni në dosjet personale të punonjësve nuk është i plotë
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturës së Burimeve Njerëzore
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Spektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa në vazhdimësi për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës, sipas bazës ligjore në fuqi.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer është konstatuar një mungesë koherence dhe harmonizimi midis kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi, përse i takon afateve të ankimimit administrativ në fushën e prokurimeve publike të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë. Konkretisht, sipas Ligjit Nr.36/2020, datë 16.04.2020 “*Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë*”, në nenin 53, pikat 2 dhe 3, përcaktohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

Ndërkohë që VKM Nr.1170, datë 24.12.2020 2020 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë*”, në nenin 62 pika 4 dhe 5, përcakton se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Nga APP në bashkëveprim me Ministrinë e Mbrojtjes në rolin e institucionit përgjegjës për prokurimet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të merren masa të menjëhershme për propozimin e miratimin e ndryshimeve të nevojshme, me qëllim që të shmanget kjo papajtueshmëri dhe mungesë koherence ligjore.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer ka rezultuar se në lidhje me rregullimin e procedurave dhe dokumentacionit të ankandit, ekziston një mungesë harmonizimi e përputhjeje ndërmjet pikës 3 të nenit 20, të ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” ku përcaktohet se “*autoriteti shitës negocion me ofertuesit, për t’iu përshatur ofertat e tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftim në mënyrë që të kenë si rezultat përzgjedhjen e ofertës më të mirë*” dhe pikës 5.1 të Dokumenteve Standarde të Ankandit, ku shprehimisht thuhet se “*Nuk do të kryhet asnjë negociatë me Ofertuesin në lidhje me ofertën e tij*”, të cilat kanë sjellë problematika në praktikë.

Konstatohet një mos përputhje në lidhje me afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimin e saj, ku sipas shtojcën 7 të DSA përcaktohet se subjekti fitues ka afat 30 ditë kohë për tu paraqitur për formulimin e sigurimit të kontratës.

Nga ana tjetër, në nenin 39, pika 3 të LAP, përcaktohet se “Autoriteti shitës dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën brenda 10 ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike. Kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit”. Një mospërputhje e tillë, shkakton paqartësi në lidhje me afatin për dorëzimin e sigurimit të kontratës dhe nënshkrimi të tij, duke sjellë pengesa në finalizimin me sukses të nënshkrimit të kontratës.

Lidhur me problematiken e DSA, të trajtuara më sipër, në pikën 3, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dokumentet standarde të ankandit publik, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.”

-Ka vetëm 1 set të Dokumenteve Standarde të Ankandit, edhe pse janë 4 procedura të ndryshme. Pavarësisht faktit se VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 përcakton se: “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dokumentet standarde të ankandit publik, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga APP në bashkëveprim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e institucionit përgjegjës për prokurimet në fushën ankandeve publike, të merren masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve të kuadrit rregullator në fuqi dhe hartimin e dokumenteve standard të ankandeve.

Afati: **Menjherë e në vijimësi**

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimet e kryera nga Agjencia e Prokurimit Publik, të procedurës së ankandit publik, të zhvilluara nga autoritete të ndryshme shitëse për vitin 2021, për objektin “Shitje e materialit drusor të vlerësuar në ngastrat e dëmtuara nga faktorë të ndryshëm natyrore dhe nga zjarret”, ka rezultuar se, disa nga kriteret e pranimit të përcaktuara nga autoriteti shitës në dokumentet e ankandit, janë bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 03.03.2017, të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit. Konkretisht, ku përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për shfrytëzimin e ngastrave me rrugë autopsyjore.

Sa më sipër rezulton se, disa nga kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim nuk janë në harmoni me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik, i cili ndër qëllimet kryesore të tij, nxitjen e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik dhe në veçanti të biznesit të vogël dhe të mesëm. Më konkretisht: pika 1 e kreut XI e Udhëzimit, u referohet “vetëm” subjekteve juridike, kjo në kundërshtim me pikën 3, të nenit 3, të LAP Nr.9874, datë 14.02.2008, që përcakton se “Kandidatë blerës janë të gjithë personat fizikë ose juridikë që kërkojnë të marrin pjesë me ofertën e tyre në procedurën e shitjes publike nëpërmjet ankandit publik”. Pra ekziston një mungesë harmonizimi dhe koherence ndërmjet Udhëzimit të nxjerrë nga Ministria e Turizmit dhe LAP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Nga APP, në bashkëveprim me Ministrinë e Turizmit, të merren masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve në kuadër të harmonizimit me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik rregullator në fuqi dhe udhëzimit të nxjerrë.

Afati: **Menjherë e në vijimësi**

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2021-2022, rezultoi se nga ana e këtij institucioni nuk është kryer asnjë proces hetimi për kontratat koncesionare. Referuar informacionit të datës 18.7.2023, dërguar nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, për vitin 2020 është nënshkruar kontrata koncesionare datë 20.4.2020 me objekt: “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim

i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës”, me Autoritet Kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu, Sektori i Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare në Agjencinë e Prokurimit Publik, nuk ka administruar informacion të përditësuar nga ATRAKO, nëse janë finalizuar me nënshkrim kontrate, tre procedurat koncesionare të vitit 2022⁶. APP pasi administrimit të kontratave koncesionare nga ATRAKO, (kjo e fundit është përgjegjëse për mbajtjen e bazës së të dhënave për të gjitha kontratat e koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të dhëna në Republikën e Shqipërisë), vlerëson në bazë të kriterëve të caktuara në rregulloren e saj të brendshme, për përzgjedhjen e kontratave që do t’i nënshtrohen hetimit administrativ. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa në vijim që të sigurojë një komunikim të vazhdueshëm me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve lidhur me përditësimin e informacionit për kontratat koncesionare dhe përzgjedhjen e kontratave që do t’i nënshtrohen hetimit administrativ.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Grupi i Auditimit konstatoi se: Struktura e Sektorit të Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare është e paplotësuar për arsye të një pozicioni vakant “Inspektor”, si dhe nuk ka një plan trajnimi për stafin, lidhur me procedurat koncesionare. Lidhur me trajnimet, rezultoi se nuk ka një kërkesë zyrtare të APP-së drejtuar institucioneve përgjegjëse, për nevojat që ka për trajnim të stafit të saj, lidhur me procedurat koncesionare. Sipas subjektit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) si institucioni përgjegjës, që ofron trajnime për nëpunësit e administratës publike nuk ka ofruar trajnime në fushën e koncesioneve/PPP. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 8-47 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendit vakant “Inspektor” në Sektorin e Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

2.2 Rekomandimi: Nga ana e APP-së të merren masa për koordinimin e veprimeve me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për planifikimin e trajnimeve të specialistëve të Sektorit të Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP për procedurat koncesionare, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe krijimin e njohurive të specializuara në këtë fushë.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga subjekti mbi planet e verifikimit për procedurat e prokurimit publik, procedurat e Koncesioneve/PPP dhe procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë për vitet 2022 dhe 2023, u konstatua se: APP si institucion verifikues ende nuk ka përmbyllur detyrimin ligjor për monitorimin procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, me qëllim dhënien e sigurisë për mirëmenaxhimin e fondeve publike në këto procedura prokurimi. Megjithëse APP ka ndërmarrë në vijimësi gjithë veprimet e nevojshme konform kërkesave të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, për të përmbyllur procesin e implementimit të sistemit të komunikimit dhe të informacionit, ende nuk ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AKSHI, pasi nevojitet asistencë e një specialisti

⁶ -Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Milot-Thumanë”

-Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Kashar-Pezë-Lekaj”

-Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Lekaj-Konjat-Fier”

IT, në rolin e administratorit të SIK-së, si person përgjegjës për aspektet e sigurisë që lidhen me implementimin, instalimin dhe operimin e sistemit. Për këtë arsye APP, me shkresë nr. 9550/1 prot, datë 14.12.2023, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të caktuar një nga specialistët IT të atashuar në APP, në rolin e administratorit të SIK, por nuk ka marrë një përgjigje nga AKSHI mbi këtë çështje.

Nisur nga të dhënat statistikore për periudhë 2021-2023 rezultojnë të jenë në total 35 kontrata të nënshkruara për procedurat e prokurimit në këtë fushë. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 14 të ligji nr. 36/2020 “Për Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: APP të vijojë bashkëpunimin me Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për caktimin e specialistit të IT-së në APP, në rolin e administratorit të Sistemit të Informacionit të Klasifikuar (SIK), si personi përgjegjës për aspektet e sigurisë që lidhen me implementimin, instalimin dhe operimin e këtij sistemi.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Nga ana e APP-së të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga AKSHI me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i informacionit të klasifikuar, si dhe të marrë masa për nisjen e punës për verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të “Llogarive të arkëtueshme” u konstatua se: -Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në shumën 158,509 lekë përfaqëson të drejtat që i kanë lindur institucionit të APP-së për debitorë të paarkëtuar, të cilat janë regjistruar që në vitin 2000 dhe përfaqësojnë gjoba ndaj punonjësve. Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto të drejta nuk janë arkëtuar dhe kanë kaluar afatin e parashkrimit për arkëtimin e tyre. Nga ana e Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë kjo shumë rezulton e paarkëtueshme, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 115 Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dhjetë tre vjetëve paditë për shpërbllimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 55-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe evidentohen si të paarkëtueshme, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” u konstatua debitimi i shumës prej 1,507,813 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti.” Vlera prej 1,507,813 lekë e paraqitur në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është kontabilizuar jo në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë, vlerë e cila është e paidentifikuar dhe s’ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3,

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore së APP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 1,507,813 lekë, duke bërë veprimin kontabël kreditimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe debitimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive 214 dhe 218 u konstatua se nga ana e Sektorit të Financës, pajisjet kompjuterike janë klasifikuar si në llogarinë 214, po ashtu dhe në llogarinë 218. Gjithashtu, nga analiza e zërave të aktiveve dhe amortizimin e tyre zë për zë u konstatua se artikulli “Kondicioner” është amortizuar me normën 25% duke e klasifikuar si “*Kompjuterat, pajisje të ruajtjes së të dhënave, software e sisteme informacioni*” ku norma e amortizimit llogaritet mbi bazë grupimi me normën 25%, Veprim jo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36, duke ndikuar në mos pasqyrimin e saktë të gjendjen neto të aktiveve, si dhe ndikimi i amortizimit vjetor në fondin neto të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 55-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për riklasifikimin e artikullit “Kondicioner” në llogaritë kontabël 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune”, si dhe në rillogaritjen e amortizimit të akumuluar me normën 20% të këtyre artikujve, me qëllim përcaktimin e vlerës reale neto të gjendjes së aktiveve që institucioni disponon.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Llogarive të pagueshme u konstatua se:

Në llogarinë 401-408, “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, ndër të tjera, përfshihet dhe detyrimi që ka institucionit i APP-së, në vlerën 1,507,813 lekë, furnitorë të palikuiduar për periudhën 2007-2008. Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto detyrime nuk janë paguar, si dhe nga ana e furnitorit subjekti “G.”, janë kaluar afatet e parashkrimit për pagesën e tyre. Nga ana e furnitorit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si dhe ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku përcaktohet se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës”, si rrjedhojë ky detyrim është i parashkruar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 55-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1 Rekomandimi: Nga ana e titullarit të Agjencisë së Prokurimit Publik të merren masat për ngritjen e një grupi pune, me qëllim identifikimin e mundësive reale për pagesën e këtyre debitorëve apo për sistemimin e këtyre vlerave nëkontabilitet, sipas parashikimeve në Kodin Civil.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik për periudhën 2021-2023, rezultoi se dosjet e prokurimeve nga struktura përgjegjëse për prokurimet, nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara duke sjellë si pasojë, parregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 55-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masat në vijimësi, që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatuan parregullsi dhe mangësi në dokumentacion si: mungesë e fletës së inventarit të dosjes, librezë pune, raport mjeko-ligjor etj, veprime jo në përputhje me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit dhe VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 70-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa në vazhdimësi për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës, sipas bazës ligjore në fuqi.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT